

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 402 • MAJ 2024



PUNA SI KËRKESË PËR MBIJETESË
DHE SI DETYRIM FETAR ISLAM

DISKRIMINIMI GJINOR
NË VËND TË PUNËS

PAQJA SI DETYRË HYJNORE

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË SESIONIN E 23-TË TË BORDIT TË LARTË TË AKADEMISË SË JURISPRUDENCËS ISLAME

Më 20 prill 2024, në Riad të Arabisë Saudite, filloi punimet sesioni i 23-të i Bordit të Lartë të Akademisë së Jurisprudencës Islame, i cili është organi më i lartë i jurisprudencës islame që vepron në kuadër të Ligës Botërore Islame RABITA.

Në këtë mbledhje, për herë të parë mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili tash së fundmi u zgjodh edhe anëtar i Bordit.

Hapjen e këtij sesioni e përshëndetën sekretari i Akademisë së Fikhut, dr. Abdurahman ez Zejdi, myftiu i Arabisë Saudite, Abdulaziz al Sheikh, sekretari gjeneral i RABITA-s, dr. Abdulkerim al Isa, sekretari gjeneral i OBI-së, dr. Husein Taha, imami i Qabesë, njëherësh këshilltari në oborrin mbretëror, dr. Salih al Humejdi.

Gjatë punimeve dy ditore të këtij sesioni, u diskutuan tema të ndryshme



nga fusha e disiplina të ndryshme, të cilat kërkojnë përgjigje nga aspekti fetar në kohën tonë moderne, siç janë ato të fushës së teknologjisë, shëndetësisë, astronomisë, pakicave myslimane në

vendet jo myslimane, financave moderne etj.

Myftiu Tërnavë në këtë udhëtim u shoqërua nga shefi i kabinetit të tij, mr. Besim Mehmeti.

MYFTIU TËRNAVA U PRIT NË TAKIM NGA SEKRETARI GJENERAL I LIGËS SË BOTËS ISLAME - RABITA, DR. MUHAMED ABDULKERIM AL ISA

Më 23 prill 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, u prit në takim nga sekretari gjeneral i Ligës së Botës Islame RABITA, dr. Muhamed Abdulkerim al Isa.

Dr. Al Isa falënderoi Myftiun Tërnavë për pjesëmarrje në sesionin e 23-të të Bordit të Lartë të Akademisë së Jurisprudencës Islame, duke vlerësuar kështu rolin dhe kontributin e tij në promovimin e Islamit burimor dhe mesatar.

Ai theksoi se Këshilli i Lartë i Akademisë së Jurisprudencës Islame ka vlerësuar këtë kontribut dhe ka përzgjedhur Myftiun të jetë anëtar i Këshillit në një mandat pesë vjeçar, duke çmuar kështu edhe kontributin e tij në këtë Forum. Dr. Al Isa çmoi lart aktivitetin e Bashkësisë Islame të Kosovës për bashkëjetesën dhe tolerancën, të cilën e promovon dhe me të cilën veçohet populli shqiptar.



Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë, falënderoi nikoqirin për mikpritjen dhe e përgëzoi atë për suksesin e këtij takimi, si dhe falënderoi për besimin dhe vlerësimin për zgjedhjen e tij në Bordin e këtij Këshilli. Gjithashtu, Myftiu Tërnavë, shfrytëzoi rastin që ta

njoh dr. Al Isa me zhvillimet e fundit në Kosovë, si dhe me sfidat që shteti i Kosovës po ballafaqohet në këtë fazë.

Në këtë takim Myftiu Tërnavë u shoqërua nga shefi i kabinetit, mr. Besim Mehmeti.

EDITORIAL

- 4 Regjistrimi i popullsisë dhe kompleksi i inferioritetit fetar

FETARE

- 5 Hytbeja e Myftiut për Fitër Bajram
- 7 Të drejtat dhe përgjegjësitë e punëtorëve në Islam
Dr. Ejup Haziri
- 11 Puna si kërkesë për mbijetesë dhe si detyrim fetar islam
Dr. Rijad Imeri
- 14 Devotshmëria si virtyti më i madh
Dr. Sedat Islami
- 18 Xhizja, teori e falsifikuar e konvertimit "të dhunshëm" të shqiptarëve në Islam
Hajrudin S. Muja
- 23 Përkthime të pjesshme të Kuranit në gjuhën shqipe
Dr. Azmir Jusufi

KULTURË

- 26 Parabola e ëndrrave
Granit Sadiku
- 31 Dobitë mjekësore të vajit të farës së zezë
Dr. Afërdita Zejnullahu

INTERVISTË

- 33 Të arriturat e Shtëpisë Botuese "Dituria Islame" janë të mëdha, të shumta dhe të prekshme



FAMILJE & EDUKIM

- 37 Të drejtat e punëtorëve dhe migrimi i popullsisë në Kosovë
Prof. ass. dr. Ferdi Kamberi
- 41 Diskriminimi gjinor në vendin e punës
Azemine Kukaj
- 45 Paqja - kërkesë njerëzore dhe detyrim hyjnor
Mr. Besa Ismaili
- 47 Qasja ekolinguistike në edukimin fetar të brezit të ri - një alternativë mirëkuptimi
Dr. Xhevdet Rusinovci
- 52 Pedagogjia në mësimdhënien islame
Faik Llumnica



HISTORI

- 55 Flamuri i rezistencës në muret e Medresesë "Alauddin"
Akademik Feti Mehdiu

PERSONALITETE

- 58 Jeta e Imam Kadi Ijadit (V.544/1149)
Blerton Bahtiri

AKTIVITETE

- 68 Myftiu Tërnavë mori pjesë në sesionin e 23-të të Bordit të Lartë të Akademisë së Jurisprudencës Islame të Arabisë Saudite



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 402 • viti 37 • Mam 2024
• Sheval / Dhul-Ka'de 1445
• çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavë,
Mr. Vedat Shabani.

Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"IliriPrint", Prishtinë

Regjistrimi i popullsisë dhe kompleksi i inferioritetit fetar



“Shqiptarët myslimanë përbënin një barrierë ndaj idesë imperialiste megalomane greke dhe sllave.”

(Sami Frashëri)

Regjistrimi i popullsisë mbetet një prej detyrave imediate, që si proces, parimisht rëndon mbi supet e organeve qeveritare në çdo kohë. Ai bëhet edhe më i rëndësishëm sa herë që në një vend ndodhin transformime politike, sociale ose ndryshime demografike. “Demografia është fati i një populli” – është një frazë e cituar shpesh nga studiuesit e fushave socio-politike, e cila rrëfen më së miri se sa i rëndësishëm është për një vend regjistrimi i popullsisë. Thënë më ndryshe, statistikën dhe regjistrimet e popullsisë japin prognozën e pagabuar për fatin e saj, por edhe përshkruajnë besnikërisht se ku do vejë një shoqëri në periudhën afatmesme e afatgjatë.

Edhe regjistrimi ynë i popullsisë, që tani është në proces e sipër, nuk del dot nga ky rend. Çdo e dhënë në rezultatin e statistikës së përgjithshme ka vlerë të veçantë, andaj jo rastësisht edhe ndahet rubrikë specifike për një mori pyetjesh relevante. E në këtë kuadër, edhe rubrika e deklarimit të besimit fetar duket të jetë tejet me vlerë për shoqërinë dhe për institucionet tona.

Në sajë të detyrave të veta, Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës, u ka bërë ftesë publike qytetarëve që të deklarojnë besimin e tyre, e jo të shprehen inferiorë ose të papërcaktuar fetarisht, sepse, përtej stereotipave iluzioniste që mund t'i ketë dikush, kjo, në thelb rrëfen për një pjesë qenësore të identitetit të këtij populli. E, po të mos ishte feja apo besimi faktor jorelevant në shoqëri, do të dukej absurd edhe përfshirja e kësaj pyetjeje në censusin kombëtar të ne dhe jo vetëm. Ky nuk është thjesht një regjistrim, për më tepër kemi të bëjmë me një vizion afatgjatë, i cili ndërthurë në vetvete dimensionet shtetërore, fetare e kombëtare.

Në perceptimet e njohësve të fushave gjegjëse, bindjet dhe praktikët fetare të popullit duket se kanë potencial të madh për të adresuar problemet e sotme sociale. Siç është shprehur edhe Allen Bergin, profesor i psikologjisë në Universitetin amerikan “Brigham Young” se: “Ka prova të konsiderueshme që tregojnë se përfshirja fetare redukton probleme të tilla si: shturjen morale, shtatzëninë e adoleshentëve, vetëvrasjen, abuzimin me drogën, konsumimin e alkoolit, dhe deri diku veprimet devijuese dhe delikuede. Ajo, pos të tjerash rrit vetëvlerësimin, kohezionin familjar dhe mirëqenien e përgjithshme. Në përgjithësi, shkencëtarët e fushave sociale po zbulojnë fuqinë e vazhdueshme të fesë për të mbrojtur familjen nga forcat që do ta rrezikonin atë.” Shikuar në konstatimin e mësipërm, edhe shoqëria jonë, nëse jo në nivel të atyre perëndimore, dosido qëndron në një terren të rrezikuar nga po të njëjtat rreziqe, e të cilat mund të lajthisin rrugëtimin e drejtë të shtetit tonë të porsaformuar.

Në kuptimin tonë kombëtar, të deklarohe mi ashtu siç jemi në shumicë myslimanë, është një shprehje e besnikërisë ndaj bindjeve tona të trashëguara dhe ruajtje e diferencës me ata që duan t'i shkrijmë gjithë këto diferenca. Siç theksonte edhe rilindësi ynë, Sami Frashëri, “shqiptarët myslimanë përbënin një barrierë ndaj idesë imperialiste megalomane greke dhe sllave.” Dhe meqenëse pozita jonë gjeografike nuk ka ndryshuar në hartë, dhe fqinjët tanë i kemi po ata që ishin edhe në epokën e rilindësve tonë mendjendritur, deklarimi ynë siç jemi në shumicë, se i përkasim besimit islam, e natyrisht, edhe deklarimi i të krishterëve e protestantëve siç janë të tillë, përbën pos të tjerash edhe një akt të lartë patriotik që nuk do të duhej të neglizhohej nga asnjëri.

Vetëm duke qenë kështu, mbetemi digë e lartë përballë orekseve ekspansioniste të atyre, që e kaluara na rrëfen se fqinjësia jonë me ta nuk na ka falur qetësinë e një fqinjësie të mirë. Në këtë kuptim, thirrjet mesquine që vijnë për të braktisur këtë trashëgimi, apo për të ndryshuar proporcionalitetin religjioz të shoqërisë sonë në favor të njëres apo fesë tjetër, në këtë kohë, janë tentativa për të prekur gjenin identitar të këtij populli. Ato cenojnë diversitetin e shëndoshë religjioz që ka ngulitur rrënjët në truallin tonë, dhe kanë efekt negativ aq sa për të shpërqendruar vëmendjen nga sfidat reale që cenojnë shtëpinë tonë të përbashkët.

Mr. Driton Arifi

Hytbeja e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, e mbajtur me rastin e festës së Fitër Bajramit

“Familja është themeli i shoqërisë”

Sot është ditë feste, ditë gëzimi, ditë smëshire e shpërblimi, ngase të gjitha adhurimet dhe lutjet, të cilat i kemi kryer gjatë këtij muaji të bekuar Ramazan ishin rrugë drejt këtij gëzimi e vëllazërimi, andaj me të drejtë i gëzohemi kësaj dite kaq madhështore dhe kaq të gëzueshme, ngase vjen pas një adhurimi e përkushtimi njëmujor.

Në shenjë të kësaj, Zoti xh.sh., thotë: *“Vetëm mirësisë së Zotit dhe mëshirës së Tij le t'i gëzohen, se është shumë më e dobishme se ajo që grumbullojnë ata.”* (Junus, 58).

Le t'i gëzohemi edhe ne kësaj dite, duke uruar e vizituar njëri-tjetrin për këtë festë, të lutemi për shëndet e mirëqenie, solidaritet e vëllazëri, humanitet e siguri, duke u lutur që Zoti të mos na ndaj nga mëshira e Tij.

Të nderuar vëllezër e motra,

Botërisht është i njohur qëndrimi human i Islamit rreth ruajtjes dhe shumimit të llojit njerëzor. Feja jonë islame vërteton se njeriu është krijesa më e privilegjuar, e pajisur me veçori e cilësi të veçanta, për dallim nga krijesat e tjera, të cilat jetojnë mbi sipërfaqen e Tokës. Zoti xh.sh., krijoi Ademin dhe Havanë, babanë dhe nënën e njerëzimit, prej tyre pastaj mundësoi shumimin e krijimit e familjeve, fiseve e popujve të ndryshëm. Ai në shenjë rikujtimi për këtë mirësi e begati tha: *“Me të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun nga një farë e përzier-zigota, për ta sprovuar dhe e bëmë atë që të dëgjojë e të shoh.”* (El Insan, 2).

Edhe Muhamedi a.s., porositi duke thënë: *“Martohuni, shumojuni.”*

Familja është elementi kyç dhe i parë ndërtues, është bërthama bazë e formimit të një shoqërie, është baza e forcës dhe kohezionit të një shoqërie, mirëqenia e saj nënkupton mirëqenien e gjithë shoqërisë. Feja jonë islame i ka kushtuar vëmendje të madhe familjes, themeleve të formimit të saj në vazhdimësi, në mënyrë që ajo të mbetet e lartë e me harmoni

mbizotëruese të tej mbushur me dashuri prindërore e familjare. Familja kërkon lumturinë dhe stabilitetin, ajo ndërton jetën e saj mbi themele të forta. Familja konsiderohet si një shtyllë themelore e strukturës shoqërore, për shkak të lidhjeve të saja shpirtërore, fetare, psikologjike, materiale etj.. Ajo është një burim force për individin, veçanërisht nëse është një familje kohezive, që siguron një atmosferë stabiliteti psikologjik dhe emocional.

Familja është themeli i shoqërisë, është elementi themeltar në formimin e shoqërisë, e cila ndërtohet mbi bazën e marrëdhënies ndërmjet një mashkulli dhe një femre, përmes një akti ligjor të kurorëzimit mes tyre. Dhe si e tillë, kësaj familje edhe i është besuar e drejta dhe përgjegjësia për të rritur fëmijë, për t'i drejtuar dhe edukuar ata drejt asaj që është në interesin e tyre më të mirë dhe për t'i përgatitur ata sa më mirë që t'i marrin detyrat që u takojnë në të ardhmen, brenda një shoqërie ku ata jetojnë. Sigurimi i edukimit të duhur, kujdestaria dhe përkujdesja ndaj fëmijëve bëhet duke iu ofruar edukim dhe vlera të çmuara familjare, ngase kjo fazë është edhe gurthemeli nga i cili formohet personaliteti i fëmijës, andaj duhet pasur kujdes, sepse e kemi amanet nga Zoti, i Cili thotë: *“O ju që keni besuar, ruani veten dhe familjen tuaj nga zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët.”* (Et Tahrir, 6).

Siç po shihet, familja në fenë dhe traditën tonë është njësi bazë shoqërore mbi të cilën bazohet struktura e shoqërisë, dhe është elementi i parë ndërtues mbi të cilën ndërtohet edhe kombi dhe kalitet atdhedashuria. Me të drejtë feja islame e ka vënë familjen në qendër të shqetësimeve të saj, pasi që e konsideron bazë për stabilitetin dhe mirëqenien e shoqërisë.



“Vetëm mirësisë së Zotit dhe mëshirës së Tij le t'i gëzohen, se është shumë më e dobishme se ajo që grumbullojnë ata.”

(Junus, 58)



Kushdo prej nesh që përcjell diskutimet, por edhe debatet e shumta që po zhvillohen kohëve të fundit në vendin tonë për aprovimin e disa ligjeve rreth familjes, sheh se këto përpjekje bien ndesh me identitetin, fenë dhe vlerat morale që posedon shoqëria jonë. Përpjekjet në këtë drejtim janë për shkatërrimin e familjes, zhdukjen apo dobësimin e moralit të lartë që bartë ky popull, ngase synohet një shoqëri që jeton pa ndjenja të lidhjes emocionale me familjen, të afërmit, traditën, zakonet, dhe fisin, dhe ndikimin që këto elemente kanë në ruajtjen e kohezionit social dhe përkushtimin moral brenda shoqërisë sonë. Duhet ditur se është urdhër hyjnor që familja duhet të jetë e kompletuar, ta dijë se kë e ka babë e nënë, gjysh e gjyshe, vëlla e motër.

Në Islam, familja konsiderohet si njësi bazë për rritjen e brezave të rinj. Ajo siguron një mjedis të sigurt e të qëndrueshëm. Sa më shumë që të jetë struktura e familjes e shëndoshë, e mirë, e vetëdijshme dhe e përkushtuar, aq më shumë do të kemi një shoqëri homogjene, të integruar dhe solidare, një shoqëri që plotëson njëra-tjetrën.

Të nderuar e shumë të respektuar motra e vëllezër,

Edhe në këtë ditë feste, e para këtij xhemati të mrekuillueshëm, e nga ky vend i bekuar, bëj thirrje për të gjithë që të kemi kujdes shumë të madh për të ardhmen e fëmijëve tanë, të familjes sonë. Simptomat e dobësimit të trungut familjar tashmë i kemi para vetes. Nëse para luftës rrallëherë kemi dëgjuar për vetëvrasje, pas luftës pothuajse vetëvrasja është bërë një dukuri shqetësuese, kur shohim e dëgjojmë se një numër i konsiderueshëm i vëllezërve e motrave tona si mjet zgjidhjeje të problemeve të natyrave të ndryshme po e zgjedhin vrasjen apo vetëvrasjen, të cilat sipas normave të Islamit janë rreptësisht të ndaluara. Problemet me të cilat ballafaqohemi gjatë jetës sonë në këtë botë janë të shumta e të shpeshta, si probleme psikologjike, depresioni i rëndë, ngatërresa të ndryshme, skizofrenia, gjendja ekonomike, përvoja të dhimbshme, bullizmi, papunësia, izolimi social, vetmia etj..

Megjithatë, përkundër këtyre sfidave e të ngjashme me të cilat mund të ballafaqohet individit gjatë kësaj jete, duhet ditur se çdo problem, çdo sfidë ka shumë mënyra të zgjedhjes para se njeriu ta marrë vendimin për t'ia shuar jetën vetes apo tjetrit.

Zoti xh.sh., thotë: *“...dhe mos e vritni veten (dhe njëri-tjetrin) vërtet Zoti është i mëshirshëm me ju.”* (En Nisa, 29).

Islami kujdeset dhe nderon jetën, ndalon njeriun për çdo të keqe që mund t'ia bëjë vetes apo ta dëmtojë atë, apo t'i bëjë keq tjetrit. Ndër mëkatet më të mëdha e më të shëmtuara në Islam konsiderohet vrasja e tjetrit dhe vetëvrasja, pa marrë parasysh mënyrën apo shkakun. Vrasja e dikujt, apo vetëvrasja e qëllimtë në fenë islame konsiderohet mëkat i madh, ngase e drejta për dhënien apo marrjen e jetës nuk mund të cenohet nga askush, është e drejtë absolute që i takon vetëm Zotit xh.sh..

Zoti xh.sh., thotë: *“...kush vret dikë, që s'ka vrarë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit dhe nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e tërë njerëzve.”* (El Maide, 32).

Vërtet ne si Bashkësi Islame jemi të shqetësuar me numrin e madh të vetëvrasjeve, që sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, ky fenomen është në rritje. Nga viti 2002 deri më 2023, fatkeqësisht kemi 1230 vetëvrasje në Kosovë, kemi 1051 vëllavrasje, 2933 raste humbje jete në komunikacion, vërtet shifra rrëqethëse. Andaj kërkohet nga ne si shoqëri të mobilizohemi duke përfshirë të gjithë mekanizmat për të marrë masat e duhura në parandalimin e kësaj dukurie, ngase nëse qëndrojmë pasivë, atëherë vetëvrasjet, por edhe vrasjet mes vete do të jenë fatale për ardhmërinë tonë.

Vëllezër e motra,

Kanë kaluar trembëdhjetë vjet nga regjistrimi i fundit i popullatës në vendin tonë. Ky proces i regjistrimit këtë vit ka nisur me datën 5 prill dhe zgjat deri më 17 maj, andaj ftojme të gjithë qytetarët që të japin kontributin e tyre, të mos hezitojnë që të regjistrohen dhe të japin të dhëna bazuar në formularët që përfshijnë regjistrimi i popullatës dhe ekonomive familjare etj., të përgatitur nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Ky është një shërbim qytetar që duhet t'i bëhet vendit.

Në fund edhe njëherë urime festa e Fitër Bajramit!

Myftiu Naim Tërnav

Prishtinë, më 10.04.2024

Të drejtat dhe përgjegjësitë e punëtorëve në Islam

(TRAJTESË FIKHORE)

Dr. Ejup Haziri

HYRJJE

Islami e legjitimoi punën dhe i dha asaj Irëndësi të posaçme. Ai, punën e konsideroi dinjitet dhe nevojë mes njerëzve. Disa njerëz janë të pasur, e disa të varfër. Të pasurit kanë nevojë për të varfrit dhe të varfrit kanë nevojë për të pasurit. Secili ka nevojë për tjetrin dhe ky është ligj i jetës. Allahu thotë: *“Ne kemi dalluar disa në shkallë më të lartë se të tjerët, që të shfrytëzojnë njëri-tjetrin për shërbime...”* (Ez Zuhruf, 32). Nisur nga ky parim kuranor, nëse secili merr përsipër rolin dhe përgjegjësinë që i takon, shoqëria dhe kolektivi do të jetë në harmoni me njëri-tjetrin dhe ata do të jenë sikur një trup i vetëm, që nëse ankohet një pjesë, pjesa tjetër duhet ta ndiejë atë dhembje.

MYSLIMANI DUHET TË JETË AKTIV E PRODUKTIV

Islami i kushtoi rëndësi punës dhe angazhimit dhe kërkoi që besimtari të jetë aktiv për veten e produktiv për të tjerët, e jo të bëhet barrë e tjetrit e as i varur nga dikush tjetër.


Fitimi më i mirë është ai që fitohet me djersë, mund dhe angazhim personal. E në këtë kontekst, Mikdami transmeton se si i Dërguari i Allahut, paqja e Allahut qoftë mbi

“Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, më mirë është që ndonjëri nga ju ta marrë litarin e të bartë mbi shpinën e tij dru, se sa të vijë e të kërkojë (lëmoshë) nga ndokush, pavarësisht nëse i jep apo jo.”

(Muhamedi, a.s.)

të, thoshte: “Nuk do të hajë ushqim më të mirë askush sesa ai që e fiton me dorën e vet, Pejgamberi i Zotit, Davudi a.s., ka ngrënë vetëm nga ajo që e ka fituar me dorën e vet.”¹ I Dërguari i Allahut tregonte se të gjithë pejgamberët kishin profesione të ndryshme, përmendte Nuhun që ishte marangoz.² Imam Neveviu në lidhje me punën e të dërguarve të Allahut, thoshte: *“Ata ishin nga njerëzit më të zgjedhur, megjithatë punonin e angazhoheshin dhe hanin nga puna që bënin me duart e tyre...”*³

Njeriu nuk duhet bërë jetë parazite, të presë gjithnjë nga të tjerët, por duhet të zbatojë



metoda të ndryshme të përfitimit. Më i vlefshëm është fitimi që e bën njeriu vetë, se sa kur kërkon lëmoshën nga të tjerët. Jo rastësisht, i Dërguari i Allahut tha: “Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, më mirë është që ndonjëri nga ju ta marrë litarin e të bartë mbi shpinën e tij dru, se sa të vijë e të kërkojë (lëmoshë) nga ndokush, pavarësisht nëse i jep apo jo.”⁴

E rëndësishme është që fitimi të jetë në suaza të hallallit, të mos jetë fitim haram, ngase një gjë e tillë nuk lejohet. I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Njerëzve do t’iu vijë një kohë kur nuk do të kenë kujdes (nuk do të mërzhiten) nëse është marrë fitimi prej hallallit (formës së lejuar) apo prej haramit (formës së ndaluar).”⁵

TRAJTIM NJERËZOR NDAJ PUNËTORIT

Erdhi Islami dhe punëtori ishte tejet i shtypur, robërit ishin të shumtë dhe bënë punë të rënda e të mundimshme, ku një pjesë e madhe vdisnin për punën e mundimshme që bënë në kërkim të lirisë.

Profeti, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të, u bëri thirrje pronarëve të bizneseve që t’i trajtojnë punëtorët me dinjitet, të kenë dhembshuri për ta, të jenë të sjellshëm me ta

Punëtori ka të drejtë ekskluzive në hakun-pagesën për punën që kryen. I Dërguari i Allahut qartazi ua bëri me dije gjithë atyre që kanë punëtorë se haku i tyre duhet të kryhet domosdo. Ai tha: “Paguajani hakun punëtorit para se t’i thahet atij djersa e ballit.”

dhe të mos i ngarkojnë ata me punë që nuk mund ta përballojnë. Ai përveç kësaj, kërkonte nga shokët e tij që punëtorët dhe robërit që i kishin, t’i trajtonin si vëllezër. Kjo ishte e papranueshme në atë shoqëri dhe për atë kohë, ngase ajo shtresë ishte shumë e ultë dhe ishin të privuar nga të drejtat themelore të jetës. Të tillët ishin të privuar edhe nga veshmbathja edhe nga ushqimi, andaj edhe i Dërguari i Allahut, me qëllim që ta ndryshojë në praktikë trajtimin e punëtorëve të tillë, duke i trajtuar me dinjitet, ai i quajti vëllezër, dhe kërkoi që ata të trajtohen me dinjitet e nder: “Vëllezërit tuaj janë mbrojtësit tuaj. Allahu i ka vendosur ata nën duart (kujdesin) tuaja. Andaj, kush e ka vëllain e tij nën kujdes, le ta ushqejë nga ajo që vetë ushqehet dhe ta veshë atë siç vishet vetë. Mos i rëndoni ata me atë që nuk munden ta bëjnë, e nëse i rëndoni, atëherë ndihmohini ata.”⁶

Nga kjo kuptohet se përveç dinjitetit të punëtorëve dhe nderit të tyre, i Dërguari i Allahut, paqja e Allahut qoftë mbi të, kërkoi prej pronarëve që të mos ketë barriera e ndasi, por raportet e tyre të jenë vëllazërore, përndryshe nëse nuk janë të tilla, atëherë pronari do ta shoh veten tejet të privilegjuar e punëtorin do ta trajtojë si një rob e të nënçmuar. I Dërguari shkoi deri në atë pikë sa që kërkoi që kujdesi i pronarëve ndaj



punëtorëve të jetë edhe në veshmbathje dhe ushqim, e jo të diskriminohen. Gjithashtu kërkoi që në punë të mos rëndohen, ngase nuk do të mund ta bëjnë një gjë të tillë, ose e bëjnë, por me vështirësi të madhe. E në rast se detyrohen për një gjë të tillë, i Dërguari i Allahut, u dha pronarëve mesazh të qartë, që të ndihmohen punëtorët dhe punën e rëndë e të mundimshme ta bëjnë së bashku.

HAKU I PUNËTORIT PËR PUNËN QË KRYEN

Përcaktimi i pagës komform punës që e kryen është në pajtim me parimet e Islamit dhe kjo ndikon që të largohen mosmarrëveshjet dhe konfliktet e mundshme mes punëdhënësit dhe punëtorit. Islami kërkon që palët të dakordohen që në fillim e të mos lihen gjërat pa qartësuar, ngase kjo largon manipulimet nga të dyja palët dhe flakë dyshimet mes tyre.

Kur kushtet dhe përgjegjësitë të jenë të qarta, atëherë puna nga punëtori duhet të jetë në nivel dhe paga nga ana e punëdhënësit nuk duhet të diskutohet. Punëtori ka të drejtë ekskluzive në hakun-pagesën për punën që kryen. I Dërguari i Allahut qartazi ua bëri me dije gjithë atyre që kanë punëtorë se haku i tyre duhet të kryhet domosdo. Ai tha: “Paguajani hakun punëtorit para se t’i thahet atij djersa e ballit.”⁷

Ky është një mesazh i qartë nga i Dërguari i Allahut për të pasurit dhe bizneset që kanë punëtorë, që ka për qëllim të drejtën e pagës së punëtorit, pa vonesë dhe pa zvarritje.⁸ Fjalët “para se t’i thahet atij djersa e ballit” është metaforë e detyrimit për të marrë iniciativën që pasi të kryhet puna, punëtori ta marrë hakun e vet. Djersitja e ballit nënkupton angazhimin e punëtorit dhe mundin e tij. Në rast se nuk ia jep hakun për punën që ka bërë, ai ka bërë mëkat dhe padrejtësi ndaj punëtorit të tij. Ai që qëllimisht e privon punëtorin nga haku i pagës, pa të drejtë, në Ditën e Gjykimit, i Dërguari i Allahut do të jetë armik i tij. Në hadithin kudsij thuhet: “Për tre persona në Ditën e Gjykimit jam armik: për atë i cili ka premtuar diçka ne emrin Tim dhe nuk e ka zbatuar, personi i cili do të shesë njeriun e lirë si rob dhe personi i cili do të marrë punëtor që të bëjë punën e vetë dhe ai nuk do t’ia paguaj hakun.”⁹

Nga kjo rezulton se ai që nuk ia jep hakun punëtorit të tij, në Ditën e Gjykimit, do ta ketë barrë të madhe dhe do të ballafaqohet me punëtorin e tij të privuar, i cili do ta ketë mundësinë e hakmarrjes, ditë kur nuk do të ketë vlerë paraja, fama e as pozita. Gjithashtu hadithi tregon për kërcënimin real nga ana e të Plotfuqishmit ndaj atij që e han hakun e

punëtorit të tij, ngase Allahu do të jetë armik ndaj tij, e kjo tregon më së miri për peshën e këtij mëkati.

Ibën Ashuri, kur flet për këtë fakt, tregon se marrja e të drejtës së punëtorit dhe privimi nga paga e tij, ishte realisht veprim me të cilin karakterizohej koha e injorancës, ku i forti e shtypte të dobëtin, i pasuri e shfrytëzonte të varfrin dhe pasuria e të dobëtit merrej nga i fuqishmi.¹⁰

MIRËSJELLJA NDAJ PUNËTORIT

Punëtori meriton të trajtohet njerëzishëm nga punëdhënësi i tij. Është me rëndësi që raportet mes tyre të jenë në nivel, ngase edhe puna do të jetë më efikase. I Dërguari i Allahut

me vizionin e tij kërkonte që pronarët të tregonin mirësjellje të lartë ndaj punëtorëve, ndërsa nga punëtorët kërkonte që punën ta bënin në formën më të mirë të mundshme, ndaj edhe tha: “Me të vërtetë Allahu kërkon që kur dikush nga ju të punojë një punë, ta bëjë atë në formën më të mirë të mundshme.”¹¹

Mirësjellja ndaj punëtorit dhe puna e punëtorit në formën më të mirë e bën ambientin më të mirë e më të përshtatshëm dhe krijon një klimë të favorshme për një veprimtari shembulllore, ku në vend të konfrontimit, ata krijojnë ura bashkëpunimi dhe raporte të shkëlqyera.

Enes ibën Maliku tregon se i kishte shërbyer për dhjetë vjet të plota të Dërguarit të Allahut, e që asnjëherë nuk e kishte qortuar për një punë që e kishte bërë apo për një gjë që nuk e kishte bërë. Ai ishte me të vërtetë një shembëlltyrë dhe model për gjithë të tjerët në respektimin e njeriut dhe trajtimin e duhur.

PUNA ËSHTË AMANET DHE DO TË KETË LLOGARI PËR TË

Secili duhet ta gjejë punën që i përshtatet dhe në të cilën ndihet rehat e komod. Jo çdo punë njeriu mund ta kryejë. Besimtari duhet ta gjejë vetën në bazë të kualifikimit të tij, e jo ngarendja ndaj një punë që fitimi mund të jetë i madh, por që përgatitja e tij nuk është adekuate dhe ndoshta nuk mund t’ia jep ‘hakun’ punës së tillë. Nga jeta e të Dërguarit të Allahut kemi një shembull brilant që tregon se devotshmëria dhe puna janë dy gjëra të ndara mes vete. Mund të jetë njeriu shumë i devotshëm, por jo edhe adekuat për një punë të caktuar, e këtë më së miri e kuptojmë kur Ebu Dherri kërkoi një punë nga i Dërguari i Allahut, gjegjësisht që i Dërguari i Allahut ta përdorte në një pozicion të caktuar. I Dërguari i Allahut e vendosi dorën e tij mbi kraharorin e Ebu Dherrit dhe i tha: “O Ebu Dherri! Ti je i dobët, e kjo punë është amanet-

Shfrytëzimi
tejmase i
punëtorit për
qëllim të
pronarit, duke e
dëmtuar të
parin, është
veprim që bie
ndesh me
parimet e
Islamit.



përgjegjësi, e në Ditën e Gjykimit do të ketë poshtërim e pendim (për ata që nuk e kryejnë si duhet), përpos ndaj atij që ia ka dhënë hakun punës dhe e ka kryer siç ka qenë e caktuar.”¹²

Hadithi është indikacion i qartë se në punët që njeriu nuk do të mundet t’ia japë hakun, do të ketë përgjegjësi të madhe, për çka edhe lajmëroi i Dërguari i Allahut se do të ketë përbuzje e nënçmim në Ditën e Gjykimit dhe pendim të thellë.

E DREJTA E PUSHIMIT

Punëtori ka të drejtë në pushimin ditor, javor, por edhe vjetor, varësisht nga kushtet e marrëveshjes. Ato duhet të zbatohen në përpikëri, përndryshe çdo ndryshim pa lejen dhe miratimin e punëtorit, është shkelje dhe mëkat. I Dërguari i Allahut thoshte: “Myslimanët duhet t’u përmbahen kushteve të tyre.”¹³

Se kjo pikë shkelet, mjafton të përcillen edhe konkurset që bëhen te ne, ku në shumë prej tyre vendosen kushte që në fillim, e të cilat janë në kundërshtim me etikën e punës, si përballimi i punës me presion, ku përmendet shpesh në konkurse. Përveç kësaj stërzgjatja e orarit dhe shtyrja e pushimit janë faktorë të tjerë që e ngufatin të drejtën e punëtorit dhe e bëjnë atë pesimist në atë punë. Një gjë të tillë Islami e refuzon kategorikisht, përpos me marrëveshje paraprake me punëtorin, apo me shpërblim shtesë për punën shtesë që punëtori bën.

Shfrytëzimi tejmasë i punëtorit për qëllim të pronarit, duke e dëmtuar të parin, është veprim që bie ndesh me parimet e Islamit.

Pronarët e bizneseve duhet të jetë të mëshirshëm ndaj punëtorëve, por edhe punëtorët duhet të jenë të ndërgjegjshëm ndaj tyre. Le të jenë të mëshirshëm ndaj tyre, ngase i Dërguari i Allahut tha: “Të mëshirshmit i mëshiron Mëshiruesi. Mëshirojeni atë që është në tokë, që t’iu mëshirojë Ai që është në qiell.”

MESAZH PËR FUND

Kur gjërat qartësohen që në fillim dhe saktësohen kushtet dhe përgjegjësitë, atëherë çdo gjë më pas do të jetë më e lehtë dhe çdo gjë shkon sipas kushteve dhe përgjegjësi të parapara. E kur gjërat që në fillim janë të komplikuar dhe lënë dykuptimësi apo nuk janë të qartësuara sa duhet, atëherë edhe mosmarrëveshjet dhe konfliktet janë të gatshme.

Punëtori duhet ta ketë së pari trajtimin e duhur, se ai është njeri dhe duhet të respektohet maksimalisht, e jo të shkelet e t’i shkallmohet krenaria dhe dinjteti i tij. Ai kudo që punon dhe çfarë pune që bën, duhet ta ndiejë veten krenar se është duke u angazhuar dhe jo duke u bërë barrë e tjerëve.

Ai nuk duhet të trajtohet si rob. Pronarit ia kryen punën që ai ka nevojë, ndërsa punëtori shpaguehet për punën që bën. Përlula dhe nënçmimi nuk janë pjesë e fesë dhe nuk duhet të vijnë në shprehje.

Ai nuk duhet të ngarkohet më tepër se që janë mundësitë e tij. Ai duhet ta bëjë punën sipas kapacitetit që ka e jo të detyrohet të punojë tejmasë, ngase kjo e gërryen shpirtin e tij dhe e demoralizon për jetën e tij.

Ai duhet të paguhet konform punës që bën, e jo t’i hahet haku apo të privohet nga paga e tij. Privimi nga haku i tij është padrejtësi, që nëse nuk eliminohet ajo padrejtësi në këtë botë, në botën tjetër do të jetë shumë e kushtueshme për atë që e ka bërë. Secili t’i mendojë pasojat e së nesërme kur do të dalë para Allahut.

Punëtori duhet ta respektojë orarin e punës dhe punën ta kryejë me përgjegjësi të madhe e përkushtim, e jo shkel e shko, ngase puna është amanet dhe për punën që kryen do të japë përgjegjësi e do të gjykohe.

Ai meriton pushimin, si javor, ashtu edhe vjetor. Ai siç ka të drejta e obligime ndaj të tjerëve, ashtu ka të detyrime e përgjegjësi edhe ndaj vetes dhe trupit të tij.

1 Buhariu në Sahihun e tij, nr. 2072.

2 Ibën Maxhe në Sunen, nr.2150.

3 Nevevi, *El Minhaxh Sherh Sahihi Muslim*, Dar ihja et Turath el Arebij, Bejrut, 1392h, v.XV, f.135.

4 Sahihul Buhari, nr. i hadithit 1377, El Muvetta, nr. i hadithit 1588.

5 Buhariu në Sahihun e tij, nr. 2059.

6 Buhariu në Sahih, nr. 30; Muslimi në Sahih, 1661.

7 Ibën Maxhe në Sunen.

8 El Maverdi, *El Havi el Kebir*, v.IX, f.211.

9 Buhariu në Sahih, nr. 2114.

10 Ibën Ashur, *Et Tahriru ve-t Tenviru*, Dar et-Tunisijeh lin Neshr, pa vit botimi, v.II, f.187

11 Buhariu në Sahih.

12 Muslimi në Sahih, nr, 1825.

13 Hakimi në Mustedrek, nr. 2310.

Puna si kërkesë për mbijetesë dhe si detyrim fetar islam

Dr. Rijad Imeri

Krijuesi i Plotfuqishëm nuk krijoi ndonjë krijesë, vetëm se ia krijoi asaj edhe kushtet optimale për të ekzistuar, si dhe e pajisi atë me kapacitete të mjaftueshme për t'u furnizuar dhe për të jetuar. Këtë fakt e potencon Kurani famëlartë kur flet për vendimin hyjnor në lidhje me njeriun e parë mbi sipërfaqen e tokës: *"...Në tokë do ta keni vendqëndrimin (vendbanimin) dhe furnizimin tuaj gjer në një kohë (të përcaktuar)..."* (El Bekare, 36).

Njeriu u dallua nga krijesat e tjera me dhunti të shumta, e ndër to atij iu dhurua intelijenca, që me të të jetë në gjendje ta përmbush misionin e tij mbi këtë planet në formën më të bukur dhe të jetë i aftë ta organizojë jetën e tij, ta planifikojë dhe ta menaxhojë atë. Por, njëkohësisht atij iu shtuan edhe obligimet dhe përgjegjësitë e tij. Zoti i Madhëruar nuk e privoi njeriun nga mirësitë e begatitë e tokës, të cilat i krijoi dhe me të cilat e zbukuroi atë, përkundrazi e urdhëroi që t'i shijojë ato, por, përkaj kësaj, kërkoi nga ai që të përkujdeset për to, t'i kultivojë ato, mos të bëhej përbuzës, injorues e shkatërrues, sepse kjo do të ishte një mosmirënjohje, e cila do të shkaktoje trazira në këtë planet dhe do ta shëmtonte atë, kështu do ta meritonte hidhërimin e Krijuesit të tij. Kjo do të ishte një vetshkatërrim për vetë njeriun dhe një përfundim i tmerrshëm për të. Këtë paralajmërim, Zoti i gjithësisë ua kumtonte njerëzimit gjeneratë pas gjenerate përmes

"O ju njerëz,
me të vërtetë
Zoti është i
mirë dhe nuk
pranon tjetër
pos të mirës."

(Muhamedi, a.s.)

ambasadorëve hyjnorë, e të cilët ishin profetët e Zotit, duke thënë: *"...Hani nga të mirat që u dhuruam, e mos u bëni përbuzës se do t'u godasë hidhërimi Im, e atë që e zë hidhërimi Im, ai vetëm se ka mbaruar."* (Taha, 81).

Nga kjo kërkesë fundamentale nuk ishin të përjashtuar as edhe vetë të përzgjedhurit hyjnorë dhe këtë më së bukur e sqaron kjo fjalë profetike, ku Muhamedi a.s. u drejtohej pasuesve të tij duke u thënë: "O ju njerëz, me të vërtetë Zoti është i mirë dhe nuk pranon tjetër pos të mirës. Dhe me të vërtetë Zoti i urdhëroi besimtarët me atë që i urdhëroi pejgamberët duke thënë: *"O pejgamberë! Hani nga të mirat dhe punoni vepra të mira! Unë me të vërtetë, e di mirë çka ju punoni!"* (El Muminun, 23) dhe tha: *"O ju që besuat, hani nga të mirat që u kemi dhënë, dhe falënderoni Allahun, nëse jeni që vetëm Atë e adhuronit."* (El Bekare, 172)..."¹

Pra urdhri për t'i shijuar të mirat dhe begatitë e tokës nënkupton edhe formën dhe mënyrën e pastër për të arritur te to, ngase Zoti nuk e pranon një të mirë përderisa ajo nuk është fituar në formë të mirë e të drejtë. E për t'ia treguar rrugën hyjnore njeriut dhe për të mos e lënë atë të hamendësuar në udhëkryqet e jetës, Ai dërgoi pejgamberë, që ata të jenë shëmbëlltyrë jo vetëm në ritualet fetare, por edhe në dimensionet e tjera të jetës, ngase ky ishte dhe është kuptimi i mirëfilltë i fesë dhe mbi këto norma mendohej Muhamedi a.s. ta edukonte dhe ta integronte





shoqërinë islame duke i udhëzuar me udhëzim hyjnor e duke i nxitur të stoliseshin me vlerat më të larta njerëzore, duke thënë: “Nuk ka ngrënë njeriu diçka më të këndshme e më të mirë se sa atë që hanë nga puna e dorës së tij dhe profeti i Zotit, Davudi, hante nga puna e dorës së tij.”²

Me këtë, Pejgamberi a.s. donte që t’ua sqaronte gjeneratës së parë se angazhimi me ritualet fetare nuk do të duhej në asnjë mënyrë të jetë arsye që njeriu të jetë pasiv në aspektet e tjera të jetës dhe të neglizhojë në përmbushjen e obligimeve jetësore dhe nëse ndokush do të duhej të lirohej nga ky aktivitet, atëherë do të ishin pikërisht pejgamberët e Zotit, për shkak të angazhimit të tyre maksimal në kumtimin e fjalës hyjnore, por jo, përkundrazi Zoti solli shembuj të shumtë në Kuranin fisnik të pejgamberëve që fitonin dhe hanin nga vetë dora dhe djersa e tyre. Ndër ta Musai a.s., ishte bari delesh për dhjetë vite radhazi, Jusufi a.s., ishte menaxher i thesareve shtetërore, Davudi a.s., i përpunonte parzmoret, Zekeriai a.s., ishte zdrukthëtar, e Muhamedi a.s., përveç që e kaloi një pjesë të jetës së tij duke u marrë me tregti, ai me mburrje tregonte edhe për aktivitetet e tij në fëmijërinë e tij. Njëherë përdërisa u tregonte shokëve të tij se çdo pejgamber i Zotit kishte qenë edhe bari delesh, një nga të pranishmit kureshtar i cili nuk e njihje fëmijërinë e të Dërguarit a.s. pyeti:” Edhe ti o i Dërguar i Zotit ke qenë bari delesh?!” Muhamedi a.s. buzëqeshi edhe tha: “Po edhe unë kam qenë bari delesh, i ruaja delet e banorëve të Mekës për disa qindarke.”³ Në njërën anë Muhamedi a.s. u jepte kurajë atyre që ishin aktivë në jetë dhe të cilët mundoheshin ta ekuilibronin aspektin

Musai a.s., ishte bari delesh për dhjetë vite radhazi, Jusufi a.s., ishte menaxher i thesareve shtetërore, Davudi a.s., i përpunonte parzmoret, Zekeriai a.s., ishte zdrukthëtar, e Muhamedi a.s., përveç që e kaloi një pjesë të jetës së tij duke u marrë me tregti, ai me mburrje tregonte edhe për aktivitetet e tij në fëmijërinë e tij.

material me atë shpirtëror, dhe në anën tjetër orvatej në thyerjen e barrierave, të cilat i kishin ngritur njerëzit duke e përbuzur aktivitetin e një pjese të shoqërisë, e të cilët preferonin të qëndronin pasiv sesa të angazhoheshin me gjëra të tilla.

Për ta nxjerrë një shoqëri nga dekadencia e materializmit dhe për ta ngritur atë gjer në atë nivel sa të bëhej model për shoqëri të tjera nuk ishte përgjegjësi e lehtë mbi supet e Muhamedit a.s.. Pikërisht për këtë vinin mesazhet hyjnore një pas një për ta lehtësuar këtë proces vendimtar në historinë e njerëzimit dhe për ta kalitur personalitetin e besimtarëve, i cili assesi nuk duhej të ndërtohej mbi lakmi të shfrenuar e as në pasivitet të urryer, dukuri të cilat e fundosin një shoqëri dhe shkaktojnë trazira me përmasa fatale. Për këtë Zoti i Madhërishëm iu drejtua besimtarëve me këto fjalë: “O ju të cilët keni besuar, kur të thirreni për namaz në ditën e premte, nxitoni për ta përmendur Zotin dhe pezulloni shitblerjen; kjo është më mirë për ju, nëse e dini! E kur të përfundojë namazi, atëherë shpërndahuni nëpër tokë dhe kërkonin nga begatitë e Zotit dhe përmendeni Zotin shumë, nëse dëshironi të jeni të shpëtuar.” (El Xhuma, 9-10).

Zoti i gjithësisë i filloi këto citate me “O ju të cilët keni besuar” duke ia rikujtuar besimtarëve besëlidhjen e tyre me Krijuesin e tyre, besim i cili duhet ta rregullojë sistemin e jetës së tyre, t’ua sqarojë prioritetet e tyre në jetë dhe t’ua tregojë formën e furnizimit material dhe atij shpirtëror, sepse vetëm në këtë formë arrihet shpëtimi.

Sejid Kutubi në komentimin e citateve të mësipërme thotë: “Ky është ekuilibri me të

cilin karakterizohet feja islame. Ekuilibër në mes të kërkesave të jetës mbi tokë, punë, orvatje, angazhim e fitim dhe në mes izolimit të përkohshëm të shpirtit nga kjo atmosferë dhe shkëputje e preokupimit të zemrës me to dhe orientimit të saj në përmendje të Zotit të gjithësisë. E kjo është domosdoshmëri për gjallërinë e zemrës, pa të cilën nuk mund të përmirësohet, e as të furnizohet, e as ta përmbush amanetin dhe përgjegjësinë finale. Përmendja e Allahut është e domosdoshme në kërkimin e furnizimit, e ndjenja e prezencës së Zotit është ajo e cila e shndërron aktivitetin e furnizimit material në adhurim. Mirëpo megjithëkëtë, ndonjëherë është i nevojshëm rikujtimi i sinqertë të Zotit, dhe ndërprerja e plotë dhe shkëputja e tërësishme nga këto aktivitete ditore, siç ceket në këto citate.”⁴

Kurse Arrak b. Malik, një nga dijetarët e dalluar të gjeneratës së dytë, pasi e falte namazin e xhumasë drejtohej për në punën e tij dhe te porta e xhamisë duke aluduar në këto dy citate i ngrite duart e tij dhe thoshte: “O Zoti im, unë iu përgjigja thirrjes Tënde dhe e plotësova obligimin Tënd, e po largohem nga xhamia ashtu siç më ke urdhëruar, më furnizo nga begatitë e Tua, sepse Ti je furnizuesi më i mirë!”⁵

Ky ishte morali i gjeneratave të arta në Islam, të cilët e kuptonin se adhurimi nuk është ikje nga realiteti dhe angazhimi me çështje të kësaj bote, por, rikujtim i vlerave, rifreskim i besëlidhjes me Zotin që ka besimtari dhe reflektim në aktivitetet e tij ditore, qoftë në punë, në shitblerje apo në profesion.

E Profeti i Zotit a.s. i lavdëronte këta njerëz pa të cilët edhe jeta nuk do të zhvillohej në mënyrë normale duke thënë: “Tregtari mysliman i cili është besnik dhe i sinqertë do të jetë me peygamberët, të sinqertit dhe dëshmorët në ditën e llogarisë.”⁶ Ai i inkurajonte shokët e tij që të jenë aktivë në jetë, të angazhohen e të punojnë, të bëhen të pavarur e mos të presin nga lëmosha e të tjerëve, e as të bëhen barrë e tjetërkujt përderisa Zoti u ka dhënë shëndet dhe mundësi fizike për të punuar, sa që betohej e thoshte: “Pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti im, që ta marrë ndonjëri prej jush konopin e tij dhe të bartë dru mbi shpinën e tij, e t’i shes në treg e pastaj të ushqehet me të, është më e mirë për të se sa të shkojë tek një i pasur e ta zgjat dorën e tij me shpresë që ta ndihmoj, e ndoshta edhe do ta refuzoj.”⁷

Muhamedi a.s. si edukator i një shoqërie mbi vlera të larta të moralit nuk mjaftohej me kaq, por vazhdonte me hapin e dytë dhe më të rëndësishëm drejt suksesit të një individi dhe

Abdullah b. Mesudi r.a. ka thënë: “Unë e urrej ta takoj një njeri duke qëndruar së koti, i cili nuk është i angazhuar as në çështje të kësaj bote (dynjasë) e as në çështje të botës tjetër (ahiretit).”

një shoqërie, i cili ishte që njeriu të jep maksimumin në punën apo profesionin e tij dhe të arrij nivelin e perfeksionimit të asaj pune, mjeshtërie apo profesioni, për këtë ai thoshte: “Me të vërtetë Allahu dëshiron që kur ndonjëri nga ju ta bëjë ndonjë punë, ta zotërojë (perfeksionojë) atë.”⁸

Ky ishte sekreti i myslimanëve të mëherëshëm, të cilët zotëruan, perfeksionuan e avancuan shumë shkenca, si matematikën, astronominë, medicinën, sociologjinë, kiminë etj., por edhe u dalluan në fusha të ndryshme, qofshin ato detare apo tokësore, e arkitektura e Andaluzisë mbetet ende dëshmi e freskët në historinë njerëzore se myslimanët aty ku ndodheshin, aty gjallërohej shkenca dhe lulëzonte civilizimi.

Kurse kultura e njeriut pasiv, e cila e largon atë nga rrjedhat e jetës ishte dhe mbetet gjë e urryer në fenë islame. Abdullah b. Mesudi r.a. ka thënë: “Unë e urrej ta takoj një njeri duke qëndruar së koti, i cili nuk është i angazhuar as në çështje të kësaj bote (dynjasë) e as në çështje të botës tjetër (ahiretit).”⁹ Kurse Urve b. Zubejri r.a. thoshte: “Gjëja më e shëmtuar në këtë botë është kotësia.”¹⁰

Pra kërkimi i furnizimit si dhe shumimi i pasurisë brenda konditave islame, duke mos i mashtruar njerëzit, duke mos ua marrë pasurinë e tyre pa të drejtë dhe duke mos i ndjekur rrugët ilegale, mbetet obligim islam, i cili bazohet në këtë thënie profetike: “Kërkimi i të lejuarës (hallallit) është obligim i çdo myslimani.”¹¹ dhe fjalës hyjnore, e cila na i rikujton begatit e Krijuesit dhe Furnizuesit tonë në këtë planet: “Ai është që tokën juve ua bëri të përshtatshme (të nënshtruar), andaj, ecni nëpër zonat (viset) e saj dhe shfrytëzoni begatitë e Tij, meqë vetëm tek Ai është e ardhmja.” (Mulk, 15).

1 Muhamed b. Isa et Tirmidhi, *Sunen et Tirmidhi*, (5, Egjipt, Mektebetu Mustafa El Halebi), 2989.

2 Muhamed Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, (3, Damask, Dar Ibën Kethir, 1993), 1966.

3 El Buhari, *Sahih el Buhari*, (2), 2134.

4 Sejid Kutub, *Fij Dhilal al Kuran*, (6, Kairo, Dar Ash-Shuruk), 3570.

5 Abdurrahman b. Muhamed ibën Ebi Hatim, *Tefsir el Kuran el Adhim*, (10, Arabia Saudite, Mektebetu Nezar Mustafa Albaz), 3356.

6 Muhamed Jezid ibën Maxheh, *Xhami es Sunen*, (Jubail, Dar es Sidik), 460.

7 Ahmed bin Hanbel, *Musned Ahmed*, (3, Muesestu er-Risaleh), 26.

8 Sulejman b. Ahmed et Taberani, *El Muxhem el Ewsat*, (1, Kajro, Dar el Hamejin) 275.

9 Ismail b. Muhamed el Axheluni, *Keshf el Khafa*, (1, Kajro, Mektebetu el Kuds), 250.

10 El Axheluni, *Keshf el Khafa*, (1) 250.

11 Et Taberani, *El Muxhem el Ewsat*, (8) 258.

Devotshmëria si virtyti më i madh

Dr. Sedat Islami

Devotshmëria, që në thelb nënkupton frikën nga Krijuesi, nuk është thjesht një ndjenjë; përtej kësaj është dije dhe besim, dije se je nën vëzhgimin e Zotit dhe besim se do të dalësh para Tij për të dhënë llogari. Devotshmëria është mençuri dhe maturi për t'i bërë gjërat e duhura dhe për t'u larguar nga të tjerat, është një emërues i përbashkët i shumë vlerave dhe virtyteve, është përkatësi. Profeti Muhamed a.s., ka thënë: “Vini re, bijtë e filanit nuk janë miqtë e mi. Miqtë e mi janë Allahu dhe besimtarët e mirë.”¹; “...Unë vetëm të devotshmit i kam miq!...”² Këtu mbase qëndron arsyeja pse disa dijetarë, devotshmërinë, e kanë listuar si virtytin kryesor.³ Ky konstatim ka bazë edhe në tekste fetare. Profeti Muhamed a.s., siç qëndron në Sunenin e Tirmidhiut, ka thënë: “...ndërsa fisnikëria në

fakt është devotshmëria.”⁴ Pra, tregues i fisnikërisë, që kuptimisht përmbledh të gjitha tiparet e mira, është devotshmëria.

KONCEPTI PËR DEVOTSHMËRINË

Devotshmëria (ar. et takva) në esencë nënkupton kryerjen e urdhëresave dhe largimin nga ndalesat për t'iu shmangur ndëshkimit. Aliu r.a. e ka definuar devotshmërinë kështu: “Frika nga Krijuesi, të vepruarit sipas Kuranit, të kënaqurit me pak dhe përgatitja për ditën e udhëtimit.”⁵

Pra, devotshmëria është koncept për jetën, është guidë e jetës së lumtur në këtë dhe botën tjetër, sepse, t'ia kesh frikën Allahut, nënkupton të mos bësh gjëra të ndaluara e kështu të shpëtosh nga zjarri; të veprosh sipas Kuranit, nënkupton të ndjekësh rrugën e drejtë; të kënaqesh me pak, nënkupton të mos mashtrohesh nga materializmi i kësaj bote dhe, të përgatitesh për ditën e udhëtimit, nënkupton të mendosh për botën tjetër, për vendqëndrimin e përhershëm.

Këtë konceptim për jetën dhe fetarinë e vërtetë e gjejmë dhe në definicionin që Omer bin Abdulazizi ia ka bërë devotshmërisë: “Devotshmëria nuk manifestohet duke agjëruar ditën e falë namaz natën, dhe as në kombinimin e gjërave ndërmjet tyre; devotshmëria nënkupton ta braktisë atë që të është ndaluar dhe ta bësh atë që të është obliguar.”⁶

Aliu r.a. e ka definuar devotshmërinë kështu: “Frika nga Krijuesi, të vepruarit sipas Kuranit, të kënaqurit me pak dhe përgatitja për ditën e udhëtimit.”



Pra, devotshmëria shprehet edhe jashtë, në raport me të tjerët dhe gjërat e tjera. Të parët kanë thënë se devotshmëria manifestohet te dinari dhe dërhem, pra te fitimi, a po e bën hallall apo haram.

Devotshmëria nënkupton të ndjekësh rrugën nga parimi dhe njohja, njohja e asaj që të bën dobi dhe tjetrës që të dëmton. Për këtë shkak, si fryt të saj, dijetarët kanë përmendur udhëzimin e drejtë dhe dallimin ndërmjet të mirës dhe të keqes. Ata i janë referuar ajetit: “O besimtarë! Nëse i frikësoheni Allahut, Ai do t’ju japë aftësinë e të gjykuarit drejt, do t’ju lirojë nga gjynahet tua dhe do t’ju falë. Allahu zotëron mirësi të madhe.” (El Enfalë, 29).

Këtë kuptimin e ruajtjes nga mëkatet duke i njohur, Ebu Hurejre r.a., e ka shpjeguar në mënyrë figurative me ruajtjen nga gjembat ose ferrat. Kur ishte pyetur nga dikush se çfarë është devotshmëria kishte thënë: “Si vepron kur ta përshkosh një rrugë me ferra?” Kujdesem ku e vë këmbën, nëse ka ferra, largohem ose, o e kapërcej o e prapësoj këmbën, pra ruhem nga shkelja në ferr. Kjo është devotshmëria! – i kishte thënë.⁷ Kjo nënkupton jo vetëm braktisjen e mëkateve të mëdha, por edhe të voglave. Pra, përderisa është dije, atëherë devotshmëria nënkupton ruajtjen e shtuar, kujdesin e shtuar, ruajtjen, figurativisht, edhe të shkëljes në ferra të vogla. Këtë kuptim e ka përmbledhur bukur në një varg poetik Ibën Muteziu:

*Braktis mëkatet, të mëdha e të vogla qofshin,
kjo është devotshmëri,*


*vepro si ai që ecën mbi tokën me ferra e
tregon syçelëtësi.*

*Mos nënvlerëso asnjë mëkat të vogël, sepse
kodra e madhe është bërë nga gurë të vegjël.⁸*

Nga këtu, nuk e kanë parë devotshmëri të plotë nëse njeriu i druhet një gjeje që nuk e njeh. Maruf Kerhi citohet të ketë thënë: “Si mund të jetë i devotshëm ai që nuk e di se prej çfarë duhet të ruhet?”⁹

Devotshmëria nënkupton ruajtjen me dashuri. Nuk është frikë nga dikush që të bën keq, nga dikush që nuk të do dhe që nuk e do, nga dikush që e urren. Jo, devotshmëria nënkupton ruajtjen me mirënjohje e falënderim. Kështu e ka përkufizuar Ibën

Këtë kuptim e
ka përmbledhur
bukur në një
varg poetik
Ibën Muteziu:
*Braktis mëkatet,
të mëdha e të
vogla qofshin,
kjo është
devotshmëri,
vepro si ai që
ecën mbi tokën
me ferra e
tregon syçelëtësi.
Mos nënvlerëso
asnjë mëkat të
vogël, sepse
kodra e madhe
është bërë nga
gurë të vegjël.*



Mesudi r.a.: “Devotshmëria nënkupton që t’i bindet Allahut dhe të mos kundërshtohet, të përmendet e mos të harrohet dhe të falënderohet e të mos mohohet.”¹⁰ Devotshmëria nuk nënkupton vetëm braktisjen e asaj që parimisht është e ndaluar, por edhe të disa gjërave që mund të jenë në esencë të lejuara, por të panevojshme ose, siç thotë Ebu Derda r.a., mund të kihet frikë se të çojnë në haram.¹¹ Mbase nga këtu dijetari i madh, Sufjan Theuriu, ka konstatuar se të devotshmit janë quajtur kështu, sepse i janë ruajtur asaj që nuk i ruhet,¹² pra hallallit. Të devotshmit, nga kjo perspektivë, janë njerëz që kanë punë me veten e tyre. Ata aq shumë vetëquhen saqë, në raport me vetveten, janë më të ashpër se që ortaket në tregti mund të jenë me njëri-tjetrin. Mejmun bin Mihrani ka thënë: “I devotshmi kërkon llogari më shumë nga vetja e vet se që një ortak koprrac mund të kërkojë nga ortaku i vet.”¹³

RËNDËSIA E DEVOTSHMËRISË

Nëse kemi parasysh kuptimet që përmendëm te koncepti për devotshmërinë, atëherë mund ta marrim me mend se sa e rëndësishme është ajo për shëndetin shpirtëror të besimtarit. Kurani dhe Suneti na



kanë shpalosur detaje rreth kësaj rëndësie. Po përmendim disa tekste vetëm sa për ilustrim:

Allahu, dëshminë la ilahe il-la Allah!, e ka quajtur fjalë e devotshmërisë, përkushtimit: “Dhe, kur në zemrat e mohuesve u shfaq zellaria pagane, Allahu zbriti qetësinë e Tij në zemrën e të Dërguarit të Tij dhe të besimtarëve e i bëri ata të mbështeten fort në fjalën e përkushtimit (ndaj Allahut). Ata kishin më të drejtë e qenë më të denjë për të. Allahu është i Gjithëdhijshëm për çdo gjë.” (Fet’h, 26);

Është urdhër i Zotit për njerëzit mbarë, por për myslimanët në veçanti: “...O robërit e Mi, më kini frikë Mua!” (Zumer, 16); “O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj...” (En Nisa, 1); “O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!” (Ali Imran, 102);

Devotshmëria është porosi që profetët a.s., ua kanë përcjellë popujve të tyre: “Kujto kur vëllai i tyre, Nuhu, u tha: “Vallë, a nuk i frikësoheni ju Allahut?” (Shuara, 106); “Kujto kur vëllai i tyre, Hudi, u tha: “Vallë, a nuk i frikësoheni ju Allahut?” (Shuara, 124);¹⁴

Adhurimi është urë që të çon te devotshmëria. Adhurimi është qëllimi pse ekzistojmë dhe, nëse objektivë e tij është devotshmëria, atëherë kjo flet për pozitën që kjo e fundit ka në fe. Është si të thuash pika më e lartë e një çështje më të rëndësishme. Menjëherë pas besimit, adhurimi ka pozitën më të rëndësishme. Allahu i Madhëruar thotë: “O njerëz! Adhuroni Zotin Tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të ruheni (nga të këqijat).” (El Bekare, 21); “O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat.” (El Bekare, 183);

Devotshmëria nënkupton një lidhje të fortë me Zotin, një raport korrekt, një besim të fuqishëm, prandaj dhe vendi i saj është në zemër, ajo buron nga zemra, nga organi më me rëndësi në trup. Profeti Muhamed, paqja qoftë mbi të, ka thënë: “...Devotshmëria është ja, këtu!...”¹⁵ - duke aluduar në zemër.

FRYTET E DEVOTSHMËRISË DHE REFLEKTIMI I SAJ

Veçori e moralit islam është aspekti praktik i tij, pra reflektimi i tij në sjelljet dhe veprat e besimtarit. Devotshmëria, si kryevirtyt, gjithsesi se reflekton. Në vazhdim do të përmendim disa fusha ku vihet re ndikimi i devotshmërisë te besimtari.

• Besim i kompletuar me bindje e vepra

Devotshmëria nënkupton përfilljen e fesë dhe detyrave të saja. I devotshmi është besimtar që afrohet te Zoti duke e besuar dhe duke i kryer obligimet fetare. Allahu i Madhëruar thotë: “Ai është udhërrëfyes për të devotshmit, të cilët besojnë në të fshehtë, falin namazin dhe japin nga ajo që u kemi dhënë Ne; dhe për ata që besojnë në atë që të është shpallur ty (o Muhamed), në atë që është shpallur përpara teje dhe që me bindje i besojnë jetës tjetër. Ata janë udhëzuar në rrugë të drejtë nga Zoti i tyre dhe pikërisht ata janë të shpëtuarit.” (El Bekare, 2-3).

• Dashuria e Zotit

Allahu i Madhëruar thotë: “Jo! Por kushdo që plotëson premtimin e tij dhe ruhet nga të këqijat, (ta dijë se) Allahu, me të vërtetë, i do ata që janë të devotshëm.” (Ali Imran, 76).

• Mëshira e Zotit në të dyja botët

Allahu i Madhëruar thotë: “...ndërsa mëshira Imë përfshin çdo gjë. Atë do t’ua jap atyre që ruhen nga gjynahet e japin zeqatën, atyre që u besojnë shpalljeve Tona.” (Arafë, 156).

• Mënyrë e tërheqjes së ndihmës hyjnore

Allahu i Madhëruar thotë: “Vërtet, Allahu është me ata që e kanë frikë dhe që janë punëmirë.” (Nahl, 128).

• Strehë shpirtërore

Allahu i Madhëruar thotë: “O bijtë e Ademit, kur nga gjiri juaj të vijnë të dërguar që ju shpëtojnë shpalljet e Mia, atëherë

ata që ruhen nga të këqijat dhe kryejnë vepra të mira, nuk do të frikësohen e as do të pikëllohen.” (Arafë, 35).

- **Dritë e cila ndriçon rrugën drejt së vërtetës**

Allahu i Madhëruar thotë: “O ju (ithtarë të Librit) që besuat (në Musain dhe Isain), ruajuni Allahut dhe besoni në të Dërguarin e Tij (Muhamedin), se Ai do t’ju dhurojë pjesë të dyfishtë nga mëshira e Vet, do t’ju japë dritë, me ndihmën e së cilës do të ecni dhe do t’ju falë; Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.” (Hadid, 28).

Tejkalimin e gjendjeve të rënda, çfarëdo qofshin ato: shpirtërore, materiale... Allahu i Madhëruar thotë: “...Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t’i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi).” (Talak, 2); “...Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t’ia lehtësojë çështjen.” (Talak, 4).

- **Mënyrë e shtimit të begatisë dhe rritjes së mirëqenies**

Allahu i Madhëruar thotë: “Sikur banorët e atyre qyteteve të besonin dhe të ruheshin prej gjynaheve, Ne do t’u dërgonim bekime nga qielli dhe toka...” (Arafë, 96); “...Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t’i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi) dhe do t’i japë risk prej nga nuk e pret.” (Talak, 2-3).

- **Përgjdhje e shoqërisë mbi bazën e saj**

Allahu i Madhëruar thotë: “Atë Ditë miqtë do të bëhen armiq të njëri-tjetrit, përveç të drejtëve, që e kanë pasur frikë Allahun.” (Zuhruf, 67).

- **Forcë për ta fituar betejën me djallin**

Allahu i Madhëruar thotë: “Ata që i frikësohen Allahut, kur u vjen ndonjë mendim i lig nga djalli, i kujtojnë (urdhrat e Tij), e atëherë e shohin rrugën e drejtë.” (Arafë, 201).

- **Devotshmëria është furnizimi më i mirë për te Zoti**

Allahu i Madhëruar thotë: “...Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur!” (El Bekare, 197). Profeti a.s., dikush i kishte kërkuar këshillë, ndërsa ishte bërë gati për një udhëtim. Profeti a.s., ishte lutur për të: “Allahu të furnizoftë me devotshmëri!”¹⁶

- **Mënyrë e fitimit të shpërblimit të madh**

Allahu i Madhëruar thotë: “...Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t’ia shlyejë veprat e këqija dhe do t’ia rrisë shpërblimin.” (Talak, 5).

“Zoti im, të lus për udhëzim, devotshmëri, nder dhe pasuri!”

(Muhamedi a.s.)

- **Rrugë e fitimit të dijes**

Thamë se devotshmëri është dije. Në fakt ajo është edhe rrugë e fitimit të dijes. Allahu i Madhëruar thotë: “...prandaj ruajuni Allahut! Allahu ju mëson ju; Allahu është i Dijshtëm për çdo gjë.” (El Bekare, 282).

- **Shkak i pranimi të veprës**

Allahu i Madhëruar thotë: “...Allahu pranon vetëm prej të devotshmit.” (Maide, 27); “Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi juaj...” (Haxh, 37).

Prandaj devotshmëria ka shpërblim Xhenetin. Allahu i Madhëruar thotë: “Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit.” (Ali Imran, 133).

Në vend të një mesazhi përmbyllës, për vete dhe lexuesin e nderuar do të bëja këtë lutje që ka bërë Profeti Muhamed a.s.: “Zoti im, të lus për udhëzim, devotshmëri, nder dhe pasuri!”¹⁷

1 Hadith i saktë. Shih: Sahih el Xhami, nr. 2631.

2 Hadith i saktë. Shih: Sahih el Xhami, nr. 4194.

3 “Virtyti më i madh i moralit është frika ndaj Zotit!”

Ahmed bin Abdul Halim ibën Tejmiye, Xhamiu el mesail, red. shkenc. Muhamed Uzejr Shems, (Rijad: Dar Ataát el ilm – Bejrut: Dar Ibën Hazm, ed. 2, 1999), 1/178.

4 Shih hadithin nr. 3271. Albani në Sahihu et Tirmidhij e ka saktësuar.

5 Omer bin Sulejman el Eshkar, Et takva: ta’rifuha ve fadluha ve mahdhratuha ve kasasun min ahvaliha, (Jordani: Dar en Nefais, 2012), f. 11.

6 Ahmed bin el Husejn Ebu Bekir el Bejhakij, Ez zuhdu el kebir, (Bejrut: Muessesetu el kutub eth thekafijeh, ed. 3, 1996), f. 351.

7 Muhamed bin Ahmed el Kurtubi, El xhamiu li ahkam el Kur’an, red. shkenc., Ahmed Berduni dhe Ibrahim Atfish, (Kajro: Dar el kutub el misrije, ed. 2, 1964), 1/162.

8 Po aty.

9 Ismail bin Muhamed Asbahani, Et tergib ve et terhib, red. shkenc. Ejmen Shaban, (Kajro: Dar el hadith, 1993), 1/413.

10 Ebu Is’hak Ahmed bin Ibrahim eth Thalebij, El keshfu ve el bejan an tefsiri el Kur’an, (Xhidde: Dat et tefsir, 2015), 9/73.

11 Muhamed bin Ahmed Sefarini, Keshfu el litham sherhu Umdeti el ahkam, (Kuvajt: Vizaretu el Evkah - Siri: Dar Nevadir, 2007), 6/509.

12 Po aty.

13 Abdurrahman bin Shihabuddin ibën Rexheb, Xhamiu el ulum ve el hikem, (Bejrut: Muessesetu err rrisale, 1997), 1/401.

14 Shih porosinë e Salihut a.s., (Shuara: 142), Lutit a.s., (Shuara: 161), Ibrahimit a.s., (Ankebut: 16), etj.

15 Buhari, nr. 6064; Muslimi, nr. 2564.


16 Tirmidhiu, nr. 3444.

17 Muslimi, nr. 2721.

Khizja, teori e falsifikuar e konvertimit “të dhunshëm” të shqiptarëve në Islam

Hajrudin S. Muja

Teoritë e konvertimit të shqiptarëve në Islam janë bërë aq të përsëritshme, të zhurmshme, të shpifura, të mbrapshta e të mërzitshme, sa kanë lëshuar rrënjë në mendjet e njerëzve, dhe pavarësisht se nuk ka asnjë të vërtetë brenda tyre, janë bërë “*të vërteta historike*”, që u ligjërohen studentëve në bankat universitare. Disa nga këta ligjërues helmojnë opinionin publik nëpër debate të zhurmshme televizive, ku jo vetëm paraqesin mungesë kulture në debat, por kanë mungesë njohurish dhe bëhen



Khizja ishte një tatim vjetor individual për çdo njeri të lirë jomyslimanë, mashkull i rritur, që nuk ishte as i sëmurë as i vjetër, i vënë në zbatim sipas ligjit islam, një kontribut për shpenzimet e mbrojtjes, që ishte detyrë e çdo myslimani,

qesharakë me “argumentet” e tyre, që veç argumente nuk janë.

Një nga “argumentet” më të përsëritura për “islamizimin e dhunshëm” të shqiptarëve është taksa e veçantë për jomyslimanët (khizja). Kjo paraqitet si një fatkeqësi dhe “mjet i dhunshëm” ekonomik, që detyroi shqiptarët të konvertohen në Islam.¹ Është një parapërgatitje masive moniste, e cila vazhdon ta justifikojë frymën anti-islame në shoqërinë shqiptare, duke e paraqitur si një fe pushtuesish, të imponuar nën presionin e bukës (xhizjes), një gabim i paraardhësve tanë, që në kushte të lirisë duhet korrigjuar një orë e më parë. Duke shfrytëzuar burimet sllavo-greke dhe islamofobe, ata e kanë maskuar xhizjen me një hije dhe komente të zeza, sipas të cilave i paska shtyrë dhimijët, të frikësohen vetëm me përmendjen e emrit të tij, duke e trajtuar si një taksë nënçmimi e poshtërsie kundrejt mospranimit të Islamit. A ka ndonjë të vërtetë në gjithë këtë?!

Për ta mësuar rreth kësaj teme, unë kam zgjedhur distancimin e tërësishëm nga historiografia e fqinjëve tanë sllavë e greke, por edhe nga ajo zyrtare shqiptare, që shpesh është një “copy-paste” e tyre, duke ju

shmangur tërësisht autorëve, të cilët kanë prekë nivelet arsimore e akademike, por në një mënyrë apo një tjetër, vazhdojnë të përdorin teoritë “e veta” në shërbim të padronëve. Mendoj dhe shpresoj që autorët e huaj, jo vetëm që nuk kanë padronë dhe interesa politike që t’i bëjnë të njëanshëm, por ngritja e tyre intelektuale e akademike është e padiskutueshme. Nuk synoj ta luaj rolin e historianit, por mbështetem në konstatime historianësh të niveleve akademike.

Fillimisht duhet shpjeguar atë që debatuesit zhurmues e bëjnë shpesh kur e ngatërrojnë xhizjen me haraçin. Xhizja ishte një tatim vjetor individual për çdo njeri të lirë jomyslimanë, mashkull i rritur, që nuk ishte as i sëmure as i vjetër, i vënë në zbatim sipas ligjit islam, një kontribut për shpenzimet e mbrojtjes, që ishte detyrë e çdo myslimani, nga e cila i krishteri ishte i liruar.² Haraçi ishte tatim financiar obligim për tokën e poseduar (sipas prodhimit), pavarësisht konfesionit që i takonte. Me pranimin e Islamit një individ vazhdonte të paguante haraçin, lirohej nga xhizja, por obligohej me zeqatin (2.5% të pasurisë) dhe me shërbimin ushtarak.³ Vetë koncepti xhizje mund të përkthehet si “targë për kokë”, por duhet të kujtojmë këtu se xhizje mund të konceptohet edhe si “një lloj kompensimi”. Rrënja e kësaj fjale është “xheze” që do të thotë të kompensosh, përkatësisht një pagesë kompensuese në vend të shërbimit ushtarak.

A ishte vërtet xhizja shkak për konvertimin (qoftë edhe të një individi shqiptar) në Islam, pa llogaritur faktorë të tjerë?⁴ Sa mund të ishte kjo taksë aq “e padurueshme” që të mund të ndryshonte identitetin konfesional të një besimtari?⁵ Çfarë fitonte dhe çfarë humbiste (përveç besimit) një individ që konvertohej në Islam? Cila ishte arsyeja e pagesës së xhizjes dhe çfarë përfitimi kishte shoqëria jomyslimane brenda shtetit islam? Sa ishte i lidhur me fenë e tij të mëparshme një i konvertuar? Si qëndronte situata e tatimeve në vendet perëndimore jomyslimane?⁶ Këto janë disa nga pyetjet, përgjigjet e të cilave janë derdhur nëpër faqet e veprave akademike dhe universitare të historianëve të huaj, të cilat i shpjegojnë në mënyrë më bindëse në profesionalizmin e tyre.

Sikur shqiptarët të kishin pranuar Islamin për t’ju shmangur detyrimit të taksave, besimi i ri i tyre nuk duhej të ishte rrënjësor aq thellë. Peter Bartl, citon Thomas Arnoldin kur thotë se: “Duhet të kesh një lidhje shpirtërore shumë të dobët me fenë tënde që ta braktisë atë me qëllim që t’i shmangesh një ndëshkimi aq të lehtë; dhe vetë ekzistenca e një mase aq të madhe e krishterësh në Shqipëri,

Në kohën e Kryqëzatave, ishte një taksë e veçantë shtesë veçanërisht në Francë. Richard Dunn, thotë se taksa të veçanta “Cruzada” kishte caktuar edhe Filipi i II-të i Spanjës, një fond për të ndihmuar kryqëzatën e autorizuar nga papa, për luftërat e vazhdueshme të Spanjës kundër Islamit.

në kohën e sotme tregon se barra nuk duhet të ketë qenë aq e rëndë sa t’i detyronte ata të braktisnin fenë pa ndonjë alternativë tjetër.”⁷ Këtu nuk kishte asgjë të jashtëzakonshme që mund të lidhej vetëm me pushtetin osman. Një kronik mysliman i Spanjës, Ibën Xhubejri, pas një udhëtimi në Palestinë në vitin 1184, shkroi: “Të krishterët kërkojnë taksat prej myslimanëve, në ato territore ku lejohen të jetojnë. Tregtarët e krishterë paguan tatiime për mallrat e tyre në vendet e myslimanëve. Mirëkuptimi ndërmjet tyre është i plotë, i mirëkuptueshëm dhe realizohet pa asnjë kundërshtim. Njerëzit e luftës janë të okupuar me luftërat e tyre, por populli mbetet në paqe...”⁸

Ku qëndronte bota perëndimore mesjetare në proporcion me detyrimet, në kohën kur shqiptarët jomyslimanë u obliguan me taksën e xhizjes? Cantor thotë se në Evropën Perëndimore, princërit dhe monarkët u venin taksa të rënda popullatës. Në fillim kjo taksë paguhej me punë në korpuse e shërbime si në armatën mbretërore, por edhe në lloje të veçanta pune. Taksa të tjera që duhej t’i paguanin monarkut ishte taksa e importit dhe eksportit të mallit, taksa e të ardhurave (përveç klerit). Pasonte pastaj taksa e kishës dhe taksa e papatit për çdo familje në shkëmbim të sigurisë.

Në kohën e Kryqëzatave, ishte një taksë e veçantë shtesë veçanërisht në Francë.⁹ Richard Dunn, thotë se taksa të veçanta “Cruzada” kishte caktuar edhe Filipi i II-të i Spanjës, një fond për të ndihmuar kryqëzatën e autorizuar nga papa, për luftërat e vazhdueshme të Spanjës kundër Islamit.¹⁰ Filipi madje u përpoq të vendoste taksa të reja edhe mbi klerin. Cantor thotë: “Për shkak të taksave të larta, njerëzit shpeshherë revoltoheshin, siç ishte për shembull revolta e vitit 1358 në Jacquerie të Francës, apo revolta e vitit 1381 në Angli.”¹¹

Edhe Daniel Rops na tregon se në Gjermani, fshatarësia mbytej prej taksave të rënda dhe vazhdimisht rebeloheshin. Për ta paguar qiranë dhe të dhjetët e kishës, ata shpesh detyroheshin të merrnin kredi me interes të lartë nga çifutët.¹² Njëjtë ishte edhe në Perandorinë Lindore Bizantine, ku kishte taksa të shumta e të padurueshme për ndërtimin e rrugëve, për mirëmbajtjen e tokës shtetërore, etj.. Më 3 tetor 1500, një banor i Ulqinit ishte ankuar ndaj detyrimeve të rënda që ishin barrë e madhe për të varfrit e vendit.

Në vitin 1763, Anglia, një shtet i fuqishëm i botës që sapo kishte mbaruar luftën shtatë vjeçare me Francën, u kushtonte shumë taksapaguesve. Ata konsideronin shkëputje prej



taksave të padëshirueshme, që duhej të ishte principi themelor në çdo shtet të lirë: “Pa këtë të drejtë... nuk mund të ketë liri, lumturi, siguri... prekja e pasurisë së tjetrit, e madhe apo e vogël qoftë, konsiderohet si sulm ndaj sigurisë dhe pasurisë së tjetrit...”¹³ Madje edhe lufta tridhjetë vjeçare në Evropë lindi si shkak i detyrimeve të rënda me taksa. Njerëzit iknin drejt fshatrave për t’ju shmangur taksave të rënda dhe për të siguruar mbijetesën, nga ku pastaj lindnin revolucionet.¹⁴

Ku qëndronin shqiptarët në këtë kontekst para konquistës osmane? Murgu Gjergj Kadreni (shek. XI), në veprën “Përmbledhje historish” na tregon për ngarkesat e rënda të popullsisë me taksat në kohën e Perandorit Niqifor Foka. Ai ngriti taksat publike pa përjashtuar as institucionet mirëbërëse, jetimore, kishat, etj.. Taksat e mëdha detyronin popullsitë të shpërnguleshin prej vendeve të veta. Perandori Romani (1029-1034) ju mori shqiptarëve taksat e 5 vjetëve përnjëherë, sa që shkaktoi varfëri të madhe e vdekje nga uria.¹⁵

Orientalisti gjerman, Adam Metz, në veprën “Renaissance des Islams” shpjegon se ndryshe nga Evropa Mesjetare, qytetërimi islam brenda vetes përmbante popuj të besimeve të ndryshme, gjë që i hapte rrugë ko ekzistencës dhe atmosferës së tolerancës, për çka Evropa nuk kishte njohuri. Ai pohon se banorët ishin të kënaqur me këtë lloj trajtimi, jo vetëm se ishte trajtim më i mirë nga paraardhësit, por edhe për shkak se e kishin kuptuar që “për mbrojtjen e tyre paguanin xhizjen që i ngjasonte taksës së mbrojtjes së vendit. Nuk paguanin të tjerët, pos burrave që ishin të aftë për mbajtjen e armës. Nuk e paguante as i moshuari, fëmijët, gratë, priftërinjtë, adhuresit në tempuj...” Këtij mendimi i qëndron edhe Sir Thomas W. Arnold, i cili në librin “Përhapja e Islamit”, thotë se kjo taksë nuk ishte “një lloj ndëshkimi për mospranimin e Islamit”, por për sigurinë e tyre si dhimitë (popuj të librit), meqë “ata janë jomyslimanë dhe janë prej kopesë së shtetit, të cilit i ndalon feja e tyre për shërbime ushtarake.”¹⁶ Ata jo vetëm që ishin të mbrojtur nga sulmet

armike, por gëzonin edhe të drejtën e pasurisë, të fesë, të tempujve, të mbrojtur dhe pa asnjë trazirë.¹⁷

Bashkësitë fetare ishin të lira të zbatonin fenë e tyre, të ndiqnin ritualet dhe të qeveriseshin nga udhëheqësit e tyre fetarë, e nga ligjet e veta në çështje si martesë, divorci e trashëgimia. Në shkëmbim, atyre u kërkohej të paguanin një tatim (xhizje), që u siguronte atyre mbrojtjen myslimane nga çdo sulm i jashtëm dhe i çlironte nga detyrimi i shërbimit ushtarak. Për këtë arsye, ata quheshin “të mbrojtur” (dhimmi).¹⁸ Kjo pra ishte vetëm një këmbim për këtë mbrojtje dhe tolerancë, sipas parimit islam “nuk ka detyrim në fe”.¹⁹

Për më tepër, ky lloj tatimi ishte i obliguar në çdo shtet, në çdo kohë dhe në çdo vend, për shërbimet që i gëzonin të gjithë, pavarësisht konfesioneve, si gjykatat, policia, ndreqja e rrugëve, ngritja e urave. Myslimanët në këtë fushë, kontribuonin duke paguar zeqatin me të holla, prej tregtisë së kafshëve, të mbjellave, frutave të tyre, sadakatul fitrit, etj.. Duke qenë kështu, ngarkesa me xhizje për jomyslimanët ishte më shumë se normale dhe aspak degraduese. Janë të njohura madje edhe rastet kur të krishterët e Dukagjinit, Malësisë së Madhe, Mirditës, Kurveleshit, Sulit, etj., ishin liruar nga xhizja për shkak se ata mbronin dhe mirëmbanin rrugëkalimet malore duke fituar statutin e derbentxhinjve. Të lirë ishin edhe një pjesë e popullsisë së qyteteve dhe fshatrave, të cilët kryenin shërbime të caktuara siç ishin mirëmbajtja e kështjellave, gjuetia e shpendëve të egra (për oborrin e sulltanit) dhe për mbrojtësit e pushtetit osman nga kryengritjet ose nga sulmet e vendeve të tjera. Thënë ndryshe, në atë kohë liri nga shërbimi ushtarak dhe mbajtja e një krahu pune në shtëpi, mund të ishte më e vlefshme se sa mospagimi i taksës.²⁰ Shkuarja ushtar nga ku nuk dihej nëse kthehej apo jo, ndonjëherë natyrisht që ishte më ndrojtëse. Në këtë kontekst, xhizja ishte një mundësi zgjedhjeje ndërmjet shërbimit ushtarak dhe pagesës së xhizjes. Mundësia për të zgjedhur e zgjeronte dhe nuk e ngushtonte lirinë.

Konvertimet vazhduan edhe në viset që nga ana e osmanëve u përjashtuan nga taksat. Si shembull mund të merret qyteti i Krujës, i cili më 1441 kishte 125 shtëpi të krishtera, që u përjashtuan nga taksat, meqë ata mbronin kështjellën e gurtë të Krujës.²¹ Në relacionin e Fra Kerubinit, të 27 marsit 1638, duke folur për Kelmendin, thotë se ‘turqit’ nuk i shqetësojnë, se atyre nuk ua marrin të dhjetën, vetëm se paguajnë pak ose aspak ‘haraç’ dhe “nga ky shkak shumë bahen turq”.²² Të njëjtin vit, duke folur për dioqezën e Shasit, thotë se lirimi nga taksat ishte një “metodë e turkut për t’i tërhequr të krishterët në sektin e vet”.²³ E njëjta ngjau edhe në vitin 1744, kur pas lutjes së arqipeshkvit të Tivarit (Zmajeviq), pashai i Shkodrës iu përgjigj pozitivisht, duke liruuar prej çdo tatimi banorët e Shestanit, të Ljares dhe të Briskut (Krajë), për shkak të varfërisë së tyre.²⁴ Ishte i gabuar mendimi i arqipeshkvit, se kështu po largonte rrezikun e braktisjes së fesë katolike, sepse doli e kundërta. Prandaj shumë studiues e konsiderojnë këtë si stimulim, përkatësisht si një mënyrë tjetër në favor të konvertimit të shqiptarëve në Islam.

Se xhizja nuk ishte një taksë aq “dhunuese” sa të bëhet shkak për konvertime, argumenton edhe fakti se në vitin 1885, kur tashmë kishte përfunduar procesi i konvertimeve, u mor një vendim që edhe të krishterët të përfshiheshin në shërbime të ushtrisë.²⁵ Ishin të krishterët që paraqiten vullnetin se më me qejf do të paguanin taksën (xhizjen), sesa të shërbenin në ushtri. Ata e kundërshtuan vendimin dhe vazhduan të paguanin xhizjen që tanimë e quanin “taksë ushtarake”.

Sa mund të ishte kjo pagesë (xhizja) që duhej të paguhej prej një individi të familjes, të aftë për ushtri e punë? I mbështetur në burime dokumentare, prof. Anton Minkov, na ka dhënë një përgjigje më të detajuar.²⁶ Ai citon Inalçikun që thotë se deri në fundin e shekullit XV, xhizja ishte 45 akçe²⁷ ose 50 akçe vjetore, që nuk përbënte ndonjë arsye të mjaftueshme për konvertim, aq më pak kur konvertimet gjatë kësaj kohe ishin të pakta. Kiel, na jep një vlerë të kësaj “ngarkese”, duke nxjerrë çmimet e tregut në këtë kohë. Sipas tij, çmimi i një deleje mund të sillej ndërmjet 25 dhe 30 akçesh. Në prag të shekullit pasues, XVI, xhizja u rrit në 80-85 akçe, e njëkohësisht u rrit edhe numri i të konvertuarve, por rritja më e madhe e detyrimit të xhizjes, ngjau në shekullin e XVII dhe të XVIII, kur xhizja kishte arritur nga 170 në 230 akçe, deri në gjysmën e këtij shekulli ishte 300-350 akçe, dhe deri në fund të këtij shekulli, i kishte kaluar 400 akçe! Jalevich, thotë se kishte arritur në 789 akçe.²⁸

Kjo rritje spektakulare ishte rezultat i inflacionit. Duke krahasuar akçen osmane me dukatin venedikas, Minkov ka hartuar një paralele, sipas të cilit në vitin 1584, një dukat


Këta janë të bindur se pagesa e xhizjes ishte shumë më e vogël se detyrimet që ata i paguanin kishës për pagëzim, kungim, rrëfim, etj..

venedikas shkëmbehej me 60 akçe osmane, kurse në vitin 1600 me 125 akçe, ndërkohë që xhizja ishte rritur prej 80 në 170 akçe. Deri më 1659 një dukat venedikas shkëmbehej për 190 akçe, dhe deri më 1669 kishte rritur vlerën në 250. Ngritja e xhizjes në mesin e këtij shekulli, kishte shkuar në 300-350 akçe, kur një dukat venedikas shkëmbehej për 350 akçe, por xhizja vazhdoi të rritej edhe në shekullin e XVIII, kur konvertimi filloi të ndërpritej.²⁹ Nëse në ndonjë kohë tatimet u rënduan, kjo ishte nga shpërdorimet e tagrambledhësve, por në të tilla raste nuk rëndohej vetëm pozita e rajasë së krishterë, por edhe të asaj myslimane njëkohësisht.

Nëse relatorët kishtarë raportonin ngando njëherë se ishte ngarkesa e xhizjes si shkak për konvertimin e shqiptarëve në Islam, ata e bënë këtë për të mbuluar paafësinë e tyre në

parandalimin e kësaj dukurie dhe jo pse kishte ndonjë gjë të saktë brenda këtij konstatimi. Për më shumë, nëse konvertimi i shqiptarëve u bë për shkak të shtrëngësës me anë të detyrimeve tatimore, atëherë ka diçka tjetër për çka na dëshmojnë këto relacione. Është taksa e rëndë me të cilën i kishte ngarkuar kisha. Relacioni i vitin 1558, na thotë se si katolikët (latinë), ashtu edhe ortodoksët (grekë), i detyroheshin kishës ortodokse me një taksë të veçantë.³⁰ Kështu kisha katolike, përveç që kishte rezervuar një taksë të veçantë që besimtarët duhej të paguanin, ajo ishte e shtypur edhe nga kisha ortodokse, dhe i detyrohej asaj me taksa. Nikollë Mekajshi, duke shkruar për gjendjen e keqe të klerit, ankohej se si Kisha ortodokse ua merrte me dhunë tributin për t’ia dërguar patriarkës së Kostandinopojës, kur edhe vetë ai, nga pozita e një prifti ishte i detyruar të japë për të siguruar kalimin në vizitat e dioqezave.³¹ Kisha ishte aq e pasur sa vështirë mund të gjeje ndonjë copë toke që nuk i detyrohej kishës me një taksë vjetore, nëse nuk ishte pronë e saj.³² Kiel thotë se veç taksës së madhe vjetore, që secili person duhej t’i paguante, priftërinjtë kërkonin të paguheshin edhe për shërbime fetare dhe ato çmime ishin tejet të mëdha.³³ Këta janë të bindur se pagesa e xhizjes ishte shumë më e vogël se detyrimet që ata i paguanin kishës për pagëzim, kungim, rrëfim, etj.. Ne e dimë se gjatë kësaj kohe, shumë katolikë kaluan në skizmë duke u bërë ortodoksë dhe duke vazhduar të paguajnë xhizjen.³⁴

Se qeveria perandorake nuk kishte interes ta nxisë konvertimin përmes xhizjes, argumenton edhe fakti se xhizja ishte një burim i rëndësishëm i të ardhurave perandorake dhe konvertimi masiv do të shkaktonte kaos financiar. John Fine thotë se kur një i krishterë konvertohej në Islam, osmanët humbitnin taksën vjetore të xhizjes, që ishte në disfavor të tyre.³⁵ Për këtë arsye, shpesh të krijohet përshtypja se osmanët provonin mos inkurajimin e konvertimit, në ato fshatra ku



ende nuk kishte filluar konvertimi, duke i mbajtur pak a shumë në gjendje të njëjtë, e sidomos duke mos u dhënë avantazhe me konvertimet. Nga ana tjetër, një trajtim i tillë për të gjitha fshatrat ishte thjesht i pamundur.

Përveç kësaj, si mund të ishte xhizja aq “e dhunshme” për të ndikuar në konvertimin e shqiptarëve dhe boshnjakëve dhe nuk ishte e tillë për popujt e tjerë të Ballkanit, të cilët nuk u konvertuan?! Cila ishte ajo “arsye e posaçme” për të ushtruar “dhunë” mbi shqiptarët ndryshe nga popujt e tjerë, ose së paku përse dha rezultat vetëm te shqiptarët dhe boshnjakët? Një gjë është e sigurt, se dobësia e hipotezës e cila e paraqet Perandorinë Osmane si të “egër”, “barbare”, “me prirje të fortë asimiluese” etj., qëndron në faktin se nuk mund të shpjegojë bindshëm se, pse shqiptarët u integruan aq shumë në Perandorinë Osmane, në qoftë se ajo u përkeqësoi gjendjen e përgjithshme të tyre? Si i mbijetuan shqiptarët atij “presioni” të madh e të gjatë “asimilues” dhe cila qe ajo forcë e madhe e pamposhtur shqiptarëve, që ruajti të drejtat zakonore, traditat etnike dhe veçoritë psikologjike të tyre?

- 1 Daniel C. Dennet, “Conversion and the Poll Tax in Early Islam”, Cambridge, 1950, f.3-4.
- 2 Halide Asllan, “The Religious Conversion (to Islam) in Kosovo (1800-1900)”, në: “Balkans and Islam - Encounter, Transformation, Discontinuity, Continuity”, Ed. Ayşe Zişan Furat & Hamit Er, Cambridge Scholars Publishing 2012, f.24.
- 3 Noel Malcolm, “Agjentë Perandorakë – një familje shqiptare në botën mesdhetare të shekullit të gjashtëmbëdhjetë”, përktheu: Kastriot Myftiu, Tiranë, 2015, f.33.

- 4 Heath Lowry, “Changes in Fifteenth-Century Ottoman Peasant Taxation: The Case Study of Radilofo”, në: “Anthony Bryer and Heath Lowry (ed.): “Continuity and Change in Late Byzantine and Early Ottoman Society”, Birmingham - Washington, 1986.
- 5 Anton Minkov, “Conversion to Islam in the Balkans”, Boston 2004.
- 6 Denis P. Hupchick, “The Balkans – from Constantinople to Communism”, Nju Jork, 2002.
- 7 Peter Bartl: “Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878 - 1912)”, shqipëruar nga Nestor Nepravishta, Dituria – Tiranë, 2006, f.20.
- 8 Jacques Le Goff, “Medieval Civilization 400-1500”, në anglisht e përkthyer nga Julia Barrow, Nju Jork, 1988, f.147.
- 9 Norman F. Cantor (ed.), “The Encyclopedia of the Middle Ages”, Vikig Penguin, 1999.
- 10 Richard S. Dunn, “The Age of Religious Wars (1559-1689)”, New York 1970, f.16.
- 11 Norman F. Cantor (ed.), “The Encyclopedia of the Middle Ages”, Vikig Penguin 1999, f.404.
- 12 Henri Danuiel – Rops, “The Protestant Reformation”, përktheu nga frëngjishtja në anglisht nga Audrey Butler, Vëll.2, Nju Jork 1963, f.30.
- 13 Edmund S. Morgan, “The Birth of the Republic, 1763 - 1789”, University of Chicago 1956, f.14, 20.
- 14 Trevor Aston (ed.), “Crisis in Europe 1560-1660”, Nju Jork, 1965, f.65.
- 15 Koço Bozhari & Filip Liço: “Burime tregimtare Bizantine për Historinë e Shqipërisë, Shek. X-XI”, Tiranë, 1975, f.30.
- 16 Arnold, 2008.
- 17 J. J. Sanders, “A History of Medieval Islam”, London – Nju Jork, 1965, f.47.
- 18 John L Esposito, “Islam: The Straight Path”, Oxford University Press 1988 f. 33-34.
- 19 Kuran, 2: 256.
- 20 Richard Bulliet, “Conversion to Islam in the Medieval period - An Essay in Quantitative History”, London 1979 f. 41, 68.
- 21 Ferit Duka, “Shekujt Osmanë në Hapësirën Shqiptare” (Studime dhe dokumente), UET Press. 2009, f.13.
- 22 Injac Zamputi, “Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII”, Tiranë, 1965, Vëll. II, dok.28, f.103-141.
- 23 Injac Zamputi, “Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII”, Tiranë, 1965, Vëll. II-të; dok.33, f.181-189.
- 24 Nevila Nika, “Dioqeza e Shkodrës gjatë shekullit XVIII-të. Sipas dorëshkrimeve arkivore”, Shkodër, 2001, f.16.
- 25 Barbara Jalevich, “History of the Balkans, Eighteenth and Nineteenth Centuries”, Cambridge University Press. 1983, f.108; Kemal H. Karpat: “Popullsia Osmane 1830-1914”, përktheu Ajroll Guni, Tiranë, 2016, f.29.
- 26 Anton Minkov, “Conversion to Islam in the Balkans”, Boston, 2004.
- 27 Barbara Jalevich, “History of the Balkans, Eighteenth and Nineteenth Centuries”, Cambridge University Press, 1983.
- 28 Barbara Jalevich, “History of the Balkans, Eighteenth and Nineteenth Centuries”, Cambridge University Press, 1983.
- 29 Anton Minkov, “Conversion to Islam in the Balkans”, Boston, 2004, f.96.
- 30 Injac Zamputi, “Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë”, vëll.I, Tiranë, 1989, I, dok.200, f.195-196.
- 31 Zamputi, 1990, dok.#5, f. 34-41
- 32 Clement Gunn, “The Book of Peebles Church – St. Andrew’s Collegiate Parish Church ad.1195-1560”, Peebles, 1908, f.53.
- 33 Michael Kiel, “Remarks on the Administration of the Poll Tax”, në Linda Darling: “Revenue-Raising and Legitimacy - Tax Collection and Finance Administration in the Ottoman Empire 1560-1660”, Leiden-Nju Jork-Köln, Brill, 1996. f.148.
- 34 Skender Riza, “Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII”, Tiranë, 1987, f.420-437.
- 35 John Fine, “The Bosnian Church – Its Place in State and Society from the Thirteenth to the Fifteenth Century”, London, 2007, f.303.

Përkthime të pjesshme të Kuranit në gjuhën shqipe

Dr. Azmir Jusufi

“Bashkatdhetarëve kombëtarë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës”.

(Ilo Mitkë Qafëzezi)



Interesimi i masës së shqiptarëve për t’u njohur drejtpërsëdrejti me fjalën e shenjtë të Kuranit ka qenë i hershëm. Po ashtu të kahershme kanë qenë dhe përpjekjet e mjaft intelektualëve islamë për ta mundësuar një gjë të tillë. Një ndërmarrjeje të tillë i pati hyrë dhe Shemsetin Sami Frashëri për ta përkthyer atë në gjuhën turke, por botimi i këtij përkthimi u ndalua nga qeveria osmane dhe pjesët e përkthyer u asgjësuan.¹

Me sa dimë deri tani, përkthimi i mirëfilltë i Kuranit në shqipe zë fill në vitet ’20 të shekullit të kaluar. Mund të duket si e çuditshme, por është e vërtetë që përkthyesi i parë i këtij libri të shenjtë, i njohur deri më sot, është një bashkatdhetar yni i besimit të krishterë, ortodoks, e pikërisht atdhetari korçar dhe studiuesi i mirënjohur i historisë sonë mesjetare dhe më gjerë qysh para Çlirimit, Ilo Mitkë Qafëzezi. Ai bëri përkthimin e parë, kuptohet, të pjesshëm, të këtij libri në gjuhën shqipe, duke u mbështetur në përkthimin anglisht të bërë nga George Sale. Nga gjithë libri ai arriti të botonte pjesën e parë në Rumani më 1921. Këtë botim autori ua dedikon, siç shprehet vetë: “Bashkatdhetarëve kombëtarë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës”. Ndërsa fashikullin e dytë të këtij botimi ai arriti ta shtypë në Korçë, pas gjashtë vjetësh, më 1927. I. M. Qafëzezi nuk qe specialist i Kuranit, nuk qe as mysliman.²

Po ashtu, në vitin 1982, në Romë botohet një përkthim ajetesh të zgjedhura, të cilin na e jep Bekir Maloki, imam i Bashkimit të Mys-

limanëve në Romë. Këtu përkthyesi, në një broshurë të formatit standard prej afro 60 faqesh, i ofron lexuesit shqiptarë një zgjedhje të ajeteve të Kuranit, për të cilët mendonte se është nevoja më e madhe për të përkthyer “për të ndriçuar popullin mysliman shqiptar me dritën madhështore të Kuranit...” siç pohon në parathënie.³

Vlen të theksohet se përkthimi i ajeteve është shënuar me numër të sures dhe ajetit, pa origjinal, duke e përcjellë me një shpjegim çdo ajet apo grup ajetesh të përkthyer. Përkthyesi thotë se gjatë kësaj pune është shërbyer me përkthimet e Kuranit nga Çausheviç-Panxha. Këtu janë përkthyer suret: 1, 99-114, si dhe suret 92, 95, komplet, kurse nga suret e tjera vetëm nga ndonjë ajet, sipas zgjedhjes së tij.⁴

Pra, siç kuptohet, sipas mendimit të shumicës së studiuesve shqiptarë, përmendet emri i Ilo M. Qafëzezit si përkthyesi i parë i Kuranit i mesit të viteve 20-të të shek. XX, i cili në mënyrë serioze iu përvesh punës për përkthimin e Kuranit në gjuhën shqipe, edhe pse vetë nuk i përkiste fesë islame. Në fakt, ka mendime se Naim Frashëri⁵ ishte përkthyesi i parë i përkthimit selektiv të pjesëve të Kuranit, me titull “Thelb i Kuranit”.⁶

PËRKTHIME TË PJESSHME TË KURANIT TË BOTUARA NË LIBRA TË NDRYSHËM

Përveç përkthimeve të plota, ekzistojnë edhe përkthime të pjesshme të Kuranit, botuar në libra të ndryshëm, ku gjenden pjesë të

përkthyer nga Kurani. Shquhet në këtë aspekt përkthimi i sures së “Jasinit”. Duke qenë se në përmbajtjen e saj përfshihen udhëzime, këshillime dhe shpjegime të kuptimeve të larta, versionet e përkthimeve të saj në gjuhën shqipe janë të shumta.

Botimet e saj të para në gjuhën shqipe u bënë në vitet ‘30, mjafton të përmendet këtu “Libri i së falmës” i hfz. Ibrahim Dallit, botuar në Tiranë më 1937. Libër ky që ka disa ribotime, dhe i cili është i shoqëruar me shtyllat themelore që duhet të zotërojë çdo besimtar mysliman për të formuar botëkuptimin e tij dhe për të vepruar. Në hyrje të këtij botimi ka dhe disa udhëzime fonetike mbi drejtshqiptimin e saj.

Këtë përkthim e ndoqën edhe variante të tjera si në vijim:

- “Islamizmi dhe lutjet” i Imam Vehbi Ismailit, Detroit, 1957.
- “Mësimi i shkurtër mbi namazin dhe Jasini Sherif” i hfz. Sulejman Kemurës, botuar në Prishtinë më 1959. Në gjuhën shqipe e kanë përkthyer Bajram Agani dhe Mehmet Gjevori. Libri është ribotuar disa herë.
- “Rregulla dhe lutje” i hfz. Sulejman Kemurës, Prishtinë, 1972.
- “Ajete të Kuranit me shpjegime të tjera” i Beqir Malokit, botuar në Romë më 1982.
- “Jasini dhe 20 sure të tjera”, përktheu: Feti Mehdiu. Prishtinë, 1992.

Shquhet në këtë aspekt përkthimi i sures së “Jasinit”. Duke qenë se në përmbajtjen e saj përfshihen udhëzime, këshillime dhe shpjegime të kuptimeve të larta, versionet e përkthimeve të saj në gjuhën shqipe janë të shumta.

• “Hyrye në shkencat kuranore”, në vitin 1993 në Prishtinë, Qazim Qazimi boton një tekst për klasat e larta të medresesë me titull “Kaptina Jasin”, përkthim dhe koment i M. Mustafës, Shkup, 1994.

• “Jasini”, përkthim dhe koment i Sejfid Kutubit, Shkup, 1994.

• “Kaptina Jasin”, përkthyer nga N. Ibrahim, ribotimi i fundit më 1994.

• “Universi i Jusufit a.s.”, përkthyer nga Nexhat Ibrahim, Logos-A, Shkup, 2008, etj.

Përveç këtyre librave që radhitëm, të cilat kryesisht patën për bazë përkthimin e sures “Jasin”, ka edhe mjaft libra të tjerë të përkthyer me tematikë nga Kurani, që janë botuar kohët e fundit. Është për t'u vënë në dukje libri i dr. Feti Mehdiut “Nga tematika e Kuranit”. Ky libër ka karakter didaktik, strukturë të shëndoshë dhe lidhje logjike. Tematika e tij i nënshtrohet kriterëve teologjike shkencore. Fillimisht trajtohet qëndrimi i Kuranit ndaj shkencave të përpikta dhe besimit, vijohet me: Kurani për besimin, për meshkujt, femrat, familjen, fëmijët, për çështje ekonomike -sociale etj.. Autori i punimit e bën të qartë qëllimin e botimit të këtij vëllimi. Botime me

tematikë nga Kurani pati edhe në shumë qendra të tjera të Kosovës, si “Kurani dhe të drejtat e njeriut”, Gjilan; “Njohuri rreth Kuranit”, Prizren; “Kurani libër për të gjallët apo...”, Mitrovicë etj..

Një pritje të mirë në publikun shqiptar pati edhe broshura e dr. Maurice Bucaille, anëtar i Akademisë



Franceze të Mjekësisë, që shtjellon ndërlidhjet e Kuranit me shkencat bashkëkohore. Dr. Maurice Bucaille, që është kirurg i shquar, e zhvilloi fillimisht në formë leksioni temën e mësipërme, duke e ilustruar me fragmente kuranore para auditorit të Londrës. Me titullin “Të dhëna fiziologjike dhe embrionologjike në Kuran”, kjo temë është mbajtur edhe në Akademinë Franceze të Mjekësisë, më 9 nëntor 1976. Broshura e lartpërmendur u publikua në Tiranë më 1992. Në këtë broshurë autori shtron nevojën e një kulture enciklopedike për të kuptuar Kuranin. Ai flet për Universin dhe krijimin e tij, për astronominë, tokën, krijimin e njeriut etj..

Më 1986 u botua libri i Ahmed Deedatit “Kurani, mrekullia më e përsosur” në gjuhën shqipe, më 1986. Në këtë libër gjejmë vlerësime për Muhamedin a.s., nga personalitete të shkencës, kulturës e filozofisë perëndimore, si të Thomas Carlylit, të Gibbonit, të R. Bosworth - Smith, të La Martinit, të Jules Mesermanit etj..

Në vazhdim të botimeve të pjesshme të Kuranit, më 1994 u botua “Nën hijen e Kuranit - 12 suret e fundit”, vepër e Halil Idrizit. Po më 1994 është botuar edhe një fragment i Kuranit me titull “Kurani i Madhnueshëm”, përkthim dhe komente. Fatkeqësisht këtij botimi i mungon parathënia dhe emri i përkthyesit.⁷

PËRKTHIMET E HERSHME TË KURANIT TË BOTUARA NË PERIODIKUN ISLAM

Përveç përkthimeve që përmendëm më lartë, të cilat janë botuar si të veçanta apo në kuadër të ndonjë libri fetarë kushtuar nevojave praktike të myslimanëve, kemi edhe përkthime të pjesërishme që janë botuar nëpër revistat fetare: “Zani i Naltë”⁸, “Kultura Islame”⁹, “Edukata Islame”¹⁰ dhe “Jeta Myslimane Shqiptare”.

Në periodikun islam, “Zani i Naltë”, në periudhën prej 1923-1939, në faqet e kësaj reviste janë botuar përkthimet e sureve nga Hafëz Ali Korça, e suret e përkthyerat ishin këto: El Fatiha, El Araf, Ed Duha, Et Tin, El Alak, El Kadr, Ez Zilzal, Et Tekathur, El Humeze, El Fil, En Nasr, El Felek, En Nas.¹¹

Prej përkthimeve të sureve dhe ajeteve të botuara në “Kulturën Islame”, ishin këto: El Fatiha, El Bekare, ajeti 177; Kaf, në tërësi; El Mu'minin, ajetet 12,13,14; El Beled, në tërësi; El Enfal, ajetet 45,46,47 dhe 60; dhe Ed Duhan, ajetet 1-6. Me sa shihet nga revista “Kultura Islame”, këtu nuk kemi përkthim sistematik të Kuranit, por kemi të bëjmë me përkthim tematik ku janë marrë ajete nga sure të ndryshme, jo me radhë. Edhe pse në disa numra të revistës në fjalë nuk kemi nënshkrim të autori i tyre, s'ka dyshim se autor i këtyre përkthimeve është Haki Sharofi.¹² Sharofi gjatë këtyre përkthimeve jep në fillim tekstin origjinal të Kuranit, edhe me shkronja arabe, pastaj përkthimin dhe mandej vjen

komentimi mjaft i gjerë. Komentimi është i plotësuar edhe me ajete të tjera ose ma hadithe.¹³

Në revistën fetare tremujore, “Edukata Islame”, e cila del prej vitit 1971 në Prishtinë, qysh nga numri i parë kemi përkthime të ndonjë ajeti të Kuranit që kanë shërbyer si bazë për artikuj të ndryshëm. Në këtë revistë, prej vitit 1971 deri në vitin 1981, nga autori Sherif Ahmeti, janë botuar këto përkthime të sureve: El Asr, El Fatiha, El Ihlas, El Kevther, El Felek, El Kadr, Esh Shu'ara...

Në revistën “Jeta Myslimane Shqiptare”, janë botuar: El Fatiha 1-7, El Bekare, 1-7, El Huxhurat 12, El Furkan 1-60, El Mu'minin 1-40. Autor i këtyre përkthimeve me komentim është Imam Vehbi Ismaili.¹⁴

Në periodikun islam “Glasnik”¹⁵, në vitet 1983-1984, janë botuar këto sure: El Enbija, El Haxhah, El Mu'minin, En Nur, En Neml. Autor i këtyre përkthimeve të pa komentuar është Feti Mehdiu.¹⁶

- 1 Gazmend Shpuza, “Kurani në gjuhën shqipe”, shih në ueb-faqe: <http://kuranifisnik.com/KuraniFisnik/Artikuj/default.asp?NrArtikull=273>
- 2 Shih: G. Shpuza, *Përkthyesi i parë i Kuranit në gjuhën shqipe*, “Drita islame”, (Tiranë: 1995), 4.
- 3 Bekir Maloki, *Ajete të Kuranit me shpjegime të tjera*, (Roma: 1982), 57. Sipas: Feti Mehdiu, *Përkthimet e Kuranit në gjuhën shqipe* (Shkup: Logos-A, 1996), 36.
- 4 Feti Mehdiu, *Përkthimet e Kuranit në gjuhën shqipe*, op. cit., 36-37.
- 5 Elez Ismaili, “Disa tema dhe dilema rreth përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe”, shih në ueb-faqe: <http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=3185>
- 6 *Thelb i Kuranit*, pjesë përbërëse e veprës “Mësimet” në botimin e kompletit të veprave të Naimit, si në Tiranë po ashtu edhe në Prishtinë, nuk përmendet fare. Botimin e parë të kësaj vepre e ka bërë vetë Naimi në Bukuresht më ۱۸۹۴. Studimin më të plotë të këtij kontributi e ka bërë dr. Mahmud Hysa.
- 7 Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX*, (Tiranë: Instituti Shqiptar i mendimit dhe qytetërimit islamik, 2007), 200-204.
- 8 *Zani i Naltë* - Revista fetare, Botohet nga Komuniteti Mysliman Shqiptar, Merret edhe me filozofi, moral, literaturë kombëtare e sociologji, Drejtimi: “Zani i Naltë”, Tiranë, del një herë në muaj.
- 9 *Kultura Islame* - e përmuajshme fetare, letrare, diturore, artistike, organ i Komunitetit Mysliman Shqiptar, drejtor përgjegjës: S. Bega, Drejtimi: Kultura Islame, Tiranë.
- 10 *Edukata Islame* - revistë fetare tremujore, Prishtinë. Numri i parë doli në vitin 1971, e boton Shoqata e Ulemave Islam të RS të Serbisë në Prishtinë.
- 11 Feti Mehdiu, *Përkthimet e Kuranit në gjuhën shqipe*, op. cit., 40-41.
- 12 *Haki Sharofi* lindi në Dibër të Madhe, por veprimtarinë e tij si mësues, publicist dhe përkthyes i zhvilloi larg lindjes, në Gjyrrash të Manastirit (1912), në Peshkopi (1914), ku hapi shkollën e parë shqipe, në Trujak dhe në Sllovë të Dibrës (1916 dhe 1920), në Kastriot (1923), në Krumë (1928), në Vlorë (1929). Gjithashtu ai ka lënë një trashëgim të pasur me përkthime, siç janë: “Tefsiri shqip”, “Parimet e alta të islamit”, «Ajete të Kuranit» etj. Shih në: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, *100 Personalitete shqiptare të kulturës islame (Shekulli XIX-XX)*, Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri, 2015, f. 54.
- 13 Feti Mehdiu, *Përkthimet e Kuranit në gjuhën shqipe*, op. cit., 41.
- 14 Ibid., 42.
- 15 Revista e Rijasetit të Bashkësisë islame në Bosnjë e Hercegovinë.
- 16 Ibid., 44.

Parabola e ëndrrave

Granit Sadiku

Në periudhën mekase, i Dërguari i Zotit kishte sfida e probleme të ndryshme. Idhujtarët e përçmonin, e përgënjeshtrojnë, e kur e kur edhe e sulmonin në mënyra të ndryshme. Kulmi i pikëllimit të tij ishte vdekja e dy më të dashurve të tij, që për të ishin simboli i përkrahjes dhe motiv i vazhdimit tutje. Pra, është fjala për *vitin e pikëllimit*. Kohën kur Muhamedit a.s. i vdiq gruaja dhe xhaxhai. Në rastet e pikëllimeve të mëdha, njeriu e ka të vështirë ta gjejë një copë prehje shpirtërore, në të cilën mund t'i mbështesë dhembjet, e mund t'i lidhë plagët e veta. I Dërguari i Zotit prehjen e gjente te shpallja Hyjnore, e cila i zbriste herë pas here nga Zoti i Madhërishëm. Herë në formën e këshillës, herë në formën e urdhërimit e nxitjeve, e herë në formën e rrëfimeve nga kohët e vjetra të historisë njerëzore.

Rrëfimi është kura, apo eliksiri që e mban të gjallë njeriun. Njeriu tregon ato që i ka jetuar, dhe tregon për të jetuar. E duke e shfaqur vlerën e madhe të rrëfimit, Zoti e ka zbritur një pjesë të konsiderueshme të rrëfimeve përmes Kuranit. Ndër to, tregimi më i bukur në Kuran, dhe sipas meje tregimi më i bukur në botë, i zbriti Muhamedit a.s. përmes një kaptine të veçantë me emrin "Jusuf". Kjo histori shtrihet në 111 ajete kuranore, dhe shtjellohet me ngjyime të bukura letrare. E veçanta e kësaj historie është se në Kuran tregohet vetëm një herë. Pra, dallon nga historia e Ibrahimit apo Musait, të cilët përmenden në shumë kaptina të Kuranit. Mbase, edhe ky atribut i përshtatet

Rrëfimi është kura, apo eliksiri që e mban të gjallë njeriun. Njeriu tregon ato që i ka jetuar, dhe tregon për të jetuar. E duke e shfaqur vlerën e madhe të rrëfimit, Zoti e ka zbritur një pjesë të konsiderueshme të rrëfimeve përmes Kuranit. Ndër to, tregimi më i bukur në Kuran, dhe sipas meje tregimi më i bukur në botë, i zbriti Muhamedit a.s. përmes një kaptine të veçantë me emrin "Jusuf".

konstatimit të mëparshëm se është historia më e bukur në botë. Një histori e bukur e ka vetëm një rast ta shfaqë veten.

PARALELIZMI I ËNDRRAVE

Tregimi i Jusufit është një nga tregimet më të thella që gjenden në Kuran. Madje, për nga aspektet alegorike, metaforike, krahasuese, shohim një nyjë të ndërlikuar kuptimësore, e cila nuk e duron kanonizimin për ta zgjidhur, por kërkon punë të madhe në angazhimin e kodifikimit të saj. Ka mjaft tefsirologë e historianë që kanë folur për këtë histori, kështu që ky artikull nuk përmban ndonjë studim shkencor, por thjesht koment mbi leximin e këtij tregimi. Ngase, po të vazhdoja të flisja edhe unë për ato aspekte të historisë së detajuar, druham se thjesht do të përsërisja mendimet e tyre.

Ajo që më ka intriguar gjithmonë në këtë tregim është ëndrra. Parabola e ëndrrës dhe



shumëkuptimësia e saj në dimensionet e këtij tregimi. Në fillim të rrëfimit na përmendet edhe një konstatim, e që është kulminacioni i argumenteve për tregimin më të bukur në botë, kur Zoti thotë: “*Ne po të tregojmë ty (Muhamed) historinë më të bukur përmes shpalljes së këtij Kurani, ndonëse ti, me të vërtetë, nuk ke qenë në dijeni më parë.*” (Jusuf, 3). Pra, ky cilësim i kësaj historie si më e bukura ndër të gjitha historitë, vije nga Ai që i di të gjitha historitë, që e di të dukshmen e të fshehtën, atë që thuhet dhe atë që s’thuhet, atë që fshihet dhe atë që zbulohet.

Prejardhja e Jusufit dihet. Në një transmetim nga Ibën Omeri, Pejgamberi a.s., kishte thënë: “Fisniku, i biri i fisnikut, të birit të fisnikut, nga babai fisnik, është Jusufi, djali i Jakubit, e ky i Is’hakut, i cili është djali i Ibrahimit, mikut të të Gjithëmëshirëshmit.”¹

I

Jusufi një ditë shkoi te babai i tij dhe i tha: “*O babai im! Unë pashë në ëndërr njëmbëdhjetë yje, Diellin dhe Hënën! I pashë të më përuleshin në sexhde.*” (Jusuf, 4). Kjo ëndërr kishte nxitur imagjinatën e Jusufit si fëmijë, dhe e kishte shtyrë që patjetër ta pyeste babanë e tij të dashur se çfarë kuptimi kishte. Jakubi a.s., meqë ishte pejgamber dhe e kishte shumë të njohur komentimin e ëndrrave e kuptoi menjëherë se kjo nuk është një ëndërr e zakonshme, e as nuk është ëndërr nga djalli i mallkuar. Ajo ishte ëndërr nga Zoti, dhe si e tillë ngërthente në vete një mesazh Hyjnor të një profetësie të ardhshme, e cila do të realizohej shumë vite pas shfaqjes së saj. Para se t’ia shpjegonte birit të tij ëndrrën, ia bëri me dije të kishte shumë kujdes dhe ta mbante sekret, duke i thënë: “*O biri im! Mos ua trego ëndrrën tënde vëllezërve të tu, që të mos kurdisin ndonjë gjë kundër teje, sepse, vërtet, djalli është armik i hapët i njeriut.*” (Jusuf, 5). Zakonisht, psikologjia e fëmijës vetëdijesohet dhe krijon vetëbesim atëherë kur babai apo nëna i beson diçka specifike atij. Ngase kësaj, atij i rritet motivi për vetafirmim. Edhe Jusufi si fëmijë, porsa ia bëri me dije babai që ky ishte një sekret mes tyre, u privilegjua e u vlerësua. E vlerësimi vazhdoi pastaj nga babai, i cili i tha: “*Dhe kështu, Zoti yt të ka zgjedhur ty dhe të mëson shpjegimin e ëndrrave dhe e plotëson dhuntinë e Vet ndaj teje dhe familjes së Jakubit, ashtu siç e ka plotësuar më parë ndaj të parëve tu, Ibrahimit dhe Is’hakut. Pa dyshim, Zoti yt është i Urtë dhe i Gjithëdijshëm.*” (Jusuf, 6). Kjo porosi e babait të Jusufit, Jakubit a.s., është shumë më e përgjithshme sesa që duket. Përmes porosisë së tij ndaj

Jusufi një ditë shkoi te babai i tij dhe i tha: “O babai im! Unë pashë në ëndërr njëmbëdhjetë yje, Diellin dhe Hënën! I pashë të më përuleshin në sexhde.” (Jusuf, 4). Kjo ëndërr kishte nxitur imagjinatën e Jusufit si fëmijë, dhe e kishte shtyrë që patjetër ta pyeste babanë e tij të dashur se çfarë kuptimi kishte.

Jusufit, Allahu i porositi edhe njerëzit e tjerë përmes Kuranit që të mos ua tregojnë ëndrrat e tyre, dëshirat e planet e tyre të tjerëve. Ngase ka shumë nga njerëzit që duke qenë dashakëqinjë, ndikojnë për të keq në rrënimin e planeve të dikujt. Për atë arsye, gjithmonë planet e dëshirat jetësore duhet t’u besohen vetëm atyre që i duam e që na duan.

II

Parabola e ëndrrës na shfaqet prapë te ajetet 36 dhe 41, kur Jusufi a.s., pasi që u fut padrejtësisht në burg nga zonja e lartë dhe zotëria, të cilëve po u shërbente, takohet me dy të burgosur e shoqërohet me ta. Pra është fjala për shërbëtorët e mbretit, njëri prej të cilëve shërbente verë, e tjetri shërbente ushqim. I pari i tha: “*Unë kam parë (në ëndërr) veten, se si shtrydhja verë (...), ndërsa i dyti tha: “Unë kam parë në ëndërr, se si mbaja në kokë bukë, të cilën e hanin shpendët (...)*” (Jusuf, 36). Jusufi qysh nga burgu u njoh si njeri i mirë dhe i sinqertë. Të burgosurit e kishin parë se nuk ishte njeri i thjeshtë, madje disa e kishin quajtur “falltor” ngase ai, përmes aftësive që i kishte dhënë Allahu, u tregonte të burgosurve se çfarë ushqimi do t’u vinte.

Çfarë do të thoshte vera, e çfarë do të thoshte buka?! Pse shërbimin e njerit po e pranonte mbreti, e shërbimin e tjetrit nuk po e pranonte, por po iu lihej sorrave?! Jusufi a.s. iu përgjigj: “*O shokët e mi të burgut! Njëri prej jush do t’i shërbejë verë pronarit të vet, kurse tjetri do të kryqëzohet, e shpendët do të hanë prej kokës së tij.*” (Jusuf, 41). Në rastin e parë, kur Jusufi ia tregoi ëndrrën babait të tij, ai na del si pyetës për komentimin e ëndrrës, ndërsa, në rastin e dytë si i pyetur, që dëshmon se tani ai e kishte dhuntinë e komentimit të ëndrrave, dhe se ishte pejgamber. Profetësia e tij me dy shokët e burgut u vërtetua. Njëri u lirua, tjetri u ekzekutua.

III

Mbreti i Egjiptit një ditë kishte mbledhur parinë e vet, këshilltarët e magjistarët, urtarët e dijetarët, dhe ua kishte shtruar një çështje e cila i la të gjithë pa përgjigje. “Dhe mbreti tha: “*Kam parë në ëndërr shtatë lopë të majme, të cilat po i hanin shtatë lopë të dobëta dhe kam parë shtatë kallinj të gjelbër e shtatë të tjerë të tharë. O paria ime, më shpjegoni ëndrrën time, nëse dini t’i interpretoni ëndrrat!*” (Jusuf, 43). Paria ishin të hutuar dhe të padijshëm në lidhje me këtë ëndërr, dhe i thanë: “*Këto janë ëndrra të ngatërruara e ne nuk dimë t’i shpjegojmë.*” (Jusuf, 44). Të gjithë ata që e lexojnë me



vëmendje këtë tregim, e kanë parasysh se efekti i ëndrrës së faraonit në këtë rast është pikërisht mëshira e Zotit ndaj robit të tij të dashur Jusufit. Zoti nuk ia ka dhënë askujt aftësinë ta komentojë këtë ëndërr përveç Jusufit. E kur shërbëtorit të mbretit iu kujtua komentuesi i dikurshëm i ëndrrës së tij, ndërhyri me premisa të gjetjes së komentit të vërtetë të ëndrrës. Shërbëtorit iu besua kjo përgjegjësi, dhe shkoi te burgu ku ishte Jusufi a.s., e ia shtroi çështjen që i brente mbretin dhe parinë e tij. Jusufi, me dijen e begatinë e madhe që i kishte dhënë Zoti në komentimin e ëndrrave, filloi së pari më këshillë për mbretin dhe popullin, e pastaj me komentimin e ëndrrës. “(Jusufi) tha: “Do të mbillni shtatë vjet rresht. Prodhimin që do të korrni lëreni në kallinj, përveç një pakice që do t’ju shërbejë për të ngrënë, sepse pastaj do të vijnë shtatë vjet të thatë, të cilët do t’i harxhojnë ato që i keni ruajtur ju, përveç një pakice që mund të kurseni. Pastaj, pas këtyre do të vijë një vit plot shi për njerëzit, vit në të cilin ata do të shtrydhin (rrush etj.)” (Jusuf, 47, 48). Kjo ndikoi që Jusufi të shpallej totalisht i pafajshëm nga vetë gratë që e kishin burgosur, të lirohej, e të bëhej ndër njerëzit më të privilegjuar në Egjipt me postin e ministrit, post të cilin ia kishte besuar vetë mbreti.

IV

Hera e fundit kur përmendet ëndrra si realizim final i historisë dhe i premtimit të Allahut të Madhëruar ndaj Jusufit a.s. është në ajetet 100 dhe 101, kur ndodh ribashkimi i Jusufit me familjen e tij. Pra, historia nis me një ëndërr, zhvillohet tërë ngjarja rreth asaj ëndrre, dhe përfundon prapë me atë ëndërr. Jusufi ishte në fronin e tij të lartë, e hëna, dielli dhe njëmbëdhjetë yjet alias babai, nëna dhe njëmbëdhjetë vëllezërit po i bënin sexhde në shenjë respekti për të. Ai u ngrit në këmbë, i mori afër prindërit, dhe i uli në fron pranë vetes. Ai nuk e pati për asnjë moment ndjenjën e krekosjes apo të mburrjes, përkundrazi. Ai ishte modest, dhe ishte gjithnjë i respektueshëm. Pas dhjetëra vitesh tani po i drejtohej babait të tij dhe po i thoshte: “O babai im, ky është shpjegimi i ëndrrës sime të dikurshme. Zoti im e përmbushi atë.

Mua më bëri mirësi, kur më nxori nga burgu, kurse juve ju solli nga shkretëtira, pasi djalli pati futur ngatërresë midis meje dhe vëllezërve të mi. Vërtet, Zoti im është i Butë me kë të dojë; Ai është i Gjithëdijshmi dhe i Urti!” (Jusuf, 100). Puna është gjithmonë e vështirë, por suksesi është gjithmonë i ëmbël. E përpjekja e njeriut në këtë botë nuk duhet të jetë e pashpresë, ngase Zoti gjithmonë i ndihmon të drejtët.

DY TEORI TË INTERPRETIMIT TË ËNDRRAVE

Ky tregim i Kuranit na e paraqet një lloj të ëndrrave, i cili është shtjelluar e studiuar shumë si nga shkollarët e fesë, ashtu edhe nga psikologë, e psikanalistë të ndryshëm. Sigmund Freud për shembull, në teorinë e tij mbi interpretimin e ëndrrave, paraqet disa lloje të tyre të ndara në: ëndrra të aspektit të brendshëm psikologjik, ëndrra si plotësim i dëshirave, ëndrrat latente, etj.. Më tutje në shpjegimin e ëndrrës latente, që lidhet më së shumti me llojin e ëndrrave që gjenden në këtë tregim, ai thotë: “Përmbajtja latente në ëndrra i referohet kuptimeve ose temave të fshehura, simbolike dhe të pavetëdijshme pas ngjarjeve të një ëndrre.”²² Temat e fshehura paraqiten fillimisht nga protagonistët, e pastaj shtjellohen përgjatë tërë historisë deri në fund. Simbolet që gjenden në ëndrra janë shpjeguese, dhe shfaqin epitetet e karaktereve. Yjet simbolizojnë vëllezërit, dielli simbolizon babanë, e hëna simbolizon nënën. Yjet shkëlqejnë e shndrisin në qiell, por prapëseprapë e kanë distancën e tyre dhe nuk mund të jenë të bashkuar. Dielli është ndriçuesi i botës, ai që e krijon jetën dhe e zhvillon atë. Hëna është ëmbëlsia e natës, e shpeshherë dëshmitarja e vuajtjes, e mirësive dhe e ligësive. Shërbëtori i verës do mund të ishte simboli i një shërbëtori besnik, ndërsa shërbëtori i bukës që e hanë sorrat do të mund të quhej bashkëpunëtor i së keqes, ushqyes i së keqes, shërbyes i saj, etj.. Lopët e majme simbolizojnë begatitë e bollshme, e ushqimet e majme. Lopët e thata simbolizojnë vobekësinë, e mungesën e ushqimit. Kallinjët e njomë simbolizojnë pasurinë, e kallinjët e thatë varfërinë. Po ashtu, në këtë histori gjendet edhe një aspekt alegorik, që është këmisha e Jusufit, e cila përmendet disa herë përgjatë ngjarjes, e për të do flitet më poshtë.

Kjo teori e intepretimt ishte rrjedhë e një përvoje psikanalitike të një studiuesi që është marrë intensivisht me aspektet e nënvetëdijes njerëzore. Në aspektin islam, i kemi ndarjet e llojit të ëndrrave në: ëndrra nga Zoti, ëndrra nga përjetimet e përditshme, dhe ëndrra nga djalli i mallkuar. Ëndrra e parë që përmendet në këtë histori është pa dyshim nga Zoti i Madhëruar. Ëndrra e dytë, e dy shërbëtorëve të mbretit që ishin të burgosur, mund të jetë një përzierje mes dy llojeve të ëndrrave, të parës dhe të dytës. Ëndrra e tretë duket si ankth, duket si një përzierje motivesh. Kjo ëndërr, siç përshkruhet në Kuran dhe në librat shtjellues të kësaj

historie, e kishte shqetësuar shumë mbretin. Iu kishte përsëritur disa herë me radhë. Në një analizë potenciale të raportit shkak-pasojë, do të mund të thoshim se kjo është ëndërr nga djalli, ngase ishte ankth dhe kishte efekt të frikshëm në atë që e shihte ëndrrën. Por, po ta kujtojmë historinë e Ibrahimit a.s., stërgjyshit të Jusufit, do të shohim se edhe atij iu kishte përsëritur ëndrra me Ismailin a.s. disa herë dhe e kishte shqetësuar tej mase. Ajo ishte, pa dyshim, një ëndërr nga Zoti për të. Pra, jo çdo herë ëndrrat nga Zoti janë të qeta, apo ëndrrat nga djalli janë ankthe. Kësisoj, motivi i kësaj ëndrre, sipas kësaj teorie të shpjegimit të ëndrrave, në pikëvështrimin tim mbetet i paqartë.

KËMISHA E JUSUFIT

Në tregimin e Jusufit a.s. paraqitet edhe një subjekt interesant tematologjik, që ka të bëjë me një figurë letrare, e cila ka varietete të ndryshme kuptimësore. Është fjala për këmishën e Jusufit, e cila përgjatë tregimit paraqitet si objekt jo i thjeshtë, por ngërthen në vete një alegori të tregimit. Këmisha përmendet në disa vende specifike përgjatë kësaj kaptine. Por, ne do të analizojmë tri aspektet kryesore, të cilat i vendosin kahje konceptit të lexuesit për këtë këmishë.

Në rastin e parë, pasi vëllezërit e Jusufit e rrahin, e maltretojnë dhe në fund e hedhin në pus, ata dëshirojnë që ta bëjnë sa më të besueshme gënjeshtren e tyre te babai që, gjoja se, Jusufin e ka ngrënë ujku. Ata e therin një dele, dhe me gjakun e saj e spërkatin këmishën. Me këmishë të gjakosur kthehen te babai i tyre dhe i thonë: *“O babai ynë, ne shkuam të vrapijmë e Jusufin e lamë te rrobat tona, andaj e hëngri ujku (...)”* (Jusuf, 17). Pastaj ia treguan këmishën e tij, që babai e kishte me mall, dhe i thanë se ai ishte gjaku i Jusufit. Por, gënjeshtria i ka këmbët e shkurtra – siç thuhet në popull. Ata ishin kujtuar ta lyenin me gjak këmishën e tij, por e kishin lënë të pa shqyer. E si mund të hajë ujku dikë e rrobat t'i mbeten të pa shqyera?! Prandaj, Jakubi a.s., edhe pse e dinte se nuk ishte e vërteta fare ashtu siç ia tregonin bijtë e tij, nuk kishte fakte t'ua dëshmonte gënjeshtren e tyre. Dhe kështu, u

detyrua të vuante për Jusufin në heshtje, e të mos kishte më shenjë tjetër prej tij pos asaj këmishe që mbante erën e tij të bukur.

Në rastin e dytë, këmisha paraqitet si argument kryesor i dëshmisë së pafajësisë së Jusufit. Kur Jusufi u rrit, bukuria e tij e jashtme dhe e brendshme e nxiti gruan e zotërisë që e kishte blerë Jusufin që ta ftonte atë në një dhomë me dyer të mbyllura. Jusufi iku nga ajo situatë, ngase te morali i një besimtari më e mirë është vdekja sesa imoraliteti. Duke ikur Jusufi, gruaja e zotërisë e ndiqte nga pas dhe duke tentuar ta kapte e shqeu këmishën e tij. Pastaj, ata zunë të takoheshin në derë me zotërinë dhe ai u nevrkos tej mase, ashtu siç do të bënte çdo bashkëshort në situata të tilla. Jusufi besnik ia shpjegoi situatën zotërisë, dhe i tha që ta merrte një dëshmitar nga familja e gruas së tij, që ishte një fëmijë i porsalindur. Me lejen e Zotit, i cili ka krijuar rendin dhe rregullin e kur të dojë Ai e ndryshon atë, fëmija foli fjalë kuptimplote. Çështja ishte se nga cila anë ishte e shqyer këmisha. Nëse ishte e shqyer nga para, atëherë Jusufi ishte fajtor – ngase logjikisht ai iu kishte vërsulur zonjës dhe ajo në vetëmbrojtje kishte grisur këmishën e tij. Ndërsa, nëse këmisha ishte e shqyer nga prapa, atëherë ajo e kishte ndjekur nga pas Jusufin dhe duke tentuar që ta kapte e kishte grisur këmishën e tij. Ku ka logjikë më të thjeshtë, më kuptimplote, e argument më të gjallë sesa ky për dëshminë e një pafajësie?! Kjo nuk ishte aspak mbrojtje e Jusufit. Kjo ishte thjesht dëshmi e gjallë se kush kishte faj, dhe aq më tepër që vinte nga vetë familja e fajtores. Dëshmia u mor nga zotëria, dhe ai e shikoi këmishën e Jusufit. *“Kur burri i saj pa se këmisha e Jusufit ishte shqyer nga mbrapa, tha: “Patjetër që kjo është një nga dredhitë tuaja (të femrave). Në të vërtetë, dredhitë tuaja janë të mëdha! Ti, o Jusuf, largohu nga kjo! Kurse ti (gruaja ime), kërko falje për këtë gjynah, sepse, në të vërtetë, ti je fajtorë.”* (Jusuf, 28, 29). Pra, këmisha e Jusufit në variantin e dytë të tregimit prapë ka rolin e argumentimit. Në rastin e parë shërbeu si argument për ta mohuar një dëshmi, ndërsa në rastin e dytë për ta pohuar atë.



Rasti i tretë ishte kur vëllezërit e Jusufit, pas shumë vitesh kishin shkuar në Egjipt për të marrë grurë, ngase profetësia e Jusufit mbi thatësinë e madhe ishte realizuar dhe popujt jashta Egjiptit ishin varfëruar shumë nga ajo thatësi. Pasi që shkojnë për herën e dytë, dhe Jusufi iu tregon se ai ishte vëllai i tyre, ata i tregojnë se babai i tyre, Jakubi a.s., ishte verbëruar krejtësisht duke qarë nga dhembja e mërzia që ndjente për birin e tij Jusufin. Jusufi, kur ndjeu empatinë e dhembjes së një zemreje që kishte vuajtur shumë nga dashuria për të, u përmallua dhe ua la porosi që kur të ktheheshin prapë te vendi i tyre t'ia dërgonin babait këmishën e tij dhe t'ia vendosnin në fytyrë. “Kur karvani u largua nga vendi (Egjipti), babai i tyre tha: *“Unë, me të vërtetë, po ndiej erën e Jusufit, ndonëse ju mund të më quani matuf.”* (Jusuf, 94). Ishte një mrekulli e veçantë që e bashkonte Jusufin me babanë e tij. Raporti i parë si babë e bir, e raporti i dytë si dy pejgamberë të Allahut, që në këtë botë ishin me mision të veçantë. Jakubi a.s. nuk shikonte me sytë e ballit, por shikonte me sytë e zemrës. Ai e ndjente erën e të dashurit të tij, që ishte me ditë të tëra larg. Dhe përveç kësaj, nuk ishte ai fizikisht por ishte thjesht këmisha e tij. Kur erdhën vëllezërit e Jusufit dhe ia dhanë këmishën e tij, ai e vuri në fytyrë atë. Pasi e vuri këmishën në fytyrë, me lejen e Zotit iu kthye prapë shikimi. U kthye si ngadhënjimtar, dhe iu tha familjarëve të tij: *“A nuk ju kam thënë se unë di nga Allahu atë që ju nuk e dini.”* (Jusuf, 96). Në këtë rast, këmisha e Jusufit mbetet një lloj misteri i pazgjdhur, për të cilin duhet konsultuar fusha e tefsirit (komentimit) të Kuranit. Çdokush që e lexon pjesën e rikthimit të shikimit të Jakubit a.s. përmes këmishës së Jusufit a.s., mund t'i shkojë ndërmend se çfarë mund të ketë qenë puna e asaj këmishë. A mos ajo këmishë ka përmbajtur ndonjë aromë të veçantë që askush përveç pejgamberëve nuk ka mundur ta ndjejë?! A mos ajo këmishë ka qenë këmisha e paraardhësve të Jusufit, që kanë qenë të dërguar të Zotit, dhe është përcjellë brez pas brezi tek ai?! Këto megjithatë mbesin thjesht pyetje, por ajo që është me interes të përmendet është fakti që këmisha e Jusufit në këtë tregim nuk është thjesht një përsëkrim, por është një figurë, një alegori, një kuptim i

Zoti i
Madhëruar i
përmbledh në
ajetin 111
tërësisht
motivet e këtij
tregimi të
bukur, kur
thotë: “Në
tregimet e tyre
(të dërguarve
dhe të Jusufit
me vëllezër)
pati mësim e
përvojë për të
zotët e mendjes.
Ai (Kurani)
nuk është
bisedë e trilluar,
por vërtetues i
asaj që ishte më
parë (librave të
shenjta) dhe
squares i çdo
sendi, e edhe
udhërrëfyes e
mëshirë për një
popull që
beson.”

(Jusuf, 111)

dytë të cilin mund ta interpretojmë në mënyra të ndryshme.

MOTIVET E PËRGJITHSHME

Në këtë artikull mbi tregimin e Jusufit a.s. janë prekur dy pika interesante, që në pikëvështrimin tim kanë ngjyrimet letrare (duke përfshirë figurat si: metaforën, krahasimin, epitetin, etj.). Ëndrra është kryetema e këtij tregimi, ngase ajo është syzheu fillestar rreth të cilin zhvillohet e tërë ngjarja. Pastaj, simbolet që tregohen shpesh përmes kësaj bote, pra përmes botës së ëndrrave. Aspektet se si duhet të trajtohen ëndrrat, dhe se a duhet t'u tregohen ato të tjerëve apo jo!

Pastaj këmisha, e cila është një figurë shumë e bukur. Ajo zë vend jo të vogël në këtë kaptinë të Kuranit, ngase përmendet përafërsisht në dhjetë vende përgjatë tregimit. Ajo nuk shfaqet vetëm si kuptim i veshjes, por ajo herë pas here i jep kahje historisë. Çka po të mos ia sillnin vëllezërit e Jusufit këmishën e tij me gjak të rremë te babai?! Çka nëse nuk do të dëshmohej qëllimi i vërtetë i Jusufit me gruan e zotërisë, kush do ta besonte këtë ngjarje nga një burrë që ishte shërbëtor para se ta besonte nga një grua që ishte gruaja e një zotërie të shquar në Egjipt?! Pastaj çka nëse nuk do të rikthehej Jakubit a.s. shikimi, si do ta hiqte ndryshe mallin e Jusufit pa e parë atë edhe një herë me sy?! Të gjitha këto çështje shtjellohen shumë bukur në renditjen kronologjike të ngjarjeve përgjatë kësaj historie.

Zoti i Madhëruar i përmbledh në ajetin 111 tërësisht motivet e këtij tregimi të bukur, kur thotë: “Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësim e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kurani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe squares i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson.” (Jusuf, 111).

1 Rrëfime për të Dërguarit e Allahut, Hafidh ibën Kethir, përktheu: Muhamed Dolaku, Graf-ing, Prishtinë, 2011.

2 Referencë nga interneti: <https://www.simplypsychology.org>

Dobitë mjekësore të vajit të farës së zezë

Dr. Afërdita Zejnullahu

“Në farën e zezë ka shërim për çdo sëmundje, përveç vdekjes”

(Muhamedi, a.s.)

“Në farën e zezë ka shërim për çdo sëmundje, përveç vdekjes” – është hadithi i Pejgamberit a.s., me të cilin po e nis këtë artikull, shtysë për shkrimin e dobive të shumta që mund të sjell kjo bimë. Fara e zezë është emri i zakonshëm për farat e bimës *Nigella sativa*, e cila rritet në Evropën Jugore, Lindjen e Mesme dhe Azinë Jugperëndimore. Njihet gjithashtu si nigella, lule kopër dhe koriandër romak.

Nga këto fara nxirret vaji i farës së zezë. Si vaji, ashtu edhe farat, të cilat mund të konsumohen të papërpunuara ose të pjekura lehtë, janë përdorur prej kohësh si bimë mjekësore në rajonet ku rritet *N. sativa*.

Çelësi për të kuptuar pse vaji i farës së zezë ka këto veti të mrekullueshme është sepse është i pasur me tri kimikate kryesore

natyrore: timokinon (TQ), timohidrokinon (THQ) dhe timol.

I njohur për vetitë e tij të fuqishme medicinale, vaji i farës së zezë është një ilaç natyral që njerëzit përdorin për të trajtuar një gamë të gjerë gjendjesh, duke përfshirë: dhimbjet e kokës, dhimbjet e shpinës, presionin e lartë të gjakut, infeksionet, inflamacionet etj..

PËRFITIMET KRYESORE TË VAJIT TË FARËS SË ZEZË

Ndihmon në luftën kundër kancerit

Falë fitokimikateve të tij të fuqishme dhe aftësive antioksiduese, vaji i farës së zezë ka treguar se ndihmon në trajtimin natyral të kancerit.

Kërkimet in vitro në vitet e fundit zbulojnë se timokinoni, përbërësi më i bollshëm bioaktiv në vajin e farës së zezë, ndihmon në induktimin e apoptozës (vdekjes së programuar të qelizave) në qelizat e leukemisë, qelizat e kancerit të gjirit dhe qelizat e tumorit të trurit.

Për më tepër, studiuesit nga Qendra e Kancerit “Sidney Kimmel” në Jefferson Health, kanë treguar se jo vetëm që fara e zezë mund të shkatërrojë qelizat e kancerit të pankreasit, por gjithashtu duket se pengon zhvillimin e kancerit të pankreasit. Kjo aftësi parandaluese e kancerit i atribuohet timokinonit të farës së zezë dhe vetive të tij antiinflatore.



Fara e zezë dhe vaji i saj

PROMOVON SHËRIMIN E PLAGËVE

Përbërësi i vajit të farës së zezë, i quajtur timokinon, mund të stimulojë rritjen e indeve dhe të nxisë shërimin e plagëve. Timokinoni mund të ndihmojë në trajtimin e djegieve, heqjeve dhe plagëve diabetike për shkak të efekteve të tij antiinflatore, antioksidante dhe antibakteriale.

NDIHMON NË SHËNDETIN E FLOKËVE

Vaji i farës së zezë ka edhe përfitime të fuqishme për flokët. Meqenëse përmban nigellone, që sipas studimeve është një antihistaminë, mund të ndihmojë kundër rënies së flokëve për shkak të alopecisë androgjenike ose alopecisë areata. Me vetitë e tij antioksiduese, antibakteriale dhe anti-inflatore, ky vaj ndihmon gjithashtu në shëndetin e skalpit në përgjithësi, duke dekurajuar paraqitjen e zbokthit dhe thatësisë, dhe përmirësuar shëndetin e flokëve në të njëjtën kohë.

PROMOVON SHËNDETIN E MËLÇISË

Mëlçia njihet si laborator i organizmit të trupit të njeriut ngaqë, pothuajse çdo toksinë përpunohet përmes mëlçisë, dhe lëngu biliar është çelësi për të tretur yndyrat dhe për të mbajtur trupin tuaj të shëndetshëm. Për ata që kanë probleme me nënfunksinin e mëlçisë për shkak të efekteve anësore të ilaçeve, konsumimit të alkoolit ose sëmundjeve të ndryshme, vaji i farës së zezë mund të shpejtojë shumë procesin e shërimit, pasi vaji i farës së zezë rrit funksionin e mëlçisë dhe ndihmon në parandalimin e dëmtimeve dhe sëmundjeve të saj.

VAJI I FARËS SË ZEZË ËSHTË SHUMË I PASUR ME SELEN

Mënyra e të ushqyerit tonë me selen është e varfër, kurse mungesa e tij shkakton probleme shëndetësore. Seleni jo vetëm që është një mineral antioksidativ, por luan rol të veçantë në rregullimin e tajtijes së hormonit mashkullor (testosteronit) dhe në krijimin e spermatozoideve. Mungesa e selenit shkakton rënien e flokëve (alopeci), miopati (sëmundja e muskujve) dhe artritis (inflamacion i nyjave).

Seleni është mikroelement esencial i domosdoshëm për proceset oksidoreduktive në organizëm, dhe ndikon fuqishëm në funksionimin normal të sistemit imunologjik dhe të sistemit endokrin.

UL TENSIONIN E LARTË TË GJAKUT

Gati gjysma e të rriturve amerikanë kanë hipertension. Njerëzit me presion të lartë të gjakut mund të ndihmojnë në menaxhimin e gjendjes me ndryshime në stilin e jetës, si ngrënia e një diete të shëndetshme, heqja dorë nga pirja e duhanit dhe marrja me aktivitetet fizike çdo ditë. Por marrja e vajit të farës së zezë mund të ndihmojë edhe me hipertensionin. Hulumtimet sugjerojnë se marrja e 2.5 ml



dy herë në ditë mund të ndihmojë në uljen e presionit të lartë të gjakut.

SASIA E PËRDORIMIT TË VAJIT TË FARËS SË ZEZË

Çfarë përmban vaji i farës së zezë?

Një lugë çaji me vaj të farës së zezë përmban: kalori, 45; proteina, 0 gram; yndyra, 5 gram; karbohidrate dhe fibra, 0 gram.

RREZIQET E MUNDSHME TË FARËS SË ZEZË DHE VAJIT TË FARËS SË ZEZË

Fara e zezë dhe vaji i farës së zezë janë provuar kryesisht të sigurt në doza të vogla, por disa njerëz mund të përjetojnë disa efekte anësore, si të përziera dhe fryrje pas konsumimit të farës së zezë. Gjithashtu pasi fara e zezë mund të ndikojë në metabolizmin tuaj, mund të ndërhyjë në ndërveprimin me disa ilaçe. Flisni me mjekun tuaj nëse jeni duke marrë ndonjë ilaç që mund të ndikohet.

1. Rachaela Ajmera, MS, RD, 13.12.2023, [<https://www.healthline.com/health/food-nutrition/black-seed-oil-benefits>]
2. Herbal Line Albania, 09.06.2021, [<https://www.herballine.al/vajra-bimore-blog/107-vaj-fares-se-zeze-nigella-sativa-bio-organik-perfitimet-kryesore/>]
3. Natyral Vita, 01.10.2018. [<http://natyralvita.com/post/detail/Hulumtimet%20dhe%20Dobit%C3%AB%20e%20Far%C3%ABs%20s%C3%AB%20Zez%C3%AB>]
4. Leandra Beabout, 26.10.2023, [<https://www.singlecare.com/blog/black-seed-oil-benefits/>]
5. WebMD Editorial Contributor, Medically Reviewed by Mahammad Juber, MD on November 29, 2022, [<https://www.webmd.com/diet/black-seed-health-benefits>]

Intervistë me z. Ramadan Shkodrën, drejtor i Drejtorisë për Kulturë dhe Veprimtari Botuese në kuadër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës

Të arriturat e Shtëpisë Botuese “Dituria Islame” janë të mëdha, të shumta dhe të prekshme

Në kuadër të drejtorive të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, veprimtarinë e saj e zhvillon edhe Drejtoria për Kulturë dhe Veprimtari Botuese, e cila, sikurse kuptohet edhe nga titulli, në fokus ka jetën kulturore dhe veprimtarinë botuese. Këtë Drejtori aktualisht e drejton z. Ramadan Shkodra, me të cilin, për lexuesit e revistës “Dituria Islame” e zhvilluam këtë intervistë.

Në të vërtetë, biseda jonë me z. R. Shkodrën, ndodhi jo e paramenduar, por si rezultat i një takimi që patëm me të me rastin kur ne studentët e Fakultetit të Studimeve Islame të programit Master, iu drejtuam me kërkesën që për nevojat dhe ngritjen tonë dhe sidomos për sigurimin e literaturës së nevojshme për hartimin e tezave të punimeve tona në Fakultet, të na dhuroheshin botimet e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës. Kërkesa jonë u mirëprit nga z. Shkodra, i cili, me miratimin e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, pati mirësinë dhe na i dhuroi gjithë titujt e Kryesisë së BIK-ut, të cilët u panë me interes për ne, përse ne studentët e FSI-së i jemi mirënjohës dhe falënderues njëkohësisht. Pikërisht nga ky takim dhe nga dëshira jonë që të mësojmë sa më shumë dhe të njohim fillet, historinë, zhvillimin, dhe rriten e literaturës islame jo vetëm në Kosovë, lindi edhe ideja dhe insistimi ynë që ta zhvillojmë këtë intervistë me drejtorin z. R. Shkodra, i cili, pa hezitim, pranoi që të na përgjigjej në pyetjet tona.



Z. Shkodra, a mund të na thoni se nga kur zë fillin literatura islame në përgjithësi në gjuhën shqipe?

Si të gjitha ndërmarrjet e mëdha, edhe literatura islame në gjuhën shqipe zë fillin në periudhën e Rilindjes Kombëtare, për të marrë formë e trajtë sidomos pas pavarësisht dhe konstituimit institucional të Komuniteti Mysliman Shqiptar, i cili që i vetëdijshëm për rëndësinë që ka fjala e shkruar në njërin anë, dhe i ndërgjegjshëm për ngecjen e madhe që kishte në këtë fushë, në anën tjetër. Kështu që,

Literatura islame në gjuhën shqipe zë fillin në periudhën e Rilindjes Kombëtare, për të marrë formë e trajtë sidomos pas pavarësisht dhe konstituimit institucional të Komuniteti Mysliman Shqiptar.

Literatura islame në gjuhën shqipe në Kosovë, për shkak të rrethanave të pafavorshme që u krijuan pas vitit 1912, do të mund të fillonte dhe të shihte dritë vetëm një dekadë pas Luftës së Dytë Botërore.

botimeve islame u kushtoi një rëndësi të shtuar. Me gjithë prioritetet e shumta që kishte para vetes, Komuniteti Mysliman Shqiptar dhe dijetarët e kohës filluan të hartonin broshura e libra me përmbajtje për njohuritë fillestare islame (Fe-rrëfeje a mësimë muslimane nga Said Najdeni, botuar më 1909 në Elbasan; Myslimanësia nga Hfz. Ali Korça, 1918; Besimet e Myslimanvet nga hfz. Ibrahim Dalliu, Tiranë, 1921; Ilmihal nga Shefqet Muka, Shkodër 1923) etj., nga këtu edhe fillon botimi institucional i literaturës islame në gjuhën shqipe.

Në fillimet e botimit të kësaj literature të botuar cilat kanë qenë tematikat e trajtuara?

Nëse i hedhim një vështrim të shkurtër literaturës islame në gjuhën shqipe në zanafillën e saj vërejmë që nismëtarët, projektuesit dhe realizuesit e saj në gjuhën shqipe, pra në gjuhën e popullit kishin përgatitur e botuar literaturën bazike e tematike për njohuritë e fesë dhe besimit islam. Si nevojë e domosdoshme për besimtarët shqiptarë, respektivisht popullatën shqiptare që tashmë po konsolidohej në atë që njihet si kombformim e shtetformim. Me gjithë angazhimet e tyre që qenë të shumanshme, hartuesit e literaturës islame në gjuhën shqipe ishin kuadro të përgatitur e të brumosur shumë mirë si në rrafshin e njohurive e disiplinave fetare, ashtu edhe në atë të gjuhës e kulturës shqipe dhe në këtë mënyrë ata vunë themelet e literaturës islame në gjuhën shqipe duke i shërbyer asokohe ngritjes së ndjesisë dhe përkatësisë fetare ashtu edhe shtetërore e kombëtare.

Ata, si një nevojë kohe, do t'i hynin hartiimit dhe përkthimit të veprave profesionale nga fusha të islamologjisë: "Texhvid", i përkthyer nga hfz. Ibrahim Dalliu, Tiranë (1921); "Hytbe e dytë ose muhamedija", 1928; "Këshillat e së premtes", 1928; "Jeta e Hazretit Muhamedit sipas gojddhanave dhe shkrimtarëve të mëdhenj arabë", përkthyer nga italishtja më 1029; "Bilbil i fesë i sheriatit muhamedija", përktheu hfz. Abdullah Sëmlaku, Korçë, 1930 etj.

Duhet theksuar se në këtë periudhë pati iniciativa e projekte madhore, si fillimi i botimit të revistës "Zani i Naltë" më 1923 nga

KMSH, si dhe fillimi i botimit të përkthimit të Kuranit po nga KMSH - "Ajka e kuptimeve të Kur'anit Qerim" 1929, përkthyer nga hfz. Ibrahim Dalliu. Me një fjalë, ata përgatitën dhe botuan literaturë e nevojshme për njohuri themelore islame dhe për njohjen sa më të mirë dhe më burimore të fesë islame.

Cilët ishin ato personalitete të kohës që qenë nismëtarë dhe bartës kryesorë të literaturës islame në gjuhën shqipe?

Si edhe në shumë ndërmarrje të tjera të rëndësishme, e kuptueshme, edhe në ballë të kësaj nisme u gjendën figurat më eminente të asaj kohe, rilindësit tanë të shquar, si haxhi Vehbi Dibra, hfz. Isamet Dibra, hfz. Ibrahim Dalliu, hfz. Ali Korça, Ferid Vokopola, hfz. Abdullah Sëmlaku, Said Naideni, hfz. Ali Kraja, më pastaj Sadik Bega, Haki Sharofi e shumë të tjerë, të cilët veprimtarinë botuese e islame në gjuhën shqipe e vunë në binarë të mbarë dhe e trasuan një rrugë shumë të sigurt. Vetë emrat që i përmendem, besoj se për ju studentët e FSI-së, po edhe për lexuesit tanë, flasin mjaftë apo jo.

Sa ka mundur të depërtonte ajo literaturë në viset shqiptare jashtë Shqipërisë administrative?

Literatura islame shqiptare, që nisi të dilte atëkohë në Shqipëri, ishte projektuar për tërësinë etnike dhe popullin e saj. Mirëpo për shkak të rrethanave nëpër të cilat kaloi populli ynë e trojet tona, literatura islame që u botua pas vitit 1912 gjeti shprehje e hapësirë në Shqipërinë administrative, ndërsa në viset e tjera depërtoi më shumë vështirësi e në ilegalitet të plotë, ngase dihet mirëfilli qëndrimi i pushtueseve sllavë ndaj gjuhës e literaturës shqipe. Mirëpo, duhet thënë se me gjithë vështirësitë me të cilat është përballur literatura islame në gjuhën shqipe, s'ka dyshim se ka ndikuar dhe i ka mbajtur në një linjë dhe të bashkuar shqiptarët që u ndanë me dhunë nga trangu, e më vonë edhe ata të mërgatës, madje jo vetëm shqiptarët e besimit islam, por edhe besimtarët shqiptarë të feve të tjera, gjë që manifeston më së miri ndenjen e përkatësisë së përbashkët të popullit tonë.

Po në Kosovë, kur filloi të botohej literatura islame në gjuhën shqipe?

Literatura islame në gjuhën shqipe në Kosovë, për shkak të rrethanave të pafavorshme që u krijuan pas vitit 1912, do të mund të fillonte dhe të shihte dritë vetëm një dekadë pas Luftës së Dytë Botërore. Kjo si rezultat i riorganizimit të Bashkësisë Islame, e cila ishte e vetëdijshme për nevojën dhe rëndësinë e literaturës në gjuhën e besimtarëve të saj. Duhet theksuar se edhe literatura islame në gjuhën shqipe, pësoi po fatin e fjalës së shkruar shqipe në veçanti dhe fatin e popullit shqiptar nën okupimin serb në përgjithësi.

Varësisht se çfarë ishte zhvillimi i ngjarjeve në rrafshin politik, në atë shkallë që edhe zhvillimi i ngjarjeve edhe në rrafshin e identitetit kombëtar, përfshirë këtu edhe rrafshin fetar.

Pra, fati i zhvillimit dhe i rritës së botimeve islame në gjuhën shqipe në Kosovë, përveç faktorëve të tjerë, varej edhe nga mungesa e kuadrit që do të mund të shkruanin sipas kërkesave të kohës, pastaj mungesa e traditës dhe inferioriteti që institucionet jashtë Bashkësisë Islame kishin ndaj kulturës islame në përgjithësi e botimeve islame në veçanti.

Botimi i parë islam në gjuhën shqipe në Kosovë dhe përgjithësisht te shqiptarët e mbetur në ish-Jugosllavi është ai vitit 1957, me titullin “Ilmihali i vogël, për shkencat fillestare të fesë islame”, përkthyer nga gjuha serbokroate, botim, siç quhej asokohe, i Shoqatës së Ylemave për RSS në kuadër të BFI-së me seli në Prishtinë, Shoqatë kjo që ishte përgjegjëse për veprimtarinë botuese në kuadër të këtij institucioni. Me këtë doracak, të cilit nuk i dihet as përpiluesi dhe as përkthyesi në gjuhën shqipe, zë fill veprimtaria botuese islame në Kosovë, për të vazhduar deri më sot.

Ky botim siç kuptohet edhe nga titulli është doracak (ilmihal) për njohurit themelore islame.

Si është trajtuar literatura islame gjatë sistemit monist, kur dihet qëndrimi i atij sistemi karshi fesë islame dhe sidomos Bashkësisë Islame të Kosovës?

Sistemi monist ka pasur qasje jo dashamirëse ndaj feve e besimeve në përgjithësi, e ndaj fesë islame në veçanti. Kjo dëshmohet më së miri me mbylljen e institucioneve arsimore - medreseve shekullore menjëherë pas ardhjes së tyre në pushtet, pra pas Luftës së Dytë Botërore, pastaj persekutimit të ulemasë shqiptare dhe konfiskimit të nacionalizimit e pronave të BI-së. Të njëjtën qasje e kanë pasuar edhe ndaj literaturës islame në gjuhën shqipe. Mirëpo, ish-federata jugosllave, brenda saj kishte edhe fe e besime të tjera, kështu për shkak tyre, e sidomos për shkak të Kishës Ortodokse Serbe, kishte bërë një lloj rregullimi me kushtetutën dhe ligjet e kohës, ku bashkësive fetare u njihej e drejta e organizimit, e drejta e për të pasuar institucione arsimore për nevoja vetanake, si dhe e drejta për botime, normal nën mbikëqyrjen e rreptë të pushtetit të kohës. Paria e BIK-ut duke shfrytëzuar këto rrethana ka arritur që të riorganizohet, të krijoj



institucione, si dhe të vë bazat e literaturës islame në gjuhën shqipe, por pa ndonjë rezultat të madh. Duhet potencuar se literatura islame në Kosovë në gjuhën shqipe në zanafillën e saj është dominuar nga botimet që kanë të bëjnë me njohuritë themelore e elementare të besimit.

A mund të na thoni se sa kjo literaturë e botuar në ato rrethana e kushte e ka përmbushur misionin e saj?

Nëse marrim parasysh ngecjen që qe shkaktuar nga shumë faktorë, edhe literatura islame në gjuhën shqipe në Kosovës mund të themi se lind, hapëron e zhvillohet në ato premisa në të cilat ka kaluar kultura, literatura, e periodiku në gjuhën shqipe në Kosovë. Mund të them se varësisht nga rrethanat që kanë mbretëruar në vend, kemi edhe ngjitjen kulturore, arsimore e shpirtërore të popullit shqiptar në Kosovë. Mirë dihet që pas Plenumit të Brijoneve (1966), pozita e shqiptarëve në Kosovë njeh një përmasim të ndeshem, e në këtë rrafsh edhe Bashkësia Islame frymon më lirshëm dhe rezultatet janë më evidente. A e ka përmbushur misionin e saj literatura islame në sistemin monist?! Nga perspektiva e sotme, mund të themi se falë vizionit, urtësisë, pjekurisë e mençurisë së prijësve të BIK-ut, siç ishin hfz. Bajram Agani, hfz. Haki Ismailiustaibo, haxhi Sherif Ahmeti, Hajruallah ef. Hoxha, hfz. Avni Aliu, e të tjerë përmendja e të cilëve do të shkonte gjatë, në kushtet dhe rrethanat në të cilat kanë vepruar, kanë bërë më të mirën e mundshme, ata kanë arritur ta hedhin themelin e literaturës dhe na kanë trasuar rrugën në të cilën sot ne veprojmë.

Cilat janë sfidat, arritjet dhe sukseset e literaturës islame në Kosovën pas rënies së ish-sistemit?

Me literaturën islame deri më 1990, deri kur ra sistemi monist janë marrë vetëm institucionet kompetente, pra është marrë vetëm Bashkësia Islame dhe atë kryesisht Bashkësia Islame këtu në Kosovë, e cila ka botuar broshura, libra,



publikime e periodikun e saj për nevoja të besimtarëve myslimanë shqiptarë dhe jo vetëm, ndërsa pas vitit 1990, me botimin e literaturës islame merren shoqata, fondacione, shtëpie botuese e individë nga më të ndryshëm.

Pra, deri më 1990, kemi pasur botime të përgatitura mirë si në aspektin tematik ashtu edhe në atë ideologjik. Me një fjalë, kemi pasuar botime që u hynë në punë drejtpërdrejt besimtarëve tanë duke respektuar medhhebin dhe traditën vendore, e pas vitit 1990, kemi botime nga më të ndryshme të medhhebeve të tjera, e madje edhe fare pa medhheb, e të cilat sjellin një lloj konfuzioni te besimtarët dhe lexuesit, e besa edhe kokëçarje në mesin e ulemasë.

Pikërisht, për këtë deshëm t'ju pyesim. Pas luftës së fundit në Kosovë, si e shihni vërshimin e literaturës islame, e kemi fjalën literaturës islame që botohet jashtë institucioneve të BIK-ut?

Shihni, unë mendoj se me literaturën fetare duhet të merren institucionet fetare, e në këtë rast me literaturën islame në gjuhën shqipe duhet të merren institucione islame që veprojnë në hapësirat tona, pra bashkësitë islame (në Prishtinë, Tiranë, Shkup), e të cilat kanë kapacitete të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e besimtarëve tanë. Mirëpo pas luftës në Kosovë, siç e thatë edhe ju, kemi një vërshim të literaturës islame në gjuhën shqipe, nga botues nga më të ndryshëm të njohur e të panjohur, të cilët, lexuesve shqiptar u ofrojnë botime të medhhebeve të tjera që nuk përkasin me traditën tonë, po ashtu kanë botuar edhe literaturë ideologjike që nuk që bazohet në interpretime të ngurta e herë-herë ekstreme. Përveç kësaj, ky vërshim i literaturës islame në gjuhën shqipe në një farë mase ka prishur edhe tregun e librit islam në shqip, sepse botuesit në shumicën e rasteve kanë ofruar gratis – falas, e në këtë mënyrë edhe kanë dëmtuar botuesit e bashkësive islame. Kujtoj që

duhet rend e rregull në botimet e literaturës islame, sepse kemi të bëjmë me edukim shpirtëror të popullatës, e sidomos të të rinjve. Në të kundërtën, kjo ka pasojat e veta.

Cilat janë të arriturat dhe objektivat e Shtëpisë Botuese “Dituria Islame” për literaturën islame në gjuhën shqipe?

Të arriturat e Shtëpisë Botuese “Dituria Islame” janë të mëdha, të shumta dhe të prekshme. Që nga 1957, kur zë fill literatura islame në Kosovë e deri më sot, janë botuar mbi 250 tituj të fushave e disiplinave të ndryshme, duke filluar nga botimet bazike për njohuritë themelore të fesë islame e deri te botimet e veprave kapitale të gjithë në funksion të besimtarëve tanë. Këtu kisha për të veçuar botimin e dy përkthimeve të Kuranit në gjuhën shqipe, e të cilat janë edhe përkthimet e para të botuara komplet në shqip, pastaj vepra të rëndësishme nga fusha e fikhut, ajo e tefsirit, akaidit, qytetërimit islam e të tjera. Një kontribut të madh e të jashtëzakonshëm shtëpia botuese ka edhe në botimin veprave e monografive nga kultura, tradita dhe historia e popullit tonë, ndërsa objektiv parësor për të ardhmen ka avancimin e botimeve, rritjen e cilësisë në tematikë ashtu edhe në kulturën e gjuhës dhe shtimin e botimeve nga autorët tanë dhe personalitete të shquara të botës islame.

Z. Shkodra, Ju faleminderit që patët mirësinë për të zhvilluar këtë intervistë me ne.

Ju faleminderit edhe juve! Studentët e Fakultetit të Studimeve Islame kanë qenë dhe do të jenë të parët në prioritetet e Drejtorisë për Kulturë dhe Veprimtari Botuese dhe gjithsesi të vetë Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës.

Intervistën e zhvilluan:

Anisa HOTI dhe Sara EJUPI

Studente të Fakultetit të Studimeve Islame, programi MA

Të drejtat e punëtorëve dhe migrimi i popullsisë në Kosovë

Prof. ass. dr. Ferdi Kamberi

Të drejtat e njeriut janë të drejta universale me të cilat njeriu lind si qenie. Ato konsiderohen të patjetërsueshme, janë të drejta të cilat u takojnë të gjithë njerëzve, pavarësisht identitetit, fesë, gjinisë, ngjyrës, përkatësisë etnike apo sociale. Deklarata Universale e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, e cila është miratuar me 10 dhjetor të vitit 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, nënvizon se “Neni 1. Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymë vëllazërimi dhe Neni 2. Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh për sa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër. Asnjë dallim nuk do të bëhet në bazë të statusit politik, juridik ose ndërkombëtar të shtetit ose vendit të cilit i përket çdo njeri, qoftë kur shteti ose vendi është i pavarur, qoftë nën kujdestari, qoftë jo vetëqeverisës ose që gjendet në çfarëdo kushtesh të tjera të kufizimit të sovranitetit”. Kjo lë të kuptohet se njerëzit kanë të drejta të shumta të cilat nuk mund të përmbledhen me pak rreshta, por gjithsesi se janë të rëndësishme dhe të njëjtat mbrohen edhe me aktet më të larta juridike

Të drejtat e njeriut janë të drejta universale me të cilat njeriu lind si qenie. Ato konsiderohen të patjetërsueshme, janë të drejta të cilat u takojnë të gjithë njerëzve, pavarësisht identitetit, fesë, gjinisë, ngjyrës, përkatësisë etnike apo sociale.

– politike të vendit. Në kuadër të të drejtave të njeriut është edhe e drejta e punës, e cila është një ndër të drejtat themelore, sepse apriori ndërlidhet me veprimin e lirë të individit për të punuar, ushqyer dhe për të rritur mirëqenien socio – ekonomike, të cilat në fakt ndërlidhen ngushtë më shumë me të drejtat sociale. Kështu, “të drejtat e njerëzve që punojnë bazohen në idetë e drejtësisë sociale. Edhe nëse nuk zbatohen ligjërisht, të drejtat morale janë pretendime për t’u trajtuar me dinjitetin që i ka hije një qenieje njerëzore. Të drejtat personale (*droits subjectifs*) – të tilla si e drejta e organizimit dhe liria e fjalës – janë të drejta negative në kuptimin e mbrojtjes së autonomisë së individit nga ndërhyrja



shtrënguese. Nga ana tjetër, shumica e të drejtave sociale – si e drejta për punë, e drejta për sigurim social dhe kujdes shëndetësor – kërkojnë veprim pozitiv nga shteti dhe duhet të realizohen në mënyrë progresive”. Në shumë vende këto të drejta shkelen dhe shpeshherë abuzohet me punëtorët, duke i shfrytëzuar edhe për punë të tjera ose duke i lënë të punojnë dhe në fund të mbesin edhe pa pagë dhe kjo kryesisht ndodh në ato vende të cilat kanë një demokraci të brishtë ose janë shtete despotike. Sipas Indeksit Global të të Drejtave të Njeriut për vitin 2023, 10 vendet (shtetet) të cilat shkelen më së shumti të drejtat e punëtorëve janë: Bangladeshi, Bjellorusia, Ekuadori, Egjipti, Esvatini, Guatemala, Myanmar, Tunizia, Filipinet dhe Turqia. Ekuadori dhe Tunizia janë shtuar në listë që nga viti 2021. Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut janë identifikuar si rajoni më i keq në botë për njerëzit (punëtorët) që punojnë. Në kuadër të shkeljes së të drejtave të punëtorëve janë edhe vende të tjera, por kryesisht vendet të cilat kanë probleme të theksuara kanë edhe këto probleme. Në Ballkanin Perëndimor, të drejtat e punëtorëve janë shkelur shpeshherë dhe për këtë çështje kanë raportuar një mori e organizatave ndërkombëtare, përfshirë këtu Organizatën Ndërkombëtare të Punës - ILO-në. Në rastin e Kosovës shpeshherë është raportuar për shkelje të të drejtave të punëtorëve në profile të ndryshme, por më së shumti në profilin e ndërtimtarisë, ku edhe kanë humbur jetën shumë punëtorë. Të dhëna e raportuara nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese - BIRN kanë treguar “numri i punëtorëve të vdekur dhe punëtorëve të lënduar në vendin e punës vazhdon të jetë i lartë. Për më tepër, gjetjet gjatë inspektimeve të bizneseve rezultojnë të jenë serioze. Gjatë viteve 2021 - 2023, 33 punëtorë kanë vdekur nga 763 aksidente në punë. Statistikat tregojnë që vetëm në gjashtë muajt e parë të vitit 2023 kanë vdekur 9 punëtorë. Kjo tregon një rritje të rasteve të vdekjeve të punëtorëve si pasojë e aksidenteve në vendin e punës. Në një situatë ku reformat ligjore janë të ngadalta dhe kapacitetet e institucioneve për të kontrolluar e respektuar këto reforma janë të limituara, Kosova nuk po arrin të ndalojë vdekjet dhe aksidentet në vendin e punës e as të garantojë ndjekje penale për shkelësit e ligjit”. Në anën tjetër, sipas Ligjit të Punës, neni 5 theksohet se “Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi”. Pavarësisht këtij fakti, ka shkelje të

Në rastin e Kosovës shpeshherë është raportuar për shkelje të të drejtave të punëtorëve në profile të ndryshme, por më së shumti në profilin e ndërtimtarisë, ku edhe kanë humbur jetën shumë punëtorë.

të drejtave të punëtorëve të cilët si rezultat i pakënaqësive të shumta dhe mos realizimit të të drejtave të tyre, kanë vazhduar me migrimin për në vendet e tjera, për një standard më të mirë të jetës, duke pasur për bazë mirëqenien socio – ekonomike. Shkeljet e të drejtave të punëtorëve janë evidentuar në shumë profile. Madje, shpeshherë në sektorin privat, gratë janë më të rrezikuara që mund të dalin nga puna dhe mos t’ju vazhdohet kontrata nëse eventualisht shkojnë në pushim të lehonisë dhe në shumicën e rasteve detyrohen që të fshehin shtatzëninë e tyre, gjë që është tepër diskriminuese dhe shkelje flagrante e ligjit në fuqi. Kështu, sipas Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë nënvizohet se “ky ligj përmban parimet e përgjithshme për parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve të rrezikut dhe aksidenteve, informimit, konsultimit, pjesëmarrjes së balancuar në përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë, trajnimit të të punësuarve, përfaqësuesve të tyre dhe udhëzimeve të përgjithshme për zbatimin e këtyre parimeve”. Bazuar nga ky nen, shohim se legjislacioni e ka të rregulluar çështjen e respektimit të të drejtave të punëtorëve, por fatkeqësisht mungon zbatimi i tij në praktikë.

SHKAQET E SHKELJEVE TË TË DREJTAVE TË PUNËTORËVE

Kosova si shtet ende ballafaqohet me procesin e tranzicionit, i cili si duket ka shpërfaq një mori të problemeve të natyrës: politike, ekonomike, sociale, besa edhe atë kulturore. Sido që të jetë, mos zbatimi i ligjit në praktikë në pjesën më të madhe të rasteve ka prodhuar efekte të dëmshme në shumë sfera, përfshirë këtu të drejtat e punëtorëve, gjykimin e tyre, besa edhe vdekjen e tyre në vendet e punës. Për këtë me siguri se ka disa shkaqe të cilat janë të ndërlydhura. Së pari, mungesa e njohurive elementare për të drejtat e punëtorëve – shpeshherë punëtorët si në sektorin privat po ashtu edhe në atë publik nuk kanë njohuri adekuate për të drejtat e tyre, raportin me punëdhënësin dhe çështje të tjera të kësaj natyre. Një faktor tjetër është edhe inflacioni i çmimeve, të cilat kanë ndryshuar dukshëm së fundi, megjithëse kjo varet edhe nga ndryshimet globale, konfliktet e ndryshme, kriza e recensionit, si dhe probleme të tjera. Sido që të jetë, një gjë është e sigurt se në Kosovë ende paga minimale është më e vogla në raport me vendet e rajonit. Pra, paga minimale në Kosovë, nga viti 2011, është 130 euro për personat nën moshën 35 vjeç dhe 170 euro për ata mbi 35 vjeç. Kurse paga mesatare bruto për vitin 2021, sipas ASK-së, ka qenë 484

euro, gjë që tregon më së miri këtë fakt. Gjithashtu, faktor tjetër është edhe mungesa e sigurimeve sociale dhe shëndetësore, ku edhe pse ekziston një draft-ligj, si duket ende nuk është prioritet sigurimi social dhe shëndetësor, nga i cili do të mund të përfitonin qytetarët e Kosovës dhe kjo e vendos Kosovën në hartën e atyre vendeve të rralla të cilat ende nuk kanë një ligj të tillë. Faktor tjetër është edhe mungesa e zbatimit të ligjit në praktikë, e cila ndërlidhet ngushtë numrin e inspektimeve nga inspektorët e punës. Kosova aktualisht “ka mbi 400,000 të punësuar në mbi 85,000 biznese aktive. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit në tërë këtë hapësirë u është besuar vetëm 82 punëtorëve të Inspektoratit të Punës”. Ankesat e pakta, numri i vogël i inspektimeve dhe numri i vogël i veprimeve gjyqësore, padyshim se janë një ndër faktorët kryesorë pse sot ka shkelje të të drejtave të punëtorëve në Kosovë. Në këtë kontekst ka edhe faktorë të natyrave të ndryshme me të cilat përballen këta inspektorë, përfshirë kapacitetet e tyre, mungesën e automjeteve, sigurinë sociale, si dhe faktorë të tjerë që në një ose tjetrën mënyrën e pamundësojnë një inspektim profesional. Të dhënat tregojnë se numri i inspektimeve së fundi është rritur në raport me të kaluarën, por gjithsesi se problemet janë goxha të mëdha. Studimi i BIRNI-it në këtë fushë pasqyron këto të dhëna, si vijon:

nga Agjencia e Statistikave të Kosovës – ASK, numri i të lënduarve dhe të vdekurve në vendin e punës nga viti 2015 deri në vitin 2022 është, si vijon:

Periudha kohore	Totali inspektimeve
2021	3,022
2022	6.316
Janar - Tetor 2023	6.347

Burimi: ASK

Pra, siç mund të shohim nga viti 2015 deri në vitin 2022 sipas të dhënave nga ASK, në vendin e punës kanë humbur jetën 102 persona dhe janë lënduar 1,159 persona. Këto të dhëna janë raportuar nga spitalet publike, përderisa nuk ka të dhëna ose raportime nga spitalet private.

Faktor tjetër në këtë segment është edhe operimi i bizneseve private të cilët kanë një numër goxha të madh të punëtorëve pa kontratë ose siç njihet te ne në të ‘zëzën’. Ky fakt edhe më shumë e rëndon gjendjen e punëtorëve, pasi që pa një

Vitet	Sipas spitaleve publike	
	Numri i të lënduarve në vendin e punës	Numri i të vdekurve në vendin e punës
2015	47	9
2016	62	9
2017	50	14
2018	125	23
2019	133	12
2020	160	11
2021	188	9
2022	394	15
TOTALI	1,159	102

Burimi: BIRN

Pra, shohim se numri i inspektimeve është rritur së fundi, megjithatë kjo nuk mjafton për të ushtruar monitorimin profesional të shkeljeve të të drejtave të punëtorëve dhe për të vendosur një drejtësi sociale. Numri i punëtorëve të cilët janë lënduar në punë apo edhe kanë humbur jetën sipas viteve është goxha i lartë. Lidhur me këtë, sipas të dhënave

kontratë pune është shumë e vështirë të dëshmojnë rregullat e marrëveshjes në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit. Faktorë të tjerë janë edhe mos ngritja e zërit nga ana e organizatave të shoqërisë civile, në veçanti Sindikatave të Punëtorëve, të cilët ishte dashur të jenë më të zëshëm në këtë segment.

MIGRIMI I POPULLSISË DHE ARDHMJA

Migrimet janë komponentë socio – demografike, që i kanë përcjell shoqëritë e ndryshme kohë pas kohe deri në ditët e sotme dhe që akoma vazhdon. Njerëzit, për shkaqe të natyrave të ndryshme migrojnë në relacionet fshat – qytetet, qytet – qytet apo në relacionet shtet – shtet. Migrimet mund të jenë të përkohshëm, të përhershme, sezonale, vjetore, bashkim familjar apo edhe migrime të tjera, të cilat ndikohen nga dy faktorë kryesor: Push (tërheqës) dhe pull (shtytës). Së fundi, pas liberalizimit të vizave, Kosova është duke u ballafaquar edhe me rritjen e trendit të migrimit, sidomos të fuqisë punëtore, e cila për shkak të kushteve dhe standardit më të mirë jetës, çdo herë e më shumë është duke e lëshuar Kosovën. Kjo vërehet dukshëm në profilin e shteteve kryesisht perëndimore të cilët ofrojnë kushte më të mira për punëtorët dhe familjet e tyre. Sipas të dhënave të MPB-së ‘Profil Vjetor i Migrimit për vitin 2022’, del se “numri i emigrantëve kosovarë gjatë vitit 2022, i vlerësuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës ishte gjithsej 41,553 persona apo 2.36 % e popullsisë rezidente. Në këtë numër janë përfshirë të gjithë emigrantët pa marrë parasysh arsyen e migrimit dhe statusin e tyre (rregullt dhe parregullt)”. Padyshim se ndër shkaqet e këtij migrimi janë edhe nevojat për kushte më të mira të jetës, standardi më i mirë jetësor dhe kushtet më të mira për punë dhe dinjitet njerëzor. Si profile të cilat janë të kërkuara nga shtetet perëndimore hyjnë: punëtorët e krahut, mjekët, infermierët, gastronomia, zanatet e ndryshme, e të tjera. Ky fakt është sinjal për shoqërinë kosovare dhe për institucionet e vendit se Kosova së shpejti, sikurse vendet e tjera në nivel global, do të sfidohet nga dy çështje madhore: e para migrimi i popullsisë kryesisht të rinjë të cilat janë fuqia më e madhe e punëtorëve në Kosovë, së dyti mplaķja e popullsisë e cila do të vijë si pasojë e këtij migrimi dhe uljes së natalitetit. Me liberalizimin e vizave është rritur dukshëm tendenca për të migruar dhe për t’u integruar në mjediset tjera sociale. Në anën tjetër, tashmë kanë filluar të vijnë në Kosovë për të gjetur punë edhe punëtorë nga vendet e Lindjes së Largët, përfshirë vendet e tilla si: India, Egjipti, Iraku, Afganistani, Indonezia, Bangladeshi, e të tjera, duke zëvendësuar kështu fuqinë punëtore në Kosovë.

Si përfundim, mund të themi se shkelja e të drejtave të punëtorëve në Kosovë gjatë këtyre viteve sidomos në sektorin privat, ka prodhuar pasoja të paparashikueshme të cilat janë grumbulluar si një lloj ‘katarsisi psikologjik’



dhe tani më kanë dalë në sipërfaqe duke shfaqur pasoja dhe lënë gjurmë në popullsinë dhe ekonominë e vendit. Pagat e ulëta, trajtimi jo dinjitoz, mungesa e sigurimeve shëndetësore dhe sociale, siguria në punë, mungesa e inspektimeve, puna pa orar, mungesa e kushteve elementare të punës, mungesa e implementimit të kontratës kolektive, si dhe faktorë të tjerë, kanë bërë që sot punëtori kosovar të shikojë drejt vendeve të tjera, të migron, të krijojë një stabilitet socio – ekonomik dhe Kosova të mbetet nën mëshirën e fatit, nën mplaķjen e popullsisë dhe migrimin e fuqisë punëtore. Pasojat padyshim se do të reflektojnë në një të ardhme të afërt të cilat do të reflektojnë jo vetëm tek individi, por edhe te familja, komuniteti, shoqëria dhe vetë shteti.

Së fundi, pas liberalizimit të vizave, Kosova është duke u ballafaquar edhe me rritjen e trendit të migrimit, sidomos të fuqisë punëtore, e cila për shkak të kushteve dhe standardit më të mirë jetës, çdo herë e më shumë është duke e lëshuar Kosovën.

Literatura

- APKB: “Deklarata e Përgjithshme mbi Të Drejtat e Njeriut”, Nju Jork, më 10 dhjetor të vitit 1948.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës: “Seria 5: Statistikat Sociale Statistikat e Shëndetësisë 2022”, ASK, Prishtinë, 2022.
- Buzhala, Jetlira: “Viktimat e Padrejtësisë”, BIRN, Prishtinë.
- Hepple, Bob: “Rights at Work”, International Institute for Labour Studies Geneva, Geneva, 2002.
- Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, neni 5.
- Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë
- MPB: “Profil Vjetor i Migrimit për vitin 2022”, MPB, 2023.
- TURHR: “Record high level of workers’ rights violations in 2023, Global Rights Index reports”, trade union rights are human rights, publikuar 14 July 2023, shih: <https://ëëë.ei-ie.org/en/item/27834:record-high-level-of-workers-rights-violations-in-2023-global-rights-index-reports>

Diskriminimi gjinor në vendin e punës

Azemine Kukaj

Edrejta për punë nuk është vetëm një e drejtë bazë me natyrë social-ekonomike, por edhe një nga të drejtat themelore të njeriut. Ndonëse në aspektin e legjislacionit, Republika e Kosovës ka ligje që e rregullojnë të drejtën e punësimit dhe të drejtën e trajtimit të barabartë në çështjet që lidhen me punën, situata në jetën reale është shqetësues.

Krahas zhvillimeve të hovshme teknologjike dhe sfidave nga trendet e shpejta ekonomiko-sociale, shoqëria po përballlet me një pengesë të vazhdueshme: diskriminimin gjinor në vendin e punës. Kjo gjë, jo vetëm që minon parimet e drejtësisë dhe barazisë, por gjithashtu mbyt inovacionin, rritjen ekonomike dhe përparimin shoqëror në përgjithësi. Është për t'u studiuar fakti se praktikatat të tilla ndodhin shpesh edhe pa u vënë re, dhe mbesin edhe të pa adresuara. Në këtë artikull, paraqesim efektet e diskriminimit gjinor në dinamikën e fuqisë punëtore dhe implikimet e kësaj dukurie me stagnimin e zhvillimit socio-ekonomik dhe edukativ në mbarë shoqërinë.

NDARJA GJINORE NË VENDIN E PUNËS

Pavarësisht hapave drejt barazisë gjinore në dekadat e fundit, pabarazitë vazhdojnë në aspekte të ndryshme të jetës së punës. Sipas hulumtimit të UNMIK-ut, nga viti 2014, gratë janë të përfshira në sistemin politik me rreth 30% pjesëmarrje, ndërsa burrat janë dukshëm më të përfaqësuar, rreth 70%.¹ Përfaqësimi i grave prej 30% pjesëmarrje është një

Pabarazia gjinore është sfidë globale, ndonëse është më e theksuar në vendet e pazhvilluara, ani pse kjo sfidë është edhe për vendet e zhvilluara. Një nga manifestimet më të dukshme është hendeku i pagave gjinore në shumë vende të botës, ku gratë vazhdojnë të fitojnë më pak se homologët e tyre meshkuj për punë ekuivalente.

përmbushje e kushtëzuar nga ligji, por ky nuk është një indikator matës, sepse kjo pjesëmarrje nuk siguron se zëri i tyre është i dëgjuar, përveçse në një masë më të vogël. Sipas Agjencisë së Statistikave të Republikës së Kosovës, shkalla e punësimit në mesin e femrave në moshë pune është vetëm 18.5 %, krahasuar me 51.5 % për meshkujt.²

Pabarazia gjinore është sfidë globale, ndonëse është më e theksuar në vendet e pazhvilluara, ani pse kjo sfidë është edhe për vendet e zhvilluara. Një nga manifestimet më të dukshme është hendeku i pagave gjinore në shumë vende të botës, ku gratë vazhdojnë të fitojnë më pak se homologët e tyre meshkuj për punë ekuivalente. Kjo pabarazi në paga jo vetëm që i privon gratë nga siguria financiare, por gjithashtu thëllon pabarazinë ekonomike brenda komuniteteve. Sipas një raporti nga



Byroja e Statistikave të Punës në Shtetet e Bashkuar, paga e një gruaje, është 83.8% e pagës së një burri për pozicionin e njëjtë.³

Sipas raportit 'Global Gender Gap' të Forumit Ekonomik Botëror 2021, gratë në nivel global fitojnë 77% të asaj që fitojnë burrat, duke treguar një hendek të vazhdueshëm pagash gjinore.⁴

Diskriminimi gjinor manifestohet në mënyra delikate, por me ndikim, siç janë mundësitë e kufizuara të avancimit në karrierë për gratë, nën përfaqësimi në rolet drejtuese dhe paragjykimet në proceset e rekrutimit dhe promovimit. Këto barriera, jo vetëm që pengojnë rritjen individuale të karrierës, por gjithashtu i privojnë organizatat nga perspektivat dhe talentet e ndryshme, duke penguar përfundimisht inovacionin dhe përparimin.

NDIKIMI I FAMILJES NË DISKRIMINIMIN GJINOR

Dinamika e familjes luan një rol kyç në formësimin e qëndrimeve, besimeve dhe sjelljeve të individëve në lidhje me rolet dhe pritjet gjinore. Familjet mund të jenë një burim fuqizimi dhe mbështetjeje për barazinë gjinore, por ato gjithashtu mund të jetësojnë dhe përforcojnë pa dashje diskriminimin gjinor.

Që në moshë të re, fëmijët brendësojnë normat shoqërore dhe pritshmëritë për rolet gjinore nga familjet e tyre. Prindërit, kujdestarët dhe anëtarët e familjes së gjerë, shpesh ndikojnë në perceptimet e fëmijëve për atë që konsiderohet sjellje e përshtatshme ose e pranueshme bazuar në gjininë e tyre. Këto procese të hershme socializimi mund të sfidojnë ose të përforcojnë stereotipat dhe paragjykimet tradicionale gjinore.

Sjelljet dhe qëndrimet e shfaqura nga prindërit brenda njësive familjare formësojnë ndjeshëm kuptimin e fëmijëve për rolet gjinore. Komunikimi i hapur dhe i sinqertë që vlerëson diversitetin dhe gjithëpërfshirjen është thelbësor për promovimin e një mjedisi familjar më të barabartë.

Familjet mund të jenë një forcë e fuqishme për të ushqyer vlerat e barazisë dhe respektit, ato gjithashtu mund të përforcojnë diskriminimin gjinor. Roli i edukatës familjare është kyç në adresimin e drejtë të barazisë gjinore. Familja mund të bëhet katalizator për ndryshime pozitive, duke rrënjësuar vlerat e drejtësisë, gjithëpërfshirjes dhe fuqizimit në brezat e ardhshëm.

Diskriminimi gjinor në vendin e punës, është si rezultat i diskurseve të hershme, sfidave sociale, rrethanave edukative-ambientale nëpër të cilat kalojnë gjinia femërore që nga lindja.

PSE KOMPANITË HEZITOJNË PUNËSIMIN E PUNONJËSEVE TË GJINISË FEMËRORE

Ka arsye të ndryshme pse disa kompani mund të hezitojnë të punësojnë staf femra. Këtu janë disa faktorë të mundshëm, që kryesisht janë stereotipa:

Stereotipat gjinore – Disa kompani mund t'i përmbahen stereotipave tradicionale gjinore, që supozojnë se gratë janë më pak të afta ose të përkushtuara për karrierën e tyre në krahasim me burrat. Kjo mund të çojë në paragjykimet në vendimet e punësimit.

Përgjegjësitë familjare – Ekziston një stereotip se gratë kanë më shumë gjasa t'i japin përparësi përgjegjësiave familjare mbi punën, duke i bërë disa punëdhënës të supozojnë se punonjëset femra mund të jenë më pak të besueshme ose të përkushtuara.

Paragjykimi gjatë rekrutimit – Paragjykimet e pavetëdijshme mund t'i bëjnë menaxherët e punësimit të preferojnë kandidatët që u përshtaten nocioneve të tyre të paramenduara se si duhet të duket një punonjës "tipik", i cili shpesh përputhet më afër me karakteristikat mashkullore në industri të caktuara.

Shqetësimet rreth pushimit të lehonisë – Disa punëdhënës mund të kenë shqetësime për kostot e mundshme ose ndërprerjet që lidhen me pushimin e lehonisë, duke i bërë ata të preferojnë punësimin e kandidatëve meshkuj sesa kandidatëve femra në moshë riprodhimi.

Shqetësimet e ngatërresave ndërgjinore – Shumë përgjegjës të kompanive, preferojnë të shmangen punësimit të stafit të gjinisë femërore, me arsyetimin se 'mund t'iu dalin probleme të ngacmimeve seksuale', apo ngatërresave me familjarë të të punësuarve.

PASOJAT E DISKRIMINIMIT GJINOR

Diskriminimi gjinor në vendin e punës, është si rezultat i diskurseve të hershme, sfidave sociale, rrethanave edukative-ambientale nëpër të cilat kalojnë gjinia femërore që nga lindja. Pengesat të tilla, gjininë femërore e bëjnë të ndihet inferiore dhe lehtësisht të konsiderojnë edhe normë të pranueshme diskriminimin që i bëhet asaj vetë. Por cilat janë pasojat e diskriminimit gjinor?

Diskriminimi gjinor vepron si një pengesë për gratë që të hyjnë në industri të caktuara ose të ndjekin edukim që do sillte ato në pozita pune të nivelit më të lartë. Diskriminimet që gjinia femërore përballen, shndërrohen në norma të pranuar në heshtje, të cilat norma mbysin ambiciet dhe



motivin për angazhim në rritje të talenteve dhe edukim. Kjo humbje e talenteve dhe e kontributeve të mundshme, jo vetëm që mbyt aspiratat individuale, por gjithashtu pengon rritjen kolektive të industrive dhe sektorëve. Kur individët e aftë anashkalohen në bazë të gjinisë dhe jo meritës, është shoqëria në tërësi ajo që vuan nga mungesa e aftësive, ideve dhe inovacioneve të ndryshme.⁵

Përtej dimensioneve sociale dhe etike, diskriminimi gjinor ka një ndikim të konsiderueshëm ekonomik. Studimet tregojnë vazhdimisht se mbyllja e hendekut gjinor në paga dhe promovimi i barazisë gjinore në fuqinë punëtore, mund të rrisë produktivitetin, të nxisë inovacionin dhe të kontribuojë në rritjen e përgjithshme ekonomike. Anasjelltas, praktika diskriminuese rezultojnë me kapital njerëzor të pashfrytëzuar dhe mundësi të humbura për avancim dhe prosperitet.

Diskriminimi i vazhdueshëm gjinor, heshtazi shndërrohet në një ‘normë të pranuar’, e cila heshtazi jo vetëm që pamundëson barazi sociale, por vret edhe motivin për të bërë ndryshime në këtë drejtim. Si rezultat, rastet e diskriminimit në punë, në vend që të adresohen drejt, çorientojnë veprimet e individëve, veçanërisht gjinisë femërore, të cilat në heshtje e pranojnë pozicionin e tyre inferior, heshtin për

“O njerëz, me të vërtetë Ne ju krijuam nga mashkulli dhe femra dhe ju bëmë popuj dhe fise që të njiheni me njëri-tjetrin. Vërtet, më fisniku prej jush tek Allahu është më i devotshmi prej jush.”

(Huxhurat, 13)

abuzimet e mundshme, apo edhe preferojnë të mos punojnë fare.

Është e njohur thënia ‘një nënë e demotivuar, do rris një fëmijë pa ambicie’. Kjo qëndron fuqishëm sidomos për vajzat e reja, të cilat në padrejtësitë sociale të së ëmës, shohin veten e tyre. Edukimi i vajzave të reja në frymë depresive është me pasoja afatgjata.

BARAZIA GJINORE NË ASPEKTIN FETAR

Kurani trajton barazinë gjinore në disa mënyra, duke theksuar vlerën dhe të drejtat e barabarta të burrave dhe grave, duke njohur gjithashtu rolet dhe përgjegjësitë e tyre të dallueshme. Këtu janë pikat kyçe në lidhje me barazinë gjinore siç përshkruhet në Kuran:

Statusi i barabartë shpirtëror – Kurani thekson se si burrat, ashtu edhe gratë janë të barabartë në vlerën e tyre shpirtërore dhe kanë mundësi të barabarta për të arritur kënaqësinë e Zotit. Për shembull, në suren El Huxhurat (49:13), thuhet se “O njerëz, me të vërtetë Ne ju krijuam nga mashkulli dhe femra dhe ju bëmë popuj dhe fise që të njiheni me njëri-tjetrin. Vërtet, më fisniku prej jush tek Allahu është më i devotshmi prej jush.”

Përgjegjësi e barabartë – Si burrat, ashtu edhe gratë janë përgjegjës për veprimet e tyre përpara Zotit. Kurani nuk cakton përgjegjësi apo llogaridhënie më të madhe bazuar në gjini. Surja El Ahzab (33:35) thotë: “Me të

vërtetë, myslimanët dhe myslimanet, besimtarët dhe besimtare, të bindurit dhe gratë e bindura, të sinqertët dhe gratë e sinqerta, burrat dhe gratë e durueshme, burrat e përlulur dhe gratë e përlulura, burrat bamirës dhe gratë bamirëse, agjëruesit dhe gratë agjëruese, burrat që ruajnë pjesët e tyre intime dhe gratë që e bëjnë këtë...”

Mundësitë arsimore – Kurani inkurajon si burrat, ashtu edhe gratë që të kërkojnë dituri dhe arsimim. Surja El Zumer (39:9), thekson rëndësinë e marrjes së njohurive dhe ky urdhër nuk është i veçantë për gjininë.

Respekti dhe dinjiteti – Kurani thekson dinjitetin dhe respektin e qenësishëm për çdo individ, pavarësisht nga gjinia. Surja En Nisa (4:1), thotë: “O njerëz, kini frikë Zotin tuaj, i cili ju krijoi prej një shpirti dhe prej tij krijoi shoqen e tij dhe prej tyre shpërndau shumë burra dhe gra. Dhe kini frikë Allahun me të cilin kërkonin njëri-tjetrin dhe mitrat, me të vërtetë, Allahu është mbi ju, mbikëqyrës.”

Këto pika nga Kurani pasqyrojnë parimet e barazisë dhe drejtësisë gjinore, duke inkurajuar një shoqëri ku burrat dhe gratë mund të jetojnë në harmoni, të kontribuojnë në komunitetet e tyre dhe të përmbushin potencialin e tyre në përputhje me mësimet islame.

PËRFUNDIM

Për të parandaluar diskriminimin gjinor në vendin e punës, është thelbësore të promovohet një kulturë e diversitetit, barazisë dhe përfshirjes. Një ambient i shëndosh punë, ku secili dhe secila pjesëtare ndihet i trajtuar drejt, është tregues kyç për kredibilitetin e një kompanie.

Është shumë më rëndësi që mbikëqyrja e shtetit të jetë e kujdesshme në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të qarta që ndalojnë diskriminimin gjinor në të gjitha aspektet e punësimit, duke përfshirë punësimin, promovimin, kompensimin, trajnimin dhe përfundimin. Kompanitë duhet të sigurojnë që këto politika të komunikohen në mënyrë efektive të gjithë punonjësve dhe ofrojnë trajnime mbi diversitetin, barazinë dhe përfshirjen për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të promovuar të kuptuarit e sjelljes së pranueshme.

Shteti duhet të promovojë diversitetin gjinor në rolet e lidershipit dhe vendimmarrjes, në radhë të parë duke garantuar zbatimin e barazisë gjinore dhe meritokracisë në institucionet publike, duke siguruar auditime të rregullta të barazisë së pagave dhe zbatimin e praktikave transparente dhe të drejta të kompensimit, me kritere të qarta për përcaktimin e pagave dhe avancimeve, për të siguruar pagë të barabartë për punë të barabartë.

Shteti si dhe shoqëria civile duhet të angazhohet që të ofrojnë akces të barabartë në mundësitë e zhvillimit të karrierës, programet e trajnimit, mentorimin dhe iniciativat



e rrjetëzimit për të gjithë punonjësit, pavarësisht nga gjinia. Fokus të veçantë duhet të ketë krijimi i shtigjeve për avancim që bazohen në aftësitë, performancën dhe potencialin, në vend të gjinisë ose faktorëve të tjerë të parëndësishëm.

Promovimi i një kulture respekti, civilizimi dhe përfshirjeje, ku të gjithë punonjësit ndihen të vlerësuar, të dëgjuar dhe të mbështetur është domosdoshmëri, ashtu siç është edhe formimi i mekanizmave mbikëqyrës të komunikimit dhe reagimit për të adresuar shqetësimet që lidhen me diskriminimin, ngacmimin ose paragjykimin menjëherë dhe në mënyrë efektive.

Sfiduese për shumicën e grave është gjetja e balancës punë-jetë. Andaj, shteti dhe shoqëria civile, duhet të punojnë në drejtim të mundësive sa më fleksibile të punës, politika të lejes prindërore dhe programe mbështetëse që u ndihmojnë në angazhimin e tyre, por gjithnjë duke u kujdesur për balancën e meritokracisë. Duke marrë masa proaktive për të parandaluar diskriminimin gjinor dhe për të promovuar barazinë gjinore, organizatat mund të krijojnë një vend pune më gjithëpërfshirës, të drejtë dhe mbështetës për të gjithë punonjësit.

1 Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2017.

2 Anketa e Fuqisë Punëtore, TMI, 2023.

3 Bloomberg News, 18.01.2024.

4 Global Gender Gap Report, 2021.

5 Pew Research Center, 2023 www.pewresearch.org



Paqja - kërkesë njerëzore dhe detyrim hyjnor

Mr. Besa Ismaili

Paqja është nevojë themelore njerëzore e rëndësishme për mirëqenien dhe lumturinë tonë të përgjithshme. Ajo nënkupton jo vetëm mungesën e dhunës dhe konfliktit, por edhe një ndjenjë sigurie, lumturie dhe të harmonisë në marrëdhëniet ndër njerëzore, pa dallim. Pa paqe, ka frikë, konflikt dhe vuajtje, që çojnë në ndarje dhe shkatërrim.

Si e tillë, paqja nuk është vetëm një synim dëshirues, por një detyrim moral dhe detyrim hyjnor. Në shumë tradita fetare, paqja konsiderohet si një dhuratë hyjnore dhe një reflektim i harmonisë dhe rregullit që ekziston në univers. Ajo shihet si një manifestim i mëshirës së Zotit, dhembshurisë dhe dashurisë për njerëzimin.

Paqja është qenësore edhe për shëndetin tonë mendor dhe fizik, që na mundëson të ndjehemi më pranë njëri-tjetrit, më të lidhur, të pajtuar dhe të bashkuar. Paqja mendore mundëson kreativitet intelektual, sofist dhe artistik.

Në kohëra konflikti dhe trazirash, është e rëndësishme të prioritetizojmë përpjekjet për ndërtimin e paqes dhe të promovojmë dialogun, pajtimin dhe mirëkuptimin midis individëve dhe komuniteteve.

Paqja është një detyrim i shenjtë për besimtarët, pasi që është mësim qendror në shumë tradita dhe besime fetare. Për të krishterët, paqja theksohet në mësimet e Jezusit. Në Islam, paqja është thelbësore për konceptin e “Selamit/Silmit”, që do të thotë

Paqja konsiderohet si një dhuratë hyjnore dhe një reflektim i harmonisë dhe rregullit që ekziston në univers. Ajo shihet si një manifestim i mëshirës së Zotit, dhembshurisë dhe dashurisë për njerëzimin.

paqe dhe nënshtrim ndaj vullnetit të Perëndisë. Në hinduizëm, paqen e lidhin me konceptin e “ahimsa” që nënkupton mungesën e dhunës.

PAQJA SI THIRRJE HYJNORE

Mësimet fetare shpesh theksojnë rëndësinë e kërimit të paqes, promovimin dhe përbrendësimin e faljes. Besimet inkurajojnë individët që të kultivojnë paqen brenda tyre nëpërmjet vetëdijes, lutjes dhe meditimit.

Paqja është një koncept i rëndësishëm në Islam dhe myslimanët inkurajohen të





përpiqen për paqen në të gjitha aspektet e jetës së tyre. Në fakt, paqja konsiderohet si obligim në Islam, pasi është parim themelor i fesë.

Për më tepër, Islami mëson se myslimanët duhet të përpiqen për paqe jo vetëm në marrëdhëniet e tyre ndër personale, por edhe në shoqërinë e tyre në tërësi. Myslmanët inkurajohen të promovojnë drejtësinë, barazinë dhe dhembshurinë në ndërveprimet e tyre me të tjerët dhe të punojnë drejt zgjidhjes së konflikteve dhe mosmarrëveshjeve përmes dialogut në mënyrë paqësore.

Në përgjithësi, paqja konsiderohet obligim në Islam, sepse është parakusht për mirëqenien e individëve, komuniteteve dhe shoqërisë njerëzore në tërësi. Myslmanët inkurajohen të mishërojnë parimet e paqes në jetën e tyre të përditshme dhe të përpiqen për një botë pa dhunë, shtypje dhe padrejtësi.

Besimtarët thirren të punojnë aktivisht për paqen në jetën e tyre dhe në shoqërinë që i rrethon. Kjo nënkupton ndihmën në avokimin për drejtësi, promovimin e pajtimit, përpjekjen për të kuptuar dhe bashkëndjerë të tjerët. Në thelb, paqja është pasqyrim i pranisë së besimit në Zot në çdo person, dhe besimtarët thirren të jetojnë në harmoni me njëri-tjetrin si mënyrë për të respektuar dhe lavdëruar vetë Perëndinë.

Islami vendos një theks të fortë në rëndësinë e bashkëjetesës paqësore me të tjerët dhe zgjidhjes së konflikteve përmes mjeteve paqësore.

Kurani i mëson besimtarët të kërkojnë pajtim dhe paqe me të tjerët, edhe në ballë të sfidave. Profeti Muhamed, paqja qoftë mbi të, gjithashtu theksoi rëndësinë e zgjidhjes paqësore të konflikteve, dhe inkurajoi dhe praktikoi dialogun dhe negociatat.

Në Islam, ekzistojnë udhëzime specifike për kryerjen e proceseve të paqes, duke përfshirë

kërkimin e ndërmjetësimit, promovimin e dialogut dhe punën drejt mirëkuptimit reciprok dhe mirëqenies. Gjithçka që duhet për vete, duhet edhe për tjetrin.

Gjatë historisë, civilizimet islame janë njohur për përpjekjet e tyre për të promovuar paqen dhe për të zgjidhur konflikte paqësisht.

Në përgjithësi, proceset e paqes në Islam udhëhiqen nga parime të drejtësisë, empatisë dhe dialogut. Për më tepër, Islami promovon idenë e drejtësisë sociale, barazisë dhe pluralizmit, ku të gjithë individët kanë të drejta dhe mundësi të barabarta, dhe respektohen edhe në mendime dhe qëndrime ndryshe.

Në përfundim, paqja nuk është vetëm mungesa e konfliktit, por një gjendje e tërësisë, harmonisë dhe lumturisë. Gjendja e gëzimit, dashurisë dhe lumturisë njerëzore janë të njëjtësuar me paqen në të dy botët.

Paqja si nevojë njerëzore dhe detyrim hyjnor nxitë dimensione të rizgjimit shpirtëror dhe veprime sublimë të shoqërisë për të mirën e përbashkët publike të njerëzimit.

Muaji maj është nikoqir i dy ditëve ndërkombëtare ku shënohet Dita Ndërkombëtare e Bashkëjetesës në Paqe, për të inkurajuar njerëzit dhe institucionet të angazhohen në aktivitete dhe ngjarje që promovojnë ndërtimin e paqes, pajtimin dhe bashkëjetesën, dhe Dita Ndërkombëtare për Diversitet Kulturor për Dialog dhe Zhvillim, për të inkurajuar njerëzit të festojnë diversitetet kulturore në dialog konstruktiv dhe të hapur që mundëson zhvillim për të gjithë.

Republika e Kosovës është një shembull pozitiv për dialogun, gjithpërfshirjen dhe bashkëjetesën në paqe, duke njohur dhe respektuar identitetet e qytetarëve të saj.

Republika e Kosovës është një shembull pozitiv për dialogun, gjithpërfshirjen dhe bashkëjetesën në paqe, duke njohur dhe respektuar identitetet e qytetarëve të saj.

Qasja ekolinguistike në edukimin fetar të brezit të ri - një alternativë mirëkuptimi


Dr. Xhevdet Rusinovci

Ndërdisiplinariteti në shkencat sociale-humane, i mundshëm dhe i natyrshëm për nga natyra kërkimore, do të sillte më shumë zhvillim dhe rezultate në programet edukative, duke përfshirë edhe edukimin fetar islam, nëse do të bëhej hulumtim efikas dhe politika të mirëfillta të bazuara në të. Gjuha, si mjeti kryesor i komunikimit i qenies humane, e vështruar nga perspektiva ekologjike e saj, mbase mund ta ketë një prej roleve vendimtare në edukimin e drejtë të gjeneratave të reja, ku sipas të paktën dy objektivave kryesore të kurrikulave mësimore – duhet t'i përgatisë ata për ambientin

jashtëshkollor si “komunikues efektivë” dhe “qytetarë të përgjegjshëm”, brenda besimit të tyre në Zot.

Artikulli i quajtur “New ways of meaning: the challenge to applied linguistics” (Mënyrat e reja të kuptimit: sfida për gjuhësinë e aplikuar) nga Halliday¹, shpesh besohet të jetë vepra që ka nxitur gjuhëtarët për të trajtuar kontekstet ekologjike dhe pasojat e gjuhës. Ekolinguistika, si fushë relativisht e vogël e sociolinguistikës që daton prej 50 vjetësh, ka ndryshuar perspektivën drejt një fushe me interes në rritje në hulumtimin gjuhësor. E informuar kryesisht nga ekologjia natyrore, pionier i fushës së ekolinguistikës njihet të jetë gjuhëtari norvegjezo-amerikan, Einar Haugen. Bazuar në metaforën e ekologjisë në gjuhë, ai e përkufizoi ekologjinë e gjuhës si “studimin e ndërveprimeve midis çdo gjuhe të caktuar dhe mjedisit të saj”.² Për Haugen, mjedisi i gjuhës janë njerëzit që e përdorin atë dhe përfshin mjediset sociale dhe psikologjike të gjuhës, por jo ambientin fizik-natyor, megjithëse, Haugen, vë në pah edhe një krahasim të tillë, si p.sh.: ekologjinë midis botës shtazore dhe asaj bimore brenda ambienteve në të cilat jetojnë.³ Megjithatë, ky artikull fokusohet në koncept-elementin e parë të Haugen, atë të gjuhës së njeriut dhe raporteve të tij me të tjerët.

Edhe Asociacioni Ndërkombëtar i Ekolinguistikës e përkufizon dhe e karakterizon rolin ekolinguistik në të dyja rrafshet: “Ekolinguistika eksploron rolin e gjuhës në ndërveprimet që mbështesin jetët e njerëzve, specieve të tjera, dhe mjedisit fizik. Qëllimi i parë është zhvillimi i teorive



gjuhësore, të cilat i shohin njerëzit jo vetëm si pjesë të shoqërisë, por edhe si pjesë të ekosistemeve më të mëdha nga të cilat varet jeta. Qëllimi i dytë është të tregojë se si gjuhësia mund të përdoret për të adresuar çështjet kryesore ekologjike, nga ndryshimi i klimës dhe humbja e biodiversitetit, deri te drejtësia mjedisore.”⁴

SI E ANALIZON GJUHËN EKOLINGUISTIKA?

Ekolinguistika analizon gjuhën për të zbuluar tregimet me të cilat jetojmë si njerëz, i gjykon të njëjtat nga perspektiva ekologjike, iu reziston tregimeve dëmtuese dhe, kontribuon në kërkimin e tregimeve të reja për t'i jetuar.⁵ Si rrjedhojë, ajo luan rol të rëndësishëm në rizbulimin dhe ridefinimin e shoqërisë krahas linjave të tjera ekologjike, duke nxjerrë në shesh dhe sfiduar tregimet me të cilat jetojmë. Çfarë janë tregimet me të cilat ne si njerëz jetojmë? Ato janë tregime në mendjet e njerëzve të kulturave të ndryshme, të cilat ndikojnë se si ata mendojnë, flasin dhe veprojnë. Çfarë llojesh janë ato tregime? Janë ideologji, metafora, vlerësime, identitete, bindje, largime, dhe besime.⁶ Le ta marrim shembullin e vlerësimit (si tregim me të cilin jetojmë). Vlerësimi mund të përkufizohet si tregim në mendjet e njerëzve rreth asaj se nëse një aspekt i jetës është i mirë apo i keq (shembull: koha me diell është e mirë/dielli përcëllues dhe thatësira janë të këqija, shiu është i mirë/vërshimet janë të këqija). Ndërsa, pyetja për diskutim do të ishte: Cilat aspekte të jetës kulturat tona i paraqesin si të mira ose si të këqija (p.sh. suksesi, përshtatshmëria, progresi, shpejtësia, e kaluara)? Cilat duhet t'i rimendojmë?⁷ Ose, ta shikojmë shembullin e identitetit, i cili përkufizohet si tregim në mendjet e njerëzve rreth çështjes se çfarë do të thotë të jesh një tip i veçantë i personit (shembull: njeriu ideal është muskuloz, njerëzit janë pjesë e natyrës). Diskutimi do të vijonte me pyetjet: Cilat tregime ne i rrëfejme si njerëz për të treguar se kush jemi, dhe që tregojnë se jemi qenie njerëzore? Cilat tregime do të mund të ishin përfituese, e cilat shkatërruese?⁸

Duke i analizuar tregimet e jetës të përmendura më lart, në të cilat bëjnë pjesë

Periodha e gjatë
23 vjeçare e
zbritjes së
mësimeve të
shenjta të
Kuranit, të cilat
u janë zbritur
Muhamedit a.s.
nëpërmjet
gjuhës si mjeti
kryesor i
komunikimit
njerëzor,
dëshmon për të
paktën dy
elemente të
rëndësishme në
transferin e
mesazhit hyjnor
për njerëzimin:
se edukimi (dhe
arsimimi) i
njeriut është i
pakufizuar në
kohë, dhe se
mënyra e vetme
për ta realizuar
është përmes
gjuhës.

edhe besimi dhe bindjet fetare, diskutimi do të mund të vazhdonte lidhur me pyetjen kryesore të këtij punimi: A do të mund t'i edukonim fetarisht gjeneratat e reja përmes qasjes ekolinguistike, me qëllim të arritjes të një mirëkuptim i ri dhe më i thellë i konceptit të edukimit fetar, duke mos i përjashtuar përmbajtjet e mësimeve fetare?

GJUHA E KURANIT TË SHENJTË

Periodha e gjatë 23 vjeçare e zbritjes së mësimeve të shenjta të Kuranit, të cilat u janë zbritur Muhamedit a.s. nëpërmjet gjuhës si mjeti kryesor i komunikimit njerëzor, dëshmon për të paktën dy elemente të rëndësishme në transferin e mesazhit hyjnor për njerëzimin: se edukimi (dhe arsimimi) i njeriut është i pakufizuar në kohë, dhe se mënyra e vetme për ta realizuar është përmes gjuhës. Kjo periudhë e gjatë e edukimit hyjnor të njerëzimit përmes Kuranit vazhdon edhe sot, që e përforcon edhe më tepër faktin se edukimi si koncept tërëjetësor, jo vetëm ai fetar, është një proces, shpesh i cilësuar i vështirë dhe me shumë sfida, duke e përjashtuar mundësinë e përlogaritjes së tij si një produkt, apo program, i cili me automatizëm, bazuar në perspektiva me anime tradicionaliste, do ta edukonte njeriun, komunitetin, kombin, ose kulturën përkatëse. Ë anën tjetër, ky proces edukimi mund të fillojë e të vazhdojë, vetëm përmes gjuhës.

Gjuha e Kuranit, e analizuar nga teoricientë fetarë dhe gjuhësorë, llogaritet si gjuhë e bukur, e qartë dhe pastër,⁹ ndërsa analizat tematike e përmbajtësore mund t'ua kalojnë në numër analizave gjuhësore dhe të diskursit. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm i studimeve i kanë trajtuar tekstet e shenjta kuranore në aspekt të analizës diskursive. Janë tri studime të jashtme brenda këtij punimi, që mbështesin teorikisht propozimin e mundshëm për qasjen ekolinguistike në pedagogjinë fetare islame të brezit të ri, dhe jo vetëm, të cilat e vërtetojnë dhe fuqizojnë komunikimin (duke mos e përjashtuar predikimin) ekogjuhësor si mjetin kryesor për edukim të drejtë të bazuar në tekstin e shenjtë kuranor. Benyahia¹⁰ ka diskutuar natyrën e diskursit kuranor, e cila është

hyjnore dhe e pakrahasueshme në nivel të përfaqësimit leksikor, ndërtimor, ritmik, dhe programor (përmbajtësor) të gjuhës. Ky studim konfirmon koherencën dhe konsistencën linguistike të tekstit të shenjtë, duke sugjeruar se gjuha kuranore është gjithëpërfshirëse, e gjithëkuptueshme, dhe unifikuese në strukturë dhe kuptim, dhe ofron modele që demonstrojnë shembuj të shumtë të konsistencës dhe harmonisë tekstore. Nga ana tjetër, Khan dhe Ali,¹¹ analizuan përdorimin e metaforave të luftës në diskursin kuranor. Studimi u bazua në një analizë cilësore të tekstit kuranor dhe u fokusua në metaforat që u përdorën për të përshkruar argumentimin dhe debatin. Studiuesit arritën në përfundimin se një kuptim më i nuancuar i rolit të metaforës në ligjërimin kuranor ndihmon në promovimin e qasjeve më konstruktive dhe bashkëpunuese të argumentimit dhe debatit. Një studim tjetër ka analizuar se si Kurani mund të kuptohet në botën moderne, për të plotësuar nevojat e shoqërive myslimane.¹² Në këtë punim, Saeed, ka trajtuar debatin rreth interpretimit të Kuranit dhe se si ai ndikon në kuptimin bashkëkohor të këtij teksti të shenjtë. Ai propozoi një qasje të re që merr në konsideratë kontekstet historike dhe bashkëkohore të interpretimit – si qasje sintezë, duke ruajtur sistemin thelbësor të besimit dhe të praktikave kuranore.

Në mbështetje të elementeve studimore të punimeve të përmendura më lart, si dhe të literaturës së përgjithshme rreth tekstit dhe diskursit kuranor, diskutimi mund të vijojë duke përmendur nevojën e madhe të përqendrimit në hulumtimin e edukimit fetar islam në Kosovë, me pyetjen e dytë dhe të fundit teorike të këtij punimi: Cila është gjuha (si funksion social) që edukatorët, pedagogët, mësuesit e imamët përdorin në edukimin fetar të gjeneratave të reja?

EKOLINGUISTIKA NË VEPRIM

Meqenëse ekolinguistika bazohet në përzgjedhjen e gjuhës më të përshtatshme, më funksionale, më të qartë, dhe më të drejtë në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e ndërveprimeve sociale njerëzore, dhe në zhvillimin e përgjithshëm të qenies njerëzore dhe jo

Meqenëse ekolinguistika bazohet në përzgjedhjen e gjuhës më të përshtatshme, më funksionale, më të qartë, dhe më të drejtë në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e ndërveprimeve sociale njerëzore, dhe në zhvillimin e përgjithshëm të qenies njerëzore dhe jo vetëm, ajo si fushë dhe praktikë funksionale realizohet edhe përmes vetë tekstit të shenjtë: “Dhe njerëzve thoni fjalë të mira.”



vetëm, ajo si fushë dhe praktikë funksionale realizohet edhe përmes vetë tekstit të shenjtë: “Dhe njerëzve thoni fjalë të mira.”¹³ Kjo sintagmë hyjnore duket se plotësisht pajton qasjen ekolinguistike me edukimin fetar dhe të thirrjes, e para si mjet, dhe e dyta si fushë edukative-arsimore, e para me parime të komunikimit të mirëfilltë, të kuptimeve të reja, mirëkuptimit, dhe e dyta, me objektiva të qarta të edukimit fetar, njohjes dhe ngritjes shpirtërore, dhe bashkëjetesës me anëtarët e komunitetit amë dhe të komuniteteve të tjera diversitare. Pyetja e dytë e shtruar më lart gjatë diskutimit, mbase nuk mund të marrë përgjigje të plotë në këtë punim por, ajo do të shërbejë këtu më tepër si thirrje për hulumtime, për të marrë më shumë informacion dhe të dhëna të reja rreth sjelljes, veprimeve, gjuhës dhe procesit të edukimit fetar islam të akterëve kryesorë të përmendur në pyetje. Megjithatë, vetë fakti i ekzistencës së pyetjes në fjalë në punim, tregon për, të paktën, mundësitë e përdorimit të gabuar të gjuhës si mjet në edukimin fetar, për të mos përmendur keqpërdorimin e saj të (pa) qëllimshëm (kryesisht për qëllime ideologjike).

Prandaj, në vend të përgjigjeve në pyetjen e shtruar, ky punim do të fokusohet më tepër në

vendime ekolinguistike - të bazuara në analizën e tregimeve jetësore brenda kontekstit aktual, si qasje dhe program në edukimin fetar të të rinjve, të cilat do të mund të rrisnin mundësitë dhe ndërgjegjësimin për një mirëkuptim (të ri) të përgjithshëm të konceptit të edukimit fetar, pa cenim dhe keqkuptim të përmbajtjeve të shenjta fetare. Vendimi i parë ekolinguistik do të përqendrohej në edukimin fetar të ndërlidhur me komunitetin. Komunitetet diversitare¹⁴ janë pjesë të pandashme të komunitetit amë. Ato ndikojnë dhe ushtrojnë ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në jetët dhe zhvillimin e komunitetit, të cilit i përket individi. Njohja e tyre, bashkëjetesa, toleranca e mirëkuptimi duhet të jenë në qendër të edukimit fetar, të zbatuar nëpërmjet një gjuhe të bazuar në ekologjinë gjuhësore: gjuhë jo përjashtuese, respektuese, dhe integruese, për të shmangur pasojat për të cilat alarmon ekolinguistika (tregim jetësor: p.sh., jeta dhe trajtimi i komunitetit RAE¹⁵ në krahasim me komunitetet e tjera). Këto pasoja janë zinxhirore, duke mos i përjashtuar as speciet e tjera dhe ambientin. Vendimi i dytë ekolinguistik do të rriste gjasat e një ndërgjegjësimi më të thellë për shkencën dhe për profesionet e realizuara nga pjesëtarët e komunitetit. Ka indikacione se në edukimin fetar kryesisht përdoret gjuhë specifike e zhanrit fetar, me mbitheksim të përmbajtjeve fetare (tekst), duke i lënë anash të paktën minimalisht dijet e tjera (që nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me fenë), dhe duke i konsideruar shkencën dhe profesionet jofetare me një neutralitet të theksuar.¹⁶ (tregim jetësor: p.sh., puna dhe kontributi i mjekut, mësuesit, arkitektit, si funksione sociale; a janë dhe sa janë të vlefshme në edukimin dhe jetën e njeriut?). Vendimi i tretë sipas perspektivës së ekologjisë së gjuhës do të ishte në aspekt të ndryshimeve (dhe devijimeve) të mëdha shoqërore në vend dhe botë. Perceptimet e përgjithshme janë se ndaj këtyre ndryshimeve më tepër reagohej me gjuhë të papërshtatshme fetare (kryesisht me gjuhë të dënimit dhe përjashtimit), por pa ofruar zgjidhje, alternativa, dhe veprime pragmatike. Madje, gjuha e ashpër dhe e papërshtatshme, e parë edhe nga perspektiva ekologjike, shpesh mund të çojë në pasoja të rënda, si dhuna, dhe përplasjet serioze mes individëve e komuniteteve¹⁷ (tregim jetësor: p.sh., rritja e përdoruesve të drogës, rritja e ekstremizmit; a duhet t'i përjashtojmë apo t'i pranojmë, dhe si duhet t'ju qasemi?). Vendimi i katërt dhe i fundit këtu, është lidhur me një nivel të mirëkuptimit dhe respektit më të lartë të jetës së botës shtazore dhe ambientit.


Mospërjashtimi, respekti, dhe gjithëpërfshirja e tregimeve të jetës janë tri parimet kyçe që dalin nga mësimi ekolinguistik, në mënyrë që t'ju shmangemi pasojave negative që mund të sjellë përdorimi i gjuhës jofunksionale në edukim.

Ekolinguistika nuk e sheh njeriun të pavarur nga mjedisi i tij johuman. Të tillë nuk e sheh as Kurani i shenjtë. Përderisa gjuha dhe bota shtazore janë mjete të vëna për njeriun nga Krijuesi, për të komunikuar dhe jetuar, kafshët, për dallim nga gjuha që është një mjet/entitet abstrakt, janë edhe frymorë/krijesa që kanë cikël jete të ngjashëm me njeriun. Prandaj, në kuptimin ekologjik të gjuhës si qasje në edukimin fetar, kafshët dhe ambienti do të duhej të jenë më të përfshira në aspekt të respektit, dashurisë, dhe përkujdesjes, përpos shfrytëzimit të tyre klasik për të mirën e qenies humane (tregim jetësor: p.sh., puna që kryejnë kafshë të caktuara si shoqërues të njeriut, ngrohja globale; si duhet të sillemi dhe të veprojmë ndaj tyre?). Për më tepër, ato janë pjesë e pandashme e ekosistemit ku bën pjesë edhe vetë njeriu, me funksione të shumëllojshme dhe të pazëvendësueshme. Një kaptinë e tërë e Kuranit është emërtuar Lopa (Bekare).

IMPLIKIME, REKOMANDIME DHE KUFIZIME

Ky punim është një platformë novatore në fushat e arsimit, edukimit fetar, dhe gjuhësisë së aplikuar në fusha të veçanta, dhe mund të ketë disa implikime. Fillimisht, nga poshtë

lart, punimi ka implikime për të gjithë pjesëmarrësit, të cekur në pyetjen e dytë të punimit. Implikimi tjetër është për hartuesit e politikave arsimore dhe edukative në fushën e fesë të cilët, bartin përgjegjësinë kryesore për trajnimin dhe zhvillimin e stafit në lëminë e edukimit-arsimimit fetar. E fundit këtu, por jo më pak e rëndësishme, janë tekstet shkollore. Tekstet shkollore të natyrës së edukimit fetar (krahas arsimimit përmes përmbajtjes) mund të jenë të pakta dhe jo të zhvilluara sa duhet, dhe si rrjedhojë ky punim thërret për më shumë literaturë shkollore e universitare në këtë fushë, me autorë të fushave të ndryshme. Rekomandimi kryesor i punimit do të ishte theksimi i nevojës për më shumë hulumtim ndërdisiplinor në fushën e edukimit fetar islam, studime cilësore e sasiore me pjesëmarrës në procesin e edukimit fetar, të cilat në kthim, do të mund të ndikojnë pozitivisht në hartimin e planprogrameve efikase, trajnim specialistik të stafit edukativ-arsimor, dhe më shumë ekspertizë në botimin e teksteve mësimore relevante për edukim fetar. Duke qenë një punim me mbështetje teorike, joeskperimental, mund të vihen re të paktën dy kufizime. Përfshirja e pjesëmarrësve në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa dyshim se do të siguronte të dhëna më të thella dhe statistikore për analizë dhe diskutim, dhe do të përforconte besueshmërinë



e studimit, ndërsa mbështetja edhe në studime vendore, të cilat i mungojnë fushës në masë të konsiderueshme, do të mund të rrisnin vlefshmërinë e brendshme të punimit. Prandaj, punimi duke mos synuar të sjellë përfundime të gjeneralizuara apo definitive, bën thirrje për studime të mëtejshme për të hulumtuar qasjet me perspektivë gjuhësore në edukimin fetar të të rinjve.

PËRFUNDIM

Propozimi teorik me mbështetje të dyfishtë ekolinguistikë-Kuran në edukimin fetar islam në Kosovë, bëhet duke pasur në konsideratë të paktën disa mungesa minimaliste në literaturë, mungesës së ndërdisiplinaritetit në kërkim dhe praktikum, dhe qasjeve elementare dhe jofunksionale (josociale) të gjuhës si mjet edukimi. Paradigma e ndërtuar në punim sipas perspektivës ekolinguistike për një qasje me kuptim të ri të edukimit fetar të generatës së re, përfshin tregime themelore të jetës, gjerësisht të njohura dhe të mbështetura në Kuranin e shenjtë, të cilat duket se jo vetëm që mund ta edukojnë individin drejt por, ofrojnë madje gjithë potencialin që ai/ajo ta shohë veten jo të varur nga bota dhe jeta e jashtme, por brenda tërësisë dhe unitetit që ato bartin, me perspektiva dhe botëkuptime të shëndosha. Mos-përjashtimi, respekti, dhe gjithëpërfshirja e tregimeve të jetës janë tri parimet kyçe që dalin nga mësimi ekolinguistik, në mënyrë që t'ju shmangemi pasojeve negative që mund të sjellë përdorimi i gjuhës jofunksionale në edukim. Mundësitë për arritjen e këtyre objektivave mund të rriten me edukimin e stafit edukativ përmes trajnimit të vazhdueshëm, punës kërkimore, dhe nxjerrjes në dritë të teksteve shkollore të mirëdizajnuara, dhe sipas standardeve evropiane.

- 1 Halliday, M. A. K. "New Ways of Meaning: a challenge to applied linguistics. Kongresi i 9-të Botëror i Gjuhësisë së Aplikuar, sponsorizuar nga Asociacioni Ndërkombëtar i Gjuhësisë së Aplikuar, Selanik, Greqi, 15-21 prill, 1990. (parë për herë të fundit më 16/02/2024). <https://eric.ed.gov/?id=ED324960>.
- 2 Einar Haugen, *The Ecology of Language*, (Stanford: Stanford University Press, 1972), 325.
- 3 Penz, Hermine dhe Fill, Alwin. "Ecolinguistics: History, Today, and Tomorrow". *Journal of World Languages*, 8, 2, 2022: 232-253. (parë për herë të fundit më 10/02/2024). <https://doi.org/10.1515/jwl-2022-0008>.
- 4 The International Ecolinguistics Association. (parë për herë të fundit më 26/12/2023). <https://www.ecolinguistics-association.org/Journal>.
- 5 Arran Stibbe, *Ecolinguistics: Language, Ecology, and The Stories We Live By* (University of Gloucestershire: Routledge, 2015).
- 6 Shih fusnotën 5.
- 7 Shih fusnotën 5.
- 8 Shih fusnotën 5.
- 9 Shih Kuran (Shuara, 195).
- 10 Benyahia, Naous. "Analysis of Qur'anic Discourse in The Light of Modern Linguistic Studies." *Al-Zahra: Journal for Islamic and Arabic Studies*, 18, 1 (2021). (parë për herë të fundit më 02/02/2024). <https://doi.org/10.15408/zr.v18i1.19027>.
- 11 Khan, Sardaraz dhe Ali, Roslan. "Argument is a War Metaphor in the Quran." *Journal of Islamic Thought and Civilization*, 10, 1 (2020): 66-86. (parë për herë të fundit më 02/02/2024). <https://doi.org/10.32350/jitc.101.04>
- 12 Abdullah Saeed, *Interpreting the Quran: Towards a contemporary approach* (London: Routledge, 2005).
- 13 Kuran (Bekare, 83).
- 14 Shih Kuran (Huxhurat, 13).
- 15 Romë, Ashkali, Egjiptas
- 16 Shih Kuran (Alak, 1; Zumer, 9).
- 17 Shih Kuran (Bekare, 256) dhe fusnotën 14.

Pedagogjia në mësimdhënien islame

Faik Llumnica

Në të vërtetë,
Kurani edukon
me të gjitha
llojet e
ligjërimit të vet
të larmishëm:
me këshilla,
paralajmërimi,
kërcënime,
premtime,
tregime,
diskutime,
shikime,
ilustrime.

Në shikim të parë kjo tematikë duket si çështje e cila bën pjesë në gjërat e ditura, me të cilat nuk duhet humbur kohë, mund e as energji, mirëpo çështje dhe tematika të tilla duhen sqaruar dhe nënshtruar aspektit shkencorë për të dhënë ndonjëherë ripërtërije të mendimit nga një këndvështrim tjetër, ngase ajo çfarë ndryshon më së shumti në ditët e sotme është pikërisht shkenca dhe teknologjia, ku na imponohet që ne t'i nënshtrohemi ndryshimeve të tyre. Nga ndryshimet e tilla ne ndryshojmë edhe mendime mbi të cilat

çështje pothuajse nuk ka ekzistuar mendimi ndryshe. E gjithë kjo na nxit për të kuptuar diç më shumë rreth pedagogjisë si shkencë, si dhe mësimdhënies islame, në këtë rast si proces mbi të cilën vepron pedagogjia.

Si fillim le të krijojmë një qasje terminologjike rreth pedagogjisë, vetë nocioni pedagog rrjedh nga gjuha e vjetër greke: *paidagogos* që nënkupton udhëheqje, përcjellje e fëmijës (*pais*, *paidos* – fëmijë i ri dhe *age*, *agein* – udhëheq, përcjellë).¹ Në fjalorin e gjuhës shqipe fjala “pedagogji” përkufizohet si shkenca, e cila merret me edukimin dhe

arsimimin e fëmijëve dhe të rinjve, me metodat që duhet përdorur për këtë qëllim.² Ndërsa sa i përket aspektit terminologjik, pedagogjia është shkencë sociale, e cila në mënyrë sistematike, të planifikuar dhe të organizuar e studion edukatën në të gjitha format manifestuese të saj, duke përfshirë: etapat, periudhat, moshat dhe kushtet për ta realizuar atë.³

Nga çfarë u tha më lartë mbi pedagogjinë, qëllimin dhe studimin e saj, shohim se kjo e fundit ka krijuar një sistem vlerash mbi të cilat në radhë të parë ka të bëjnë me edukatën si fenomen dhe mësimdhënien si proces, prandaj sot me të drejtë pedagogjia merr përgjegjësinë si shkencë mbi edukatën dhe mësimdhënien.

RËNDËSIA QË ISLAMI I JEP MËSIMIT DHE ARSIMIMIT

Pozita e arsimit në Islam determinohet si shumë parimore, nisur nga vetë fjala e parë e Kuranit, e cila ishte urdhër, që Allahu xh.sh. na urdhëroi që të gjithëve për lexim-studim-mësim. “Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili



krijoi(gjithçka).” (El Alek, 1). Pikërisht këto fjalë tregojnë më së miri vlerën që arsimimi ka në fenë islame, e kjo na bënë që të kuptojmë se urdhri për lexim e studim në programet mësimore islame është kahtër dhe vazhdon të jetë edhe sot e kësaj dite e në vazhdimësi. Kurani, pra, është një Libër që në kulturën dhe qytetërimin mysliman është burim për çdo disiplinë shkencore. Ai, me fjalën e tij gjithëpërfshirëse, nis dhe, ç’ është më e rëndësishmja, përcakton qëllime të pandryshueshme. Përveç të tjerash, pra, Kurani është edhe libër pedagogjie dhe natyrisht shumë më tepër se kjo. T’i edukosh njerëzit që në çdo situatë jetësore të sillen në pajtim me vullnetin e Allahut xh.sh. është qëllimi i çdo ajeti dhe çdo kapitule kuranore. Në të vërtetë, Kurani edukon me të gjitha llojet e ligjërimit të vet të larmishëm: me këshilla, paralajmërime, kërcënime, premtime, tregime, diskutime, shikime, ilustrime.⁴

Kështu pra Kurani si Fjalë e Zotit ku në vetveten e tij ka përfshirë çdo gjë, me saktësi dhe drejtësi, ashtu siç vetë pohohet në të: “Të përkryera janë fjalët e Zotit tënd në vërtetësi dhe drejtësi.” (El Enam, 115), padyshim se nuk ka lënë anash as çështjet pedagogjike, duke përfshirë disiplinën e saj, si: edukimi i shpirtit, edukimi i mendjes, edukimi i trupit, edukimi estetik, edukimi i një shoqërie mirëfilli. Me këtë gjithëpërfshirje mbi konceptet e edukatës dhe jo vetëm, Kurani lirshëm mund të themi se i shërben pedagogjisë, mësimëve, parimeve si dhe detyrave të saj.

PËRKUFIZIMI I MËSIMDHËNIES

Në lidhje me mësimdhënien ekzistojnë përkufizime të ndryshme, por ajo e cila është më përmbledhëse sipas studiuesve të pedagogjisë është se: Mësimdhënia është proces i cili planifikohet, udhëhiqet dhe organizohet nga mësimdhënësi, realizohet në objekte edukative arsimore si: shkollat, institucionet arsimore, universitetet, fakultete e të ngjashme.

Mësimdhënia si profesion dhe detyrë duket të jetë mjaft komplekse, për faktin se brenda saj përfshinë një sërë faktorësh edukativ me të cilët mësimdhënësit duhet të përballen çdo ditë, duke ju përshtatur ndryshime arsimore, të cilat tashmë janë në fazë tranzicioni mjaft të lartë. Në këtë kontekst, përball mësimdhënies, na paraqiten dy modele të njohura të saj, mësimdhënia e drejtpërdrejtë apo e njohur si mësimdhënia tradicionale, e cila është tashmë praktikë e njohur. Ky model i mësimdhënies vendos mësimdhënësin në qendër të vëmendjes, ai është autoriteti i klasës që nxënësve u drejtohet përmes ligjëratës, leximit apo demonstrimit të përmbajtës, me një fjalë ai është që shpenzon shumicën e kohës në orën mësimore dhe ku nxënësit në shumicën e rasteve janë spektatorë që dëgjojnë dhe rrallë japin ndonjë mendim.



Padyshim se edhe feja islame i ka kushtuar kujdes të veçantë mësimdhënies dhe mësuesit, transmetuesit të njohurive të nxënësi. Mësimet islame gjykojnë mbi mësimdhënien në një këndvështrim tjetër, ndryshe nga ai shkencor, kështu duke i dhënë një ngjyrim më spiritual mësimdhënies. Që shkolla të jetë ambient i mirëfilltë e edukues, duhet t’i përmbahet përgjithësisht parimeve dhe vlerave islame, ngase ajo përbënë themelin mbi të cilën ngrihet e tërë struktura arsimore.⁵ Kjo na bënë të kuptojmë se gjithë ajo çfarë transmeton Islami është në përputhje me vlerat humane në shoqëri, madje na fton që këto vlera të jenë prezentë brenda institucioneve arsimore.

Krahas kësaj, kemi modelin e mësimdhënies bashkëkohore, me të cilën kuptojmë atë lloj mësimdhënie, i cili lehtëson me forma, metoda, teknika dhe strategji të përshtatshme procesin e të nxënit të nxënësit. Mësimdhënia bashkëkohore nënkupton ndryshimin e roleve të mësuesit dhe nxënësit, e që në qendër të vëmendjes vendos nxënësin ku ai menaxhon shumicën e orës mësimore duke qenë aktiv çdoherë, kështu duke krijuar një klimë të përshtatshme pedagogjike brenda klasës, gjithashtu ky model i mësimdhënies parasheh pjesëmarrje të komunitetit në jetën e shkollës dhe të shumë faktorëve të tjerë edukativ.

DETERMINANTET PEDAGOGJIKE, SINTEZË ME MËSIMDHËNIEN ISLAME

Determinantet apo përcaktorët pedagogjik janë faktorët dhe elementët që kanë ndikim në mënyrën se si ndodh mësimi dhe arsimimi në një mjedis shkollor. Disa nga determinantet pedagogjike, të cilat do i përmendim në vijim janë:

Demokratizimi i pedagogjisë, i cili konsiderohet njëri nga determinantet kyç për funksionimin e drejtë të tërë sistemit arsimor, duke përfshirë të gjitha nivelet arsimore si dhe gjithë akterët e sistemit arsimor. Një thirrje e veçantë në këtë drejtim është bërë edhe nga organizata ndërkombëtare e arsimit UNESCO, e cila rekomandon trajtim të veçantë rreth

demokratizimit në shkolla, me theks luftën kundër diskriminimit (në baza gjinore, racore, religjioze etj.), luftën kundër analfabetizmit, si dhe i kushtoi rëndësi të madhe arsimimit të emigranteve dhe të pakicave në shtete të ndryshme në botë.⁶

Një thirrje për demokratizim dhe barazi në shoqëri, Islami e kishte qysh në fillimet e tij, duke përfshirë gjitha segmentet jetësore. Për këtë i Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s. tha: “Nuk ka përparësi i bardhi ndaj të jo të bardhit, as arabi nga jo arabi, vetëm se me devotshmëri.”⁷ Kështu duke mos krijuar asnjë dallim në shoqëri. Elementi i demokratizimit ishte prezentë në çdo periudhë të Islamit, të cilat janë dokumentuar e vërtetuar edhe gjatë shekujve, dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite, duke bërë thirrje për barazi dhe unitet çdoherë, e në veçanti në segmentin e arsimit ku vlerat demokratike janë të dukshme. Nga kjo kuptojmë se demokratizimi është sintezë e drejtësisë, ku në asnjë formë nuk guxon të mohohet e drejta e askujt për asgjë e aq më pak në sferën e arsimimit dhe edukimit, në këtë rast mësimdhënësit plotësojnë edhe urdhrin e Zotit për të ju përmbajtur drejtësisë, “...bëhuni të drejtë sepse ajo është më afër devotshmërisë.” (El Maide, 8).

Përsosja e kuadrit edukativ-arsimor. Ky determinantë ka për qëllim që në rend të parë të krijojë një qasje të re rreth procesit edukativ-arsimor si faktor për transformimin e edukatës dhe arsimit.

Mësimdhënia duhet përshtatur ndryshimeve të kohës, kështu duke imponuar ndryshim të mjeteve, formave, metodave dhe strategjive mësimore, e në këtë drejtim paraqitet nevoja që kuadri edukativ t'i përshtatet këtyre ndryshimeve, e pikërisht këtu qëndron esenca për përsosje profesionale.

Roli i përsosjes profesionale dhe rëndësia e saj në dy dekadat e fundit imponohet si domosdoshmëri dhe nevojë e secilit bartës të procesit edukativ-arsimor. Në këtë kontekst përsosja profesionale në aspektin pedagogjik duhet shikuar në dy aspekte:

Së pari, përsosja në kuptimin e ngushtë që do të thotë përsosje në lëndën mësimore, lëmin apo shkencën gjegjëse dhe së dyti, përsosje në kuptimin më të gjerë të fjalës, e cila duhet përfshijë përsosje pedagogjike, psikologjike dhe andragogjike.⁸ Nga sa u tha më lartë shohim se mësimdhënia duhet përshtatur ndryshimeve të kohës, kështu duke imponuar ndryshim të mjeteve, formave, metodave dhe strategjive mësimore, e në këtë drejtim paraqitet nevoja që kuadri edukativ t'i përshtatet këtyre ndryshimeve, e pikërisht këtu qëndron esenca për përsosje profesionale. Në këtë pikëpamje edhe bartësit e njohurive fetare islame, si teologët, mësimdhënësit, arsimtarët dhe profesorët nuk qëndrojnë keq, megjithatë duhet që në mënyrë rapide t'i përqafojnë këto ndryshime pedagogjike, të cilat kanë përfshirë sferën e arsimit dhe jo vetëm me një hov mjaft të madh, kështu duke ndjekur trajnime në mësimdhënie rreth metodave të reja pedagogjike, duke ndjekur kurse intensive rreth teknologjisë informative dhe aplikimit të saj në mësimdhënie, të njoftohen më shumë rreth mjeteve të reja didaktike. Prandaj nga ky aspekt, roli i përsosjes profesionale është i pazëvendësueshëm jo vetëm për arsye të “pasurimit të njohurive”, por edhe të konkretizimit teorik me atë praktik, e që për mësimdhënësit e fushës islame kjo konsiderohet si shumë parësore.



1 Dr. Xheladin Murati, *Pedagogjia e përgjithshme*, (Shkup, Logos-A, 1998), 51.

2 <http://www.fjalori.shkenca.org/>

3 Dr. Xheladin Murati, *Pedagogjia e përgjithshme*, (Shkup, Logos-A, 1998), 55.

4 Dr. Xhemaludin, Latif, (Bazat e pedagogjisë kuranore), *Edukata Islame*, nr. 67, 93.

5 Dr. Abdul Kerim Bekkar, *Formimi i brezave*, (Prishtinë, Dituria Islame, 2009), 130.

6 Prof. dr. Rabije Murati, *Demokracia në shkollë*, (Tetovë, Luma grafik, 2019) 37.

7 Hadithin e kanë shënuar Ebu Davudi, Tirmidhiu, dhe Ahmedi. Shih: *El Muëxhemu-l-muhfrehes li elfadhi-l-hadithi-n-nebeviy*, vëll. I, 267.

8 Andagogjia është shkencë, e cila merret me studimin dhe organizimin e veprimtarisë arsimore-edukative për të rriturit.

Flamuri i rezistencës në muret e Medresesë “Alauddin”

NË KUJTIM TË 60-VJETORIT TË 14 PRILLIT 1964

Akademik Feti Mehdiu

Në hatllat e mia, në mënyrë të veçantë është konservuar kujtesa për këtë ngjarje dhe për jehonën e asaj ndodhie përmes nxënësve të Medresesë. Kjo jehonë përmes këtyre nxënësve mori hovin në tërë hapësirën shqiptare të mbetur jashtë Shqipërisë politike. Përveç në Kosovë, arriti edhe në Maqedoni dhe në Mal të Zi.

Në prill të këtij viti bëhen gjashtëdhjetë vjet nga dita e valëvitjes së flamurit të rezistencës antiserbe në tërë Kosovën.

Në hatllat e mia, në mënyrë të veçantë është konservuar kujtesa për këtë ngjarje dhe për jehonën e asaj ndodhie përmes nxënësve të Medresesë. Kjo jehonë përmes këtyre nxënësve mori hovin në tërë hapësirën shqiptare të mbetur jashtë Shqipërisë politike. Përveç në Kosovë, arriti edhe në Maqedoni dhe në Mal të Zi.

Ngjarja e mesit të prillit të vitit 1964, ishte sinjal i qartë dhe i fuqishëm se shqiptarët

jashtë Shqipërisë politike janë të vendosur të vazhdojnë rezistencën deri në çlirimin e Kosovës, ashtu siç e kishte shkruar Adem Demaçi në fund të statutit të LRBSH-ës, qoftë edhe me luftë.

Dhe ajo luftë filloi në vitin 1981, ani pse bota e brendshme dhe e jashtme e ngulfatën, ia vështirësuan frymëmarrjen, por nuk arritën ta furin, deri në vitin 1999.

Flamuri i rezistencës për pavarësi në muret e Medresesë “Alauddin” në Prishtinë ka një lidhje të ngushtë me gjilpërën e Sabri



Maxhunit dhe me atë doktorin nga Medreseja, i cili luajti rolin e mjekut në shfaqjen “Prej territ në dritë”.

Fundi i vitit 1963, apo fillimi i vitit 1964, tanimë është zbehur shumë, por e di se bënte ftohtë. Mirëpo, unë në rolin e mjekut, duhej të isha i veshur me mantel të bardhë që nënkuptonte se nuk mund të mbaja veshje të trashë dimri. Ajo salla në shtëpinë e kulturës, që sot është teatri Dodona në lagjen Alaudin nxehej me cunga e me thëngjill, sa nxehej njëri skaj tjetri ftohej. Trupa jonë, 7-8 vetë, unë nga Medreseja, të tjerët, rini e lagjes nga familja Krajкова dhe Fetahu, nën përkujdesjen e Skender Ajetit, kryektivist i lagjes, ngjiteshim në skenë për herë të parë: unë mjeku (doktori), një infermiere, një ndihmëse e infermieres dhe e doktorit, një personazh si fallxhore, e cila i bënte konkurrencë mjekut me metodat e vjetra për shërim të pacientëve.

Një shfaqje amatorësh shtronte para opinionit publik problemin e luftës ndërmjet të resë dhe të vjetrës.

Kur i shushliza këto kujtime, aktualisht kuptova se disa nga ata nuk jetonin më, paçin mëshirën e Allahut! Ata që jetojnë i përshëndes dhe ua drejtoj një urim për shëndet e pleqëri të qetë.

Sabri Maxhuni kishte prezantuar dhe e kishte përcjellë me vëmendje e me kureshtje shfaqjen, për çka më uroi, kur u takuam. Përveç urimit shprehu edhe bindjen se kishte gjetur një argat serioz për LRBSH-ën në Medrese. Unë, normalisht, u ndjeva mirë kur e kuptova se Sabriu kishte fituar përshtypjen dhe ishte bind se me mua mund të shprehet edhe për çështje më serioze.

Takimet në vijim e dëshmonin këtë, por ai e dinte se çka duhej dhe çka mund të fliste me mua.

Nuk më tregoi se ai qepte flamujt e rezistencës për të manifestuar haptazi qëllimin e LRBSH-ës, me ngritjen e atyre flamujve anekënd Kosovës, në objekte publike politike, kulturore e arsimore etj..

Kah fundi i marsit, 1964, më dha një sinjal se së shpejti do të ndodh diçka publike që do ta dridh e t'i zgjojë nga gjumi strukturat politike të Kosovës, tërë Jugosllavisë, e pak përtej saj. Për mua nuk kishte asnjë angazhim, përveçse porosisë, kije me dije dhe kujdes në lëvizje e kontakte. Kjo ishte e tëra dhe mjaftonte.

Njëri nga ata flamuj që i kishte qepur Sabri Maxhuni – Novosella, natën ndërmjet 13 dhe 14 prillit, 1964, gdhini ndërtesën e Medresesë, te Drejtoria e Medresesë, kuptohet nga ana e jashtme.

Këtë flamur e kishin parë vetëm Rexhep Gashi dhe Haki Bahtijari – me sa di unë, të cilët sipas detyrës, njëri kuzhinier, tjetri shërbëtor, duhej të vinin në punë të parët, me të gdhirë të ditës.

Rexhep Gashi, aga Rexhë jonë, ashtu e thërrisnim gjithë nxënësit e Medresesë, më pëshpëriti në besim: “Ka ardhur policia herët dhe mori një flamur të Shqipnisë, që e kish ngjit dikush aty te muri i Drejtorisë! Ti as din gjë, as unë nuk të kam thënë asgjë për këtë! E more vesh? Hesht!”

Ashtu ndodhi. Unë e kuptova se kishte ndodhë ajo për çka më kishte folur Sabriu.

Ky akt ishte sinjal i qartë se këtu përkundej një miniarmatë për çlirimin e Kosovës, gjë të cilën e dëshmoi koha deri në vitin 1999, me shëhidët që ranë në luftën për çlirimin e Kosovës.

Me gjithë kujdesin që takimet tona, Sabri e Feti, të jenë sekrete, Bedri Novosella, vëllai më i vogël e Sabriut e kishte kuptuar qëllimin e takimeve tona. Për këtë u binda me faktin se dy a tri ditë pas arrestimit të Sabriut, unë akoma nuk kisha marrë vesh se çka ka ndodhur. Një mëngjesi të atij fillim qershori, ndërmjet orës 7-7:30, derisa unë kthehesha nga qyteti ku shkoja për çdo ditë të marrë shtypin ditor për Medrese, “Rilindja”; “Politika”; “Borba” edhe “Zani i Rinisë”, në takimin kalimthi, te shkolla “Vuk Karaxhiq” sot “Elena Gjika”, këmbëpër përshëndetjen me një mirëmëngjesi, dhe



Nga e djathta: Sabri Maxhuni, Feti Mehdiu, Sabri Kosova – bashkëveprimtar i Sabri Maxhunit nga Adapazari – Banja “Nëna Naile”, Kllokot, 2023.



Ky mesazh, përmes Medresesë dhe jo vetëm me nxënësit e Medresesë, arriti në Maqedoni dhe në Mal të Zi. Medreseja iu nënshtrua hetimeve nga organet e sigurisë dhe policisë.

me zë të ultë por qartë, ma tha: “Sabriun e ka marrë policia”, dhe ai eci rrugës së vet, unë vazhdova rrugën time. Asgjë më shumë se kaq. As që kishte nevojë më tepër!

Perceptimi i këtij akti të nxënësit e Medresesë u përcoll si kushtrim për syçelëti e angazhim për kultivimin e ndjenjës për çlirim nga okupimi serb mbi Kosovën, rrjedhimisht mbi shqiptarët e mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë politike.

Ky mesazh, përmes Medresesë dhe jo vetëm me nxënësit e Medresesë, arriti në Maqedoni dhe në Mal të Zi. Medreseja iu nënshtrua hetimeve nga organet e sigurisë dhe policisë.

U morën në pyetje nxënës të klasave të ndryshme: Ahmet Qeriqi, Ali Jusufi, Ymer Mehmeti, Shemadin Akti, Hasan Ballovci, Riza Gjokaj dhe përfundoi, përkohësisht, vetëm me masa përjashtim nga Medreseja. Por në vitin vijues arrestohen dhe dënohen me burg Ahmet Qeriqi, (Ferizaj), Ymer Mehmeti (Prishtinë), dhe Sulejman Elezi dhe Mustafë Feza (Kërcovë).¹

Katër vjet më vonë, Mustafë Feza, nxënës i Medresesë “Alauddin”, i rrëmbyer nga ajo fryma e atij flamurit të viti 1964 në muret e Medresesë, e vizatoi në letër me shqiponjë – tamam flamurin kombëtar shqiptar, e ngjyrosi, e vuri para vetes, te timoni i biçikletës dhe e barti publikisht nga fshati i vet, Jagolli,

7-8 km. në Verilindje të Kërçovës, deri në Kërçovë. Sapo hyri në qytet, u arrestua, u gjykua për veprimtari armiqësor anti-jugosllave dhe u dënua me disa vjet burg. Pasi doli nga burgu, në një udhëtim që pati në Zvicër, e pësoi në aksident komunikacioni, ku humbi jetën.

UNË, DOKTOR PARA DOKTORIT

Pas asaj shfaqjes teatrale, “Prej territ në dritë”, te shtëpia e kulturës, e tërë lagja Alaudin mbajtën mend rolin tim si mjek dhe vazhdimisht më thërrisnin doktor.

Në vitin 1965, kur erdhi në vizitë im vëlla, Nazmiu (rentgenollog), i cili studionte mjekësinë në Shkup, me kolegët e tij Esatin dhe Asllanin që studionin, njëri agronominë, tjetri fizikën, duke kaluar rrugës aty afër teatrit, kaluan dy shokë të lagjes dhe më përshëndetën, mirëdita doktor, si je?

Të tre vizitorët e mi u habitën. Iu drejtuan tim vëlla Nazmiut, prej nga të njohin këta ty, kush janë këta? Ai rrudhi krahët! Unë nuk njoh, nuk di kënd e përshëndetën.

Kur u shpjegova arsyen pse ata më përshëndetën mua, si doktor, ata bënë shaka me Nazmiun, ti studio mjekësinë sa të duash, ky qenka bë doktor para teje.

¹ Shih: Të burgosurit politik shqiptarë të Kërçovës 1946-1994, Prishtinë, 2011.



Jeta e Imam Kadi Ijadit (V.544/1149)

JETA DHE PERSONALITETI SHKENCOR I TIJ

VITI I LINDJES DHE SHKOLLIMI

Blerton Bahtiri

Kadi Ijad (v. 466/1083), i njohur me pseudonimin Ebu'l Fadl, lindi në Sebte, në anën afrikane të ngushticës së Gjibraltarit. Emri i tij i plotë është Ebu'l Fadl Ijad b. Musa b. Ijad el Jahsubi. Paraardhësit e Kadi Ijadit ishin nga fiset Himjer të Jemenit dhe migruan në Andaluzi dhe prej atyre në Sebte ku dhe u vendosën aty.¹

Sebte, vendlindja e Kadi Ijadit, ishte një qendër e gjallë e shkencës, pasi ishte pika e tranzicionit midis Andaluzisë dhe Magribit (Afrika e Veriut). Kadi Ijadi, i cili ishte inteligjent, punëtor dhe i etur për të mësuar, arsimin fillor e kreu në një qendër të tillë dhe

Në qytetin e tij, Kadi Ijadi mësoi përmendsh Kuranin fisnik me shtatë recitimet e tij (kiraetet), lexoi gramatikën dhe të gjitha burimet e rëndësishme të letërsisë arabe, tefsir, hadith, fikh, kelam, etj..

më vonë e zgjeroi fushëveprimin e tij, duke bërë udhëtime shkencore në qendra të ndryshme, veçanërisht në Andaluzi. Këto udhëtime të Kadi Ijadit nuk janë vetëm për të mësuar, por edhe për të takuar dijetarët atje, për të zhvilluar diskutime shkencore dhe për të shkëmbyer informacione.²

Në qytetin e tij, Kadi Ijadi mësoi përmendsh Kuranin fisnik me shtatë recitimet e tij (kiraetet), lexoi gramatikën dhe të gjitha burimet e rëndësishme të letërsisë arabe, tefsir, hadith, fikh, kelam, etj.. Kjo tregon se personaliteti i tij shkencor është pjekur para se të largohej nga vendlindja.³

MËSUESIT E TIJ

Kadi Ijadi përfitoi nga dijetarët e vlefshëm nga bota lindore islame që erdhën në Magrib dhe Andaluzi, me të cilët zhvilloi diskutime shkencore. Në librin e tij të titulluar “El Gunje”, të cilin ua ka kushtuar mjeshtreve nga të cilët ka mësuar dituri, ka marrë ixhazet apo ka biseduar, ai shprehet se mësuesit e tij kanë qenë rreth njëqind. Mekhari (v. 1041/1623), në veprën e tij të titulluar “Ezharu’r Rijad fi Ahbari Kadi Ijad” kushtuar Kadi Ijad, thekson se ai ka marrë njohuri nga rreth njëqind mësues, ndërsa jep informacion të detajuar për disa prej tyre, teksa të tjerët i përmend vetëm me emër.⁴

Ndër mësuesit e Kadi Ijadit, mund të japim emrat e mëposhtëm:



1. Ebu Ali Hysejin b. Muhamed el Xhejjani el Gassani (v.498/1105), i cili është prijës i haditheve të Kordobës dhe ka vepra të rëndësishme për transmetuesit e Sahihajnit (Sahihët e Buhariut dhe Muslimit).

2. Gjyshi i filozofit Ibën Rushd, Kadi Ebu'l Velid Muhamed Ahmed ibën Rushd (v. 520/1126).

3. Kadi Ebu Ali Hysejin b. Muhamed es Sedefi (v. 514/1120).

4. Ibën Arabi (v. 543/1148).

5. Ebu Bekër Muhamed b. Davud ibën Atijje.⁵

UDHËTIMET SHKENCORE TË TIJ

Pas përfundimit të arsimit shkencor në qytetin e tij, Kadi Ijadi udhëtoi në qendra të ndryshme shkencore dhe kulturore në Andaluzi në periudha të ndryshme dhe përfitoi nga studiuesit e vlefshëm atje. Kadi Ijadi nuk mund të shkonte në botën lindore islame dhe në qendrat shkencore atje, por ai përfitoi përmes kontakteve shkencore me dijetarët lindorë që erdhën në Andaluzi dhe dijetarët andaluzianë që shkonin atje. Për shembull, Sedefi, mësuesit e të cilit i përmendëm më lart, jetonte në Mekë, Medinë, Basra, Damask, Egjipt, Aleksandri etj.. Ai është një dijetar që udhëtoi nëpër qendra shkencore dhe qëndroi në Bagdad për pesë vjet dhe u kthye në Andaluzi. Kadi Ijadi përfitoi shumë prej tij dhe mësoi rreth lindjes prej tij.⁶

ASKETIZMI DHE DEVOTSHMËRIA E TIJ

Kadi Ijadi, i cili ishte i përkushtuar ndaj fesë, kishte një besim të fortë, të pa luhatur dhe kishte një zell fetar, ishte një person që vazhdonte të kryente ibadetet obligative si dhe ato vullnetare. Ai agjëronte shumë, falej natën dhe lexonte pjesë nga Kurani në pjesën e fundit të natës. Ai vazhdoi këtë për aq kohë sa mundi. Detyrat e tij fetare dhe shoqërore nuk e penguan asnjëherë nga studimet shkencore dhe krahas gjithë këtyre detyrave fetare dhe zyrtare, ai lexonte, diskutonte ose shkruante me librat e tij. Kadi Ijadi, e shprehu dashurinë e tij për Hz. Pejgamberin a.s. në një vepër unike siç është “Shifa”.⁷



Në këtë vepër, e cila është komentimi i Sahihut të Muslimit (v.264/877), një nga burimet më të vlefshme të koleksionit të haditheve, Kadi Ijadi u përpoq të plotësonte mangësitë që kishte parë në komentin e titulluar “El Mu’lim fi Fevaidi Muslim” shkruar nga Imam Mazeri

VDEKJA E TIJ

Kadi Ijadi, (v. 544/1149), i cili vazhdoi detyrën e gjyqtarit gjatë dërgimit të tij, ndërroi jetë në Marrakesh. Edhe pse thuhet se ai u helmua dhe u vra nga almohadët, mirëpo një gjë e tillë nuk është vërtetuar, andaj nuk është e vërtetë. Varri i tij është një nga shtatë varret e vizituara nga Markeshët.⁸

VEPRAT E TIJ

Ikmalu’l Mu’lim bi Fevaidi Muslim

Në këtë vepër, e cila është komentimi i Sahihut të Muslimit (v.264/877), një nga burimet më të vlefshme të koleksionit të haditheve, Kadi Ijadi u përpoq të plotësonte mangësitë që kishte parë në komentin e titulluar “El Mu’lim fi Fevaidi Muslim” shkruar nga Imam Mazeri (v.536/1141) për imam Muslimin. Këto dy vepra, të cilat janë më të vjetrat nga komentet myslimane që kanë arritur deri në ditët e sotme, veçanërisht “İkmali” i Kadi Ijadit, janë ndër veprat origjinale dhe të dobishme të literaturës së hadithit. Vlen të ceket edhe libri i njohur i Imam Neveviut (v.676/1277), i cili quhet Minhaxh dhe i cili është komenti më gjithëpërfshirës dhe më i përhapur i Muslimit, është ende në formë dorëshkrimi nëpër biblioteka.⁹

B. El Ilma’ fi Dabti’r Rivajeti ve Takjidi’s Sema’

Në këtë vepër për usuli hadithin, Kadi Ijadi pohon se ka mbledhur informacione të shpërndara në këtë fushë.¹⁰ Kjo vepër u hulumtua nga Es Sejid Ahmed es Sakr dhe u botua në Kajro në vitin 1969.

C. Meshariku’l Envar ala Sihahi’l Athar

Në këtë vepër, Kadi Ijadi, i shpjegon fjalët muškil - të paqarta në Muvattanë e Malikut, Sahihun e Buhariut dhe Sahihun e Muslimit në mënyrë alfabetike në disa kategori. Libri është i shtypur.

D. Tertibu'l Medarik ve Takribu'l Mesalik

Në këtë vepër, Kadi Ijadi i klasifikoi dijetarët maliki që jetuan deri në shekullin e tij sipas niveleve të tyre, duke filluar nga Imam Maliku (vd.179/795), imami i medhhebit, dhe dha të dhëna për ta. Kjo vepër, për të cilën Katip Çelebiu, tha se nuk ishte shkruar deri në shekullin e tij, u përgatit për botim nga i ndjeri M. Tavit et Tanxhi dhe u botua në Fasta në vitet 1965-1970, me një hyrje që përmban informacione shumë të vlefshme për jetën dhe veprat e Kadi Ijadit. Kjo vepër është botuar në Bejrut në vitin 1966, me hetimin e Ahmet Bekirit.

E. Bugjetu'r Raid lima Tedammenehu Hadisu Ummi Dherr mine'l Fevaid

Është komentimi i hadithit të famshëm të Ummu Dherrit, i cili është transmetuar nga Aisheja r.a. dhe përmban shumë fjalë të panjohura (garib).¹¹ Për këtë vepër, e cila është shumë e vlefshme edhe në aspektin e letërsisë arabe, ka punuar prof. Jashar Kandemir (Yaşar Kandemir), i cili ka përfunduar studimet e doktoratës. Me sa e dimë kjo teze nuk është e shtypur.

F. Ihtisar Sherefi'l Mustafa

Gjatë shkrimit, Kadi Ijadi, Ebu Sa'd Abdulmelik b., dëshiron të përfitojë nga vepra e Muhamed en Nisaburit (v.406/1015), të quajtur Sherefu'l Mustafa. Mirëpo, duke qenë se ky libër iu duk shumë i gjerë dhe i gjatë, ai e përmbloodhi atë në mënyrë që të përfitonte më lehtë prej tij.¹²

G. Es Sejfu'l Meslul ala Men Sebbe Ashabe'r Rasul

Është një vepër për vendin në fe të atyre që shajnë dhe flasin keq për sahabët e Kiramit dhe dënimet që do t'u jepen atyre.¹³

H. Esh Shifa bi Ta'rifi Hukuki'l Mustafa

Vepra më e famshme e Kadi Ijadit është "Shifa". Për këtë vepër të vlefshme janë bërë vlerësime lavdëruese, si "vepër unike e shkruar", "vepër e dobishme që nuk është shkruar më parë për temën e saj", "është

Vepra më e famshme e Kadi Ijadit është "Shifa". Për këtë vepër të vlefshme janë bërë vlerësime lavdëruese, si "vepër unike e shkruar", "vepër e dobishme që nuk është shkruar më parë për temën e saj"

dëgjuar nga hoxhallarët se është e dobishme të angazhohesh me librin "Shifa" në ditët e fatkeqësisë.¹⁴

SHKAKU I SHKRIMIT TË LIBRIT "ESH SHIFA"

Disa dijetarë, me këmbëngulje kërkojnë nga Kadi Ijadi, të shkruajë një vepër ku të tregojë vlerën e Hz. Pejgamberit a.s., ndjenjat e respektit që duhet të ndihen ndaj tij dhe cili do të jetë gjykimi fetar për ata që nuk e përmbushin këtë detyrë të madhe apo nuk e kritikojnë atë. Përballë këtyre kërkesave të pandërprera, ai vendos të shkruajë një libër të tillë, edhe pse një obligim i tillë ishte jo edhe i lehtë.¹⁵

Le ta përfundojmë këtë shkrim me përkthimin e një poezie arabe që shpjegon shumë mirë vlerën e librit "Esh Shifa" të Kadi Ijadit:

"Ti i ke fituar xhenetet e Adnit o Ijad,

Libri që keni shkruar si pagesë (bedel).

Hadithet që përmendët atje janë autentike (sahih),

Dhe është shërim për të sëmurin në zemrën e tij."¹⁶

1 Ebu'l Kasim Halef b. Abdulmelik ibën Beshkuval, *Kitabu's-Sila* (Kajro 1966), vëll. II, f. 454.; Ahmed b. Jahja ed Dabbi, *Bugjetu'l-Multemis* (Kajro 1967), f. 437; Hajrettin ez Zirkli, *el A'lam* (Bejrut 1389/1966, III. Baskı) vëll. V, f. 282.

2 El Makkari, Shihabuddin Ahmed b. Muhamed, *Ezharu' Rijad fi Ahbari Kadi Ijad* (Kajro 1358/1939) vëll. III, f. 8-11.

3 Tanxhi, Muhamed Tavit, *Tertibu'l Medarik Mukaddimesi* (Rabat 1965), (vav).

4 El Makkari, a.g.e., vëll III, f. 59; Ibën Hallikan, *Vefajatu'l Ajan* (Bejrut 1397/1977) vëll. III, f. 485.

5 Po aty.

6 El Makkari, a.g.e., vëll III, f. 8-11; Ibën Beshkuval, a.g.e., 73, 174, 440, 453.

7 Tanxhi, a.g.e., (he)

8 Ibën Hallikan, a.g.e., vëll. III, f. 485; Kadı İyaz ve Marakeş Mad.

9 Bazı nüshaları: Nuru Osmaniye, 1035, Ragıp Paşa, 310; Fatih 961.; Bursa Hüseyin Çelebi, 164.

10 Kadi Ijad, *İkmalu'l-Mu'lim*, Nuru Osmaniye ktp, nr..1036, v. 9a.

11 Tanxhi, a.g.e., (kb).

12 Tanxhi, a.g.e., (kb).

13 Katip Çelebi, *Keshfu'dh-Dhunun* (Istanbul 1971), vëll. II, f.1018.

14 Taşköprüzade, Ahmed Efendi, *Miftahu's-Sade*, vëll. II, f. 149.

15 Kadi Ijad, *esh-Shifa bi Ta'rifi Hukuki'l-Mustafa* (Kajro 1369/1950), vëll, I, f. 3-4.

16 Katip Çelebi, a.g.e., vëll. II, f. 1055.

UDHËHEQËSIT E BASHKËSIVE FETARE ISLAME SHQIPTARE VIZITUAN MINISTRIN PËR ÇËSHTJE FETARE TË ARABISË SAUDITE, DR. ABDULATIF BIN ABDULAZIZ AL SHEIKH

Më 22 prill 2024, udhëheqësit e bashkësive fetare islame, Myftiu Naim ef. Tërnavë, kryetari i KMSH-së, Bujar ef. Spahiu, reisul ulema, Shaqir ef. Fetai, dhe delegacionet e tyre përcjellëse, kanë vizituar në shtëpinë e

tij në Riad, ministrin për Çështje Islame të Arabisë Saudite, dr. Abdulatif bin Abdulaziz al Sheikh.

Kjo vizitë u zhvillua me rastin e pjesëmarrjes së këtyre udhëheqësve në mbledhjen e 23-të të Bordit të Lartë të

Akademisë së Jurisprudencës Islame të Lidhjes Botërore Islame – RABITA.

Në këtë takim u diskutuan aspekte të ndryshme, të cilat kanë të bëjnë me çështjet islame dhe shërbimin ndaj Islamit dhe myslimanëve në vendet e Ballkanit në veçanti.

Udhëheqësit e bashkësive fetare islame shprehën falënderimet dhe vlerësimet e tyre për Kujdestarin e Dy Xhamive të Shenjta, Princin e Kurorës, si dhe për ministrin e Çështje Islame, për kujdesin e tyre për myslimanët në botë, si dhe për kujdesin e Dy Xhamive të Shenjta dhe vizitorët e tyre gjatë umres dhe haxhit.

Ata gjithashtu falënderuan ministrin për bashkëpunimin e deritanishëm, duke u pajtuar që të thellohet edhe më tej ky bashkëpunim.



KRYETARI I KUVENDIT TË KOSOVËS, Z. GLAUK KONJUFCA, SHTROI IFTAR PËR MYFTIUN TËRNASA DHE BASHKËPUNËTORËT E TIJ

Më 4 prill 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, mori pjesë në iftarin që shtroi kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Glauk Konjufca.

Kryetari Konjufca vlerësoi lart punën dhe angazhimin e Bashkësisë Islame të Kosovës përgjatë viteve, e sidomos gjatë vitit 2023. Ai përmendi kontributin e BIK-ut, duke potencuar se: “Viti 2023 për BIK-un rezultoi një vit i suksesshëm në këtë mision të tyrin humanitar, me kontribute si shpërndarja e 28,015 pakove ushqimore dhe higjienike, 136 bursave për nxënës dhe studentë, 12,272 dhuratave dhe 15,597 veshmbathjeve, ndihmë për 120 familje të prekura nga vërshimet, 11 shtëpi të ndërtuara dhe 4 banesa për ata në nevojë, ndihma në ilaçe për 136 familje dhe shumë e shumë kontribute të tjera që tregojnë shembullin e mirë të përkushtimit dhe solidaritetit.”



Ai shprehu mirënjohjen e tij për punën e Bashkësisë Islame të Kosovës, nga e cila kanë përfituar shumë sidomos qytetarët tanë në nevojë.

Ai kujtoi edhe vitet para luftës, ku në institucionet fetare janë mbajtur rreth 1230 tubime të karakterit politik. “Po ashtu, është rasti të kujtojmë se përpara luftës në vendin tonë, në institucionet fetare islame janë mbajtur rreth 1230 tubime të karakterit politik, që kanë shërbyer për mbajtjen lart të angazhimit,

ngritjen e moralit dhe mobilizimin politik të popullit tonë. Vlera e këtyre ndodhive është e pazëvendësueshme dhe pjesë e rrugës së popullit tonë në luftën për liri” – thuhet ndër të tjera në postimin e kryetarit Konjufca.

Myftiu Tërnavë shprehu falënderimet e tij për shtrimin e këtij iftari, duke potencuar kështu përkushtimin e Bashkësisë Islame të Kosovës për punë të metutjeshme, gjithnjë në shërbim të besimtarëve e qytetarëve tanë.

KRYEMINISTRI KURTI SHTROI IFTAR PËR MYFTIUN TËRNAVA DHE BASHKËPUNËTORËT E TIJ

Më 5 prill 2024, kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, shtroi iftar për Myftiun Tërnavë dhe bashkëpunëtorët e tij.

Në njoftimin e kryeministritë thuhet se: "Teksa po i afrohem ditëve të fundit të muajit të shenjtë të Ramazanit, kryeministri Kurti u shpreh i

kënaqur që sonte ky iftar i bëri bashkë, duke e rikujtuar se ky muaj na thotë që të përqendrohemi tek ana jona shpirtërore, solidariteti me të tjerët, te mirëkuptimi me të gjithë e tek vlerat e besimit e të shpresës. Për këto ditë të mbetura të agjërimit,

kryeministri iu dëshiroi të gjithëve agjërime të lehtë dhe të pranueshëm."

Myftiu Tërnavë falënderoi kryeministrin Kurti për këtë iftar, si dhe falënderoi atë për bashkëpunimin e deritanishëm me Bashkësinë Islame të Kosovës në të gjitha fushat ku është kërkuar një gjë e tillë.



MYFTIU TËRNAVA U PRIT NË TAKIM NGA KRYETARI I KOMUNËS SË SKENDERAJT, Z. FADIL NURA

Më 8 prill 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, vizitoi Komunën e Skenderajt, ku u prit nga kryetari i kësaj komune, z. Fadil Nura dhe nënkryetari, z. Sami Lushtaku.

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, falënderoi kryetarin e Skenderajt për bashkëpunimin e shkëlqyer në krijimin kushteve për besimtarët myslimanë, me ç'rast, falë këtij bashkëpunimi do të ndërtohet edhe një xhami e re. Ai theksoi faktin e rëndësisë së xhamisë për besimtarët myslimanë, duke potencuar se xhamia shërben për adhurim ndaj Zotit dhe si e tillë, ushqen besimtarin për paqe, tolerancë dhe mirëkuptim të ndërsjellë.

Në anën tjetër, edhe kryetari i Komunës, z. Fadil Nura, u shpreh i kënaqur që përmes këtij projekti po



mund të kontribuojnë për besimtarët myslimanë të Skenderajt, duke u krijuar kushte të përshtatshme.

Kryetari Nura shprehu gatishmëri të plotë në përmbushje të këtij projekti që është në shërbim të komunitet myslimanë.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM IMAMËT DR. HUMMUD AL SHUMERI DHE EJUB AL VUHEJBI

Më 4 prill 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim imamët dr. Hummud al Shumeri dhe Ejub al Vuhejbi, të cilët kanë shërbyer nëpër xhami të ndryshme të Kosovës përgjatë gjithë muajit Ramazan.

Kjo vizitë e tyre ka ardhur si rezultat i bashkëpunimit të mirë ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Ministrisë për Çështje Fetare të Arabisë Saudite.

Myftiu Tërnavë falënderoi imamët për shërbimin e tyre, duke lutur Zotin që t'i shpërblejë me të mirat e Tij në këtë dhe botën tjetër.



Imamët e nderuar falënderuan Myftiun Tërnavë për pritjen, si dhe u shprehën të ngazëllyer me pritjen që u është bërë anekënd Kosovës.

MYFTIU NAIM EF. TËRNAVA ZGJIDHET ANËTAR I AKADEMISË SË JURISPRUDENCËS ISLAME TË ORGANIZATËS SË LIGËS SË BOTËS ISLAME RABITA

Më 6 prill 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, u zgjodh anëtar i Akademisë së Jurisprudencës Islame të Organizatës së Ligës Islame RABITA, me seli në Meke të Arabisë Saudite.

Kjo u bë e ditur përmes shkresës zyrtare të dërguar nga sekretari gjeneral i RABITA-s, dr. Abdulkërim al Isa, përmes së cilës Myftiu Tërnavë u ftua të marrë pjesë në mbledhjen e 23-të të Bordit të kësaj Akademie, e cila u mbajt më 20 prill në Riad të Arabisë Saudite.



U VU GURTHEMELI I XHAMISË SË “HAXHI VESELIT” NË MITROVICË

Më 8 prill 2024, në fund të muajit të bekuar Ramazan, me një atmosferë madhështore, është vendosur gurthemeli i xhamisë së “Haxhi Veselit” në Mitrovicë.

Në këtë ceremoni, përveç besimtarëve dhe hoxhallarëve të shumtë, mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë, si dhe kryetari i Këshillit të BI-së së Mitrovicës, Ekrem ef. Avdiu dhe nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, z. Arian Tahiri.



Myftiu Tërnavë tha se xhamia në trojet shqiptare ka një rol unik, për shkak se gjithnjë ka shërbyer për adhurim ndaj Zotit dhe për çështjet fetare e kombëtare.

Kryetari i Këshillit të BI-së së Mitrovicës, Ekrem ef. Avdiu, tha se kjo xhami, që po fillon të ndërtohet sot, është për shkak se xhamia e vjetër nuk po përmbushte kërkesat e banorëve.

Nënkryetari i Komunës, z. Arian Tahiri, shprehu mbështetje për një projekt të tillë, siç tha ai “që mban gjallë shpirtin e Mitrovicës”.

Kjo xhami pritet të përfundojë shumë shpejt që të shfrytëzohet nga besimtarët.

NË SKENDERAJ U VU GURTHEMELI I XHAMISË SË RE

Më 8 prill 2024, Skenderajn e gjeti edhe me gurthemelin e një xhamie të re. Në këtë ceremoni që filloi me lexim Kurani dhe me tekbiere, morën pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, kryetari i Komunës së Skenderajt, Fadil Nura, si dhe shumë besimtarë të tjerë.

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë tha se po ndjehet jashtëzakonisht mirë me ndërtimin e xhamive, por se duhet kujtuar çdoherë ata që na sollën lirinë.

Komuna e Skenderajt kishte nevojë të jashtëzakonshme për ndërtimin e një xhamie të re në qytet.



Kjo xhami po ndërtohet me financim nga “Syla Grup”, për çka u shprehën të

gëzuar që më në fund po realizohet kjo dëshirë.

URIMI I MYFTIUT TË KOSOVËS, NAIM EF. TËRNAVA, ME RASTIN E FESTËS SË FITËR BAJRAMIT

*Të nderuar vëllezër e motra,
Të dashur qytetarë!*

Nesër është dita e Bajramit, ditë feste për besimtarët myslimanë në gjithë botën. Të gjithë besimtarët i gëzohen kësaj feste, ngase vjen pas një sakrifice të madhe, andaj edhe është një manifestim falënderimi për Zotin pas agjërimit të muajit të bekuar Ramazan. Edhe ne në Kosovën tonë i gëzohemi kësaj feste kaq madhështore, e cila shfaqet në familjet tona e në shoqërinë tonë me gëzime e hare, duke u përhapur me një gjuhë falënderuese në mesin e të gjithë besimtarëve.

Sot, në këtë ditë të bekuar të fundit të Ramazanit, më lejoni që në emër të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, në emër të institucioneve të saj dhe në emrin tim si Myfti i Republikës, t’ju uroj për këtë festë kaq

madhështore, festën e Fitër Bajramit, duke lutur Zotin xh.sh., që të na falë shëndet e mirëqenie.

Falënderimi i takon Zotit, i Cili na ka bekuar me agjërime dhe lutje edhe gjatë këtij muaji Ramazan, duke na bërë të kalojmë këtë muaj në atmosferën e tij sublime shpirtërore dhe në komoditetin e kohezionit, qetësisë dhe kënaqësisë.

Të nderuar vëllezër e motra!

Urtësia e festës së Fitër Bajramit është gëzimi dhe hareja, të cilat trokasnin thellë në shpirtat e besimtarëve, të cilët falënderojnë Zotin e Madhëruar që ua mundësoi agjërimin, adhurimin, faljen e namazit, dhënien e sadakatul fitrit, leximin e Kuranit dhe obligimet e tjera përgjatë gjithë këtij muaji.

Fitër Bajrami bart brenda vetes një tufë virtytesh dhe avantazhesh, që e

dallojnë nga festat e tjera, bart vlerat shoqërore dhe njerëzore të Islamit, ku zemrat bashkohen në miqësi, prandaj, gëzimi i Bajramit përfshinë çdo shtëpi të besimtarëve, e bekimet e Zotit shtrihen në çdo familje islame

Zoti xh.sh. në një ajet kuranor thotë: “Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjërimit dhe që ta madhëroni Zotin (në fund të agjërimit) për shkak se ju ka drejtuar në rrugën e drejtë e që ta falënderoni Atë.” (El Bekare, 185).

Bajrami është ditë falënderimi për Zotin e Madhëruar, ditë gëzimi e hareje për besimtarin, e cila manifestohet me kënaqësi shpirtërore, gëzim e buzëqeshje, që në shpirtat e besimtarëve përhap humanizëm e dashuri ndërmjet tyre. Është ditë kur forca e të pasurve dhe dobësia e të varfërve takohen në dashuri, mirësi dhe



drejtësi, të frymëzuar nga qielli përmes bamireshive të shumta. Në këtë ditë, i lënë mënjane shqetësimet, ngrihen mbi horizontin e parashikuar nga domethënia e kësaj feste, harrojnë fatkeqësitë dhe hallet, ngase fryma vëllazërore e Bajramit sikur i fshin gjurmët e urrejtjes e të dëshpërimit, sepse kjo festë është një vijë ndarëse e rikuperimit të shpresës për jetë më të mirë.

Bajrami është një ditë që edhe fëmijët i mbush me gëzim, buzëqeshje e argëtim, një ditë për të afërmit që i bashkon ata në drejtësi dhe lidhje, ditë e vizitave dhe përqafimeve të shumta, ditë e lutjeve dhe shpresës, ditë ku bamireshi liron dorën për bamireshi, ditë kur duhen pastruar shpirtrat dhe duhen shtrënguar duart, duke shtuar dhe promovuar vëllazërinë, besnikërinë dhe dashurinë edhe më të fortë ndërmjet vete.

Pra festa e Fitër Bajramit, në kuptimin islam është vetë bukuria, madhështia, plotësimi dhe përsosja, bashkëpunimi e respekti, ndjenja e cila i lidh zemrat ndërmjet vete, shoqërimi i cili e forcon vëllazërinë ndërmjet nesh, ditë që forcon unitetin, ditë që në shikimin

tonë figurativ sikur çdo gjë të vyshkur e kthen në gjelbërim nga kënaqësia që kemi për Zotin e Madhërishëm.

Të nderuar vëllezër e motra!

Gjatë festës së Bajramit, fryma e fqinjësisë zgjerohet dhe shtrihet e bëhet sikur tërë shoqëria të jetonte brenda një shtëpie në të cilën arrihet vëllazëria në kuptimin e saj praktik, tiparet dalin në formën e tyre natyrore dhe emocionet dhe prirjet dalin ashtu siç janë. Është një arenë për garë në kërkimin e veprave të mira. Fitër Bajrami është një mundësi për të mbajtur dhe forcuar edhe më shumë lidhjet familjare, duke treguar dashurinë, respektin dhe dhembshurinë mes tyre, gjëra këto që forcojnë unitetin ndërmjet familjeve dhe shoqërisë.

Andaj duhet bërë edhe më shumë që këto festa t'i festojmë si është më së miri, të mos zbehim festat tona nga bukuria e tyre fetare e kombëtare, t'ju falim atyre kuptimin shpirtëror edhe më të madh, shkëlqim e dritë vëllazërore. Festa e Fitër Bajramit ka për qëllim formimin e një shoqërie të lumtur e të ndërgjegjshme, e cila edhe gjatë ditëve të festave ngrihet në majat më të larta, ku ajo shfaqet kohezive, bashkëpunuese dhe e dhembshur në

mes besimtarëve, deri në pikën ku çdo zemër të rrah me dashuri, drejtësi e mëshirë.

Të nderuar vëllezër e motra!

Gëzimi dhe lumturia janë të dukshme në fytyrat dhe zemrat e të gjithë besimtarëve gjatë ditëve të Fitër Bajramit, është nder i madh prej Zotit që ua mundësojë të gjithë atyre që agjëruan Ramazanin, adhuruan Zotin xh.sh., u solidarizuan me të varfrit, ndihmuan njerëzit nevojtarë, krijuan harmoni familjare brenda familjes, ruajtën krenarinë për fenë dhe atdheun, kaluan çdo sfidë vetëm për ta kënaqur Krijuesin, ngase në këtë mënyrë zemrat tona janë më afër Zotit dhe do të shpërblehen me begati të shumta prej Zotit të Madhërishëm.

Në fund më lejoni edhe njëherë që të gjithë besimtarëve si në Kosovë, ashtu edhe në mërgatën e largët, kudo që gjenden t'ju uroj këtë festë kaq madhështore dhe ta lus Zotin që të na falë shëndet, siguri dhe mundësi për të bërë edhe më shumë për vatanin tonë.

Prishtinë, Myftiu i Kosovës,

9 prill 2024 Naim ef. Tërnavë

BESIMTARËT MYSLIMANË NË KOSOVË FESTUAN FESTËN E FITËR BAJRAMIT

Më 10 prill 2024, besimtarët myslimanë në Kosovë festuan festën e Fitër Bajramit. Kjo festë për besimtarët myslimanë vije pas muajit Ramazan, muaj në të cilin besimtarët agjërojnë, japin sadaka dhe shtojnë ibadete të ndryshme.

Manifestimi qendror për festën e Fitër Bajramit u mbajt në Xhaminë e Madhe në Prishtinë. Manifestimi filloi me faljen e namazit të sabahut, të cilit i priu Hetem ef. Sopjani.

Ligjëratën kushtuar kësaj feste e mbajti profesori i Medresesë “Alauddin”, Shkëlzen Hoxha. “Nuk ka mundësi njeriu të jetë besimtar i devotshëm pa u kujdesur për raportin e tij me Zotin e Gjithmëshirshëm, dhe në të njëjtën kohë nëse njeriu është i kujdesur në këto raporte, kjo nuk e amnistion atë që të jetë i shkujdesur në raportet ndërnjerëzore, se po nuk u kujdes, i humbet mirësitë e kujdesit të ruajtjes së raporteve me Allahun xh.sh.. Pra besimtar i vërtetë dhe i devotshëm është vetëm ai që bashkon këto dy sjellje, në raport me Zotin dhe në raport me robin. Në të kundërtën ai nuk ka arritur të jetë nga të suksesshmit në këtë jetë, e as nga të shpëtuarit në Ahiret”, tha gjatë ligjëratës profesori Hoxha.

Manifestimi vijoi me faljen e namazit e Bajramit, të cilit i priu kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti.

Hytben e Fitër Bajramit e mbajti Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me mesazhe paqeje, dashurie, harmonie dhe tolerance ndaj njëri-tjetrit. Në veçanti, Myftiu Tërnavë bëri thirrje që të ruhet trangu familjar, ashtu siç na mëson feja islame.

“Me të drejtë feja islame e ka vënë familjen në qendër të shqetësimeve të saj, pasi që e konsideron bazë për stabilitetin dhe mirëqenien e shoqërisë. Kushdo prej nesh që përcjell diskutimet, por edhe debatet e shumta që po zhvillohen kohëve të fundit në vendin tonë për aprovimin e disa ligjeve rreth familjes, shoh se këto përpjekje bien ndesh me identitetin, fenë dhe vlerat morale që posedon shoqëria jonë. Përpjekjet në këtë drejtim janë për shkatërrimin e familjes, zhdukjen apo dobësimin e moralit të lartë që bartë ky popull, ngase synohet një shoqëri që jeton pa ndjenja të lidhjes emocionale me familjen, të afërmit, traditën, zakonet, dhe fisin, dhe ndikimin që këto elemente kanë në ruajtjen e kohezionit social dhe përkushtimin moral brenda shoqërisë sonë. Duhet ditur se është urdhër hyjnor që familja duhet të jetë e kompletuar, ta dijë se kë e ka babë e nënë, gjysh e gjyshe, vëlla e motër”, tha Myftiu Tërnavë gjatë hytbes.



BIK-U HAPI DYERT PËR TË PRANUAR URIMET PËR FESTËN E FITËR BAJRAMIT

Më 10 prill 2024, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, ashtu sikurse tradicionalisht hapi dyert e selisë për të pranuar urimet me rastin e festës së Fitër Bajramit.

Për të uruar Myftiun Tërnavë dhe gjithë besimtarët myslimanë për festën e Fitër Bajramit, në selinë e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës erdhën liderë shtetëror, fetar, politikë,


përfaqësues të misionëve të huaja në Kosovë, ambasadorë dhe përfaqësues të tjerë. Në vazhdim është albumi me foto të disa prej personaliteteve që vizituan krerët e BIK-ut në këtë festë.



Presidentja e Kosovës, znj. Vjosa Osmani, me bashkëpunëtorë



Kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti, me bashkëpunëtorë



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Glauk Konjufca, me bashkëpunëtorë




Ipeshkvi i Kishës Katolike, z. Dodë Gjergji, me bashkëpunëtorë



Kryetari i PDK-së, z. Memli Krasniqi, me bashkëpunëtorë



Kryetari i LDK-së, z. Lumir Abdixhiku, me bashkëpunëtorë



Kryetari i AAK-së, z. Ramush Haradinaj, me bashkëpunëtorë



Kryetari i Komunës së Prishtinës, z. Përparim Rama, me bashkëpunëtorë



Ambasadori i Shqipërisë, z. Petrit Malaj



Ambasadori i Turqisë, z. Tunc Angili



Ambasadori i OSBE-së, z. Michael Davenport



Shefja e UNMIK-ut, znj. Carolina Ziadeh



Drejtori i Përgjithshëm i PK-së, z. Gazmend Hoxha, me bashkëpunëtorë

Përfaqësuesi i AKR-së, z. Vesel Makolli, me bashkëpunëtorë;

Kryetari i PD-së, z. Ferid Agani, me bashkëpunëtorë;

Kryetari i PAI-së, z. Qazim Rrahmani, me bashkëpunëtorë;

Kryetari i Listës Konservatore, z. Abdullah Klinaku, me bashkëpunëtorë;

Drejtori i "Qatar Charity", z. Esam Dabab, me bashkëpunëtorë, etj.

U MBAJT LIGJËRATË KUSHTUAR DIJETARIT, PRIJËSIT DHE UDHËRRËFYESIT VEHBI EF. DIBRA



Më 25 prill 2024, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, në bashkëpunim me Fakultetin e Studimeve Islame, organizoi ligjëratë kushtuar dijetarit, prijësit dhe udhërrëfyesit, Vehbi ef. Dibra. Në ambientet e Fakultetit të Studimeve Islame këtë ligjëratë e mbajti shkrimtari dhe diplomati, Besnik Mustafaj.

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë vlerësoi lart diplomatin Mustafaj për angazhimin e tij, si në fushën e letërsisë, ashtu edhe atë kombëtare.

“Profesori në formën më të mirë ka përfaqësuar vendet tona dhe aspiratat e popullit tonë, si me penën e tij të mprehtë, ashtu edhe në angazhimin e tij prej diplomati e veprimtari, ku është shquar për urtësi, vizion e thellësi prej diplomati e mendimtari, duke u shndë-

rruar kështu në një ndër përfaqësuesit e ambasadorët më të nderuar të vendit tonë, prej Parisit e deri në kancelaritë më të rëndësime të botës. Dhe si i tillë, profesori ka dhënë kontribut të madh në sensibilizimin e çështjes së Kosovës dhe lirisë së saj në arenën ndërkombëtare, për se i jemi mirënjohës”, tha Myftiu gjatë fjalës së tij.

Në këtë ligjëratë u potencua kontributi i pashoq i Vehbi ef. Dibrës në çështjet fetare dhe atë kombëtare. Ai u veçua si komentuesi më i mirë i Kuranit në shqip, teksa ishte edhe kryetar i parë i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

“Janë tri attribute, të cilat përmbledhin më së miri dimensionet e këtij personaliteti të madh. Bisedën me ju sot e shoh si pjesë domethënëse të

nismës së institucioneve drejtuese të Bashkësisë Islame të Kosovës për t’u identifikuar me trashëgiminë më të lavdishme të myslimanëve shqiptarë, të cilët e shkrinë jetën e tyre duke vepruar në shërbim të kauzës për “fe dhe për atdhe”. Është në nderin e të gjithë myslimanëve shqiptarë që një shprehje e tillë ka dalë pikërisht nga mendja e Haxhi Vehbi Dibrës, duke përcaktuar kështu horizontin, drejt të cilit ka ecur gjatë më shumë se një shekulli dhe do të vazhdojë të ecë shqiptari i besimit islam. Ky përcaktim e bën menjëherë urën lidhëse midis Haxhi Vehbi Dibrës dhe 37 imamëve shqiptarë të vrarë si martirë gjatë luftës së fundit çlirimtare në Kosovë”, tha ai gjatë kësaj ligjërate.



KRYEIMAMI SAHITI TAKOI KRYEIMAMËT E KËSHILLAVE TË BI-SË



Kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, së bashku me zëvendësin e tij, Fatmir ef. Iljazin, takuan kryeimamët e këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës, për të diskutuar dhe vlerësuar raportet e punës dhe aktivitetet e muajit Ramazan.

Kryeimami Sahiti fillimisht falënderoi kryeimamët për punën

dhe angazhimin e tyre që kanë dhënë gjithandej këshillave të BI-së gjatë muajit Ramazan. Ai vlerësoi angazhimin dhe përkushtimin e gjithë imamëve, sidomos gjatë këtij muaji të bekuar, ngase ky është amanet që e kemi marrë mbi supet tona, për ta kuptuar mirë e drejtë fjalën e Zotit dhe mësimet e Pejgamberit a.s..

Më pas kryeimami Sahiti theksoi bashkëpunimin e kryeimamëve me imamët dhe xhematët e tyre, si dhe bashkëpunimin dhe koordinimin me Kryesinë në pritjen e ekipës së ligjëruesve të përbërë nga Kryesia, Fakulteti i Studimeve Islame dhe Medreseja. Gjatë takimit u diskutuan edhe çështje të tjera me interes, me qëllim të avancimit të jetës fetare në vend.

DELEGACIONI I KRYESISË SË BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS QËNDROI NË DIASPORË

Në vazhden e aktivitetet e muajit Ramazan, një delegacion i përbërë nga Ekrem ef. Simnica, Besim ef. Mehmeti, Shkelzen ef. Hoxha, Ekrem ef. Maqedonci, Bahri ef. Hoxha, Rexhep ef. Suma, Bahri ef. Hoxha dhe Fitim ef. Flugaj, nga data 28 mars deri më 1 prill 2024, qëndruan për vizitë në diasporë, ku mbajtën ligjërata e tribuna për nder të këtij muaji.

Ky delegacion vizitoi QISH në Gjermani, pjesën e Shtutgartit, Bavarinë dhe pjesën e Duserforfit.

Fillimisht ky delegacion u prit nga kryetari i Unionit të Xhamive Shqiptare në Gjermani, Mensur ef. Halili. Drejtori i Diasporës, Ekrem ef. Simnica falënderoi kryetarin Halili dhe kryetarët e bashkësive islame shqiptare dhe të unioneve për koordinimin paraprak për t'i realizuar këto vizita. Ai falënderoi gjithashtu të gjithë ata që kontribuan në përgatitjen e programeve për vizita,



por edhe për shoqërimin e delegacioneve në këto vende, duke lutur të madhin Zot që t'i shpërblejë me të mirat e Tij. Ai tha se ky koordinim duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Ndërkaq përfaqësuesi i BIK-ut, Fitim ef. Flugaj, vizitoi qendrat islame shqiptare në Norvegji, Suedi dhe Danimarkë. Ai gjatë kësaj vizite u prit

nga imami Sabri ef. Jonuzi, të cilin e falënderoi për pritjen dhe organizimin e ligjëratave në katër qendrat shqiptare në Norvegji.

Ky grup, gjatë këtyre ditëve sa qëndruan në Gjermani, Norvegji, Suedi dhe Danimarkë vizituan 35 qendra islame shqiptare.

DREJTORI SIMNICA PRITI NË TAKIME TË NDARA PËRFAQËSUES TË XHAMIVE NGA DIASPORA



Më 19 prill 2024, drejtori i Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, ka pritur në takim kryetarin e Xhamisë Shqiptare në Neumarkt të Gjermanisë, z. Naser Gashi.

Kurse, më 24 prill 2024, drejtori i Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, ka pritur në takim nënkryetarin e Bashkësisë Kulturore dhe Fetare Shqiptare në Dramen të Norvegjisë, z. Rrustem Seferi.

Drejtori Siminica falënderoi përfaqësuesit nga diaspora dhe nëpërmes tyre tërë mërgatën tonë shqiptare që gjendet në diasporë për kontributin e dhënë për mirëqenien dhe jetën e përgjithshme fetare të shqiptarëve atje. Ai shprehu gatishmërinë e tij, por edhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që bashkëpunimi i mirë që ka mbretëruar deri më tani, ndërmjet BIK-ut dhe diasporës të vazhdojë edhe më tutje.



DREJTORI SIMNICA MORI PJESË NË ORGANIZIMIN PËR FILLIMIN E PUNIMEVE TË XHAMISË NË MNGEN TË GJERMANISË

Më 27 prill 2024, me ftesë të bashkatdhetarëve tanë në Gjermani, drejtori për Diasporë në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, mori pjesë në solemnitetin e nismës për ndërtim të xhamisë së re në Mngen të Gjermanisë.

Të pranishmit fillimisht i përshëndetën Adnan Abdiu, kryetari i Këshillit iniciativë, Mensur ef. Halii, kryetar i Unionit të Qendrave Islame në Gjermani, dr. Reshat Ibishi, kryetar i BFI-së së Italisë, prof Muhamed ef. Sytari, myfti i Shkodrës, hoxhë Ardian Sejdiu etj.

Drejtori për Diasporë në fjalën e tij përshëndeti të pranishmit në emër të BIK-ut, institucioneve të saj dhe të Myftiut Tërnavë. Ai foli për ca pika të rëndësishme mbi xhaminë, vlerën dhe rolin e saj, në veçanti mbi vlerën e kontributit në ndërtimin e saj.


Ishte një pritje madhështore me një respekt të madh. Te të gjithë ndihej një gëzim i madh dhe me një dëshirë që sa



më shpejt të nisen punimet e fillimit të xhamisë. Burra, gra, të rinj e të reja, fëmijë, mysafirë e dashamirë nga të gjithë anët, nga Gjermania, Austria, Zvicra dhe Italia formuan ambient të lartë dhe dhanë kontributin e tyre madhështor, duke treguar dashurinë e madhe ndaj ndërtimit të xhamisë, ku brenda disa orëve u tubuan mbi 500 mijë euro, me të cilat shumë pritet që shumë shpejt të niset xhamia e re në Mngen.

Drejtori për Diasporë i siguroi mërgimtarët se Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës është shumë e përkushtuar që të forcojë dhe të shtojë komunikimin dhe bashkëpunimin me të gjitha xhamitë shqiptare në diasporë, me qëllim të bashkërenditjes së aktiviteteve në të mirë të mërgatës sonë.

Zoti e bekoftë këtë nismë të madhe dhe tejet të dobishme për bashkatdhetarët tanë!



**KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS
MEDRESEJA E MESME “ALAUDDIN” PRISHTINË**



KURBANI 2024



Porosinë tuaj mund ta bëni në:

► Këshillin e Bashkësisë Islame

► Përmes bankës

NLB Banka

IBAN: XK05 1700200100103672

SWIFT Code (BIC): NLPRXKPR

DITURIA ISLAME • Nr. 402 MAJ 2024